

NJE VAJZE NE VAGONIN TONE

TREGIME

BIBLIOTEKA
SHTETIT

854-32

.P97

RUZHDI PULAHA

891.P.85-32

891

RUZHDI PULAHA

8

NJË VAJZË NË VAGONIN TONË

(Tregime)

~~56595~~



2850

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

NJË VAJZË NË VAGONIN TONË...

Megjithëse gazetarë, na bëri përshtypje. Pothuajse gjysma e vagonit ishte bosh por ajo eci përmes tij dhe erdhi te ne.

— Mos ju shqetësoj gjë po të ulem këtu?

— Përkundrazi! — qeshi shoku im.

Edhe ajo qeshi. Rregulloi borsetën dhe u ul përballë nesh. Këmbyem nga një shikim me Bujarin. Kishim qenë dy javë me shërbim në një zonë të thellë e tani po ktheheshim plot përshtypje duke menduar për reportazhet tona. Duke qenë bashkë për një kohë të gjatë, pothuajse na ishin mbaruar fjalët. Dhe kthimi me tren me siguri do të ra ishte i mërzhitshëm. Edhe ato që kishim inçizuar në manjetofon i patëm dëgjuar kushedi sa herë dhe tani s'na bënë më ndonjë përshtypje të madhe. Dhe ja ku vjen e ulet pranë nesh një vajzë. Pavarësisht si e kuptojnë njerëzit këtë, po vajzat e gjalla dhe gazmore e bëjnë bisedën interesante, sidomos në udhëtim. Aq më tepër kur është e panjohur, si kjo që u ul pranë nesh.

— Gazetarë, apo jo?

— Pikës i ke rënë.

— E mora me mend nga manjetofoni.

— Bujar Teferiçi — u prezantua kolegu.

Ajo qeshi pa të keq:

— Ç'mbiemër simpatik! Një herë më ka shkuar rëpër mend që gazetarët dhe shkrimtarët duhet të kenë emrat dhe mbiemrat më të bukur.

Thashë dhe unë emrin tim.

— Tefta Vasili — tha ajo.

Një heshtje e shkurtër, siç është zakon të bëhet pas prezantimeve.

Ajo na shihte pa ndrojtje dhe në fytyrën e rregullt ovale i endej një buzëqeshje e lehtë. Bujari nxori «Ardianin».

— E pini?

— Jo, e kam lënë — qeshi ajo. — Juve gazetarëve ju pëlqen t'i ngacmoni njerëzit.

— Sëmundje profesionale — qesha unë.

— Unë jam punëtorë në uzinën... — Diç desh të shtonte po meqë ne si gazetarë domosdo i kuptojmë gjërat pa i thënë gjer në fund s'vazhdoi më tej. Veç na pa një herë në sy, pastaj tha:

— Në përgjithësi i kam inat vajzat që pirë duhan. Duan të bëhen moderne me zor.

S'kishte si të mos na tërhiqte çiltërsia e saj! Mund të ishte njëzet e një, njëzet e dy vjeçe, jo më tepër. Dhe mjaft simpatike. Sidomos sytë i kishte të bukur, të mëdhenj e të kaltër, me një kthjelltësi çuditërisht të thellë. Ja kisha frikën Bujarit, që po i shihte si i hutuar ata sy. Ai ja këput nganjëherë pa u menduar shumë e të turpëron. Ajo na vuri re, buzëqeshi dhe uli kokën. Më erdhni mirë që e dinte se ishte e bukur.

— Keni punë interesante! — na tha.

— Gjithmonë pula e botës duket më e majme

— ja ktheva unë pa djallëzi.

Vura re që vrejti një çast mos gjente kuptim të dytë të fjalët e mia.

— Do të kisha shumë qejf të isha gazetare...

— T'i thotë ky shoku një herë shefit. Kanë një vend bosh në redaksi — foli Bujari. Ai gjithmori donte t'i ngacmonte të tjerët.

— Nuk po tallem. Dhe më vjen keq që ka shumë pak vajza gazetare. Pse?

— S'është aq e lehtë puna jonë... Ka shumë shërbime. Edhe kur s'je me shërbim, ta sjellin bashkëpunëtorët në majë të hurdës.

— Kurse mua tamam për ato shërbime më pëlqen... Gjithmonë në lëvizje — dhe ju drejtua Bujarit, që papritur kishte rënë në mendime. — Edhe kjo më pëlqen që gazetari, siç ma merr mendja mua, gjithmonë është i shqetësuar, rë mendime... Ja, ju me siguri mendoni për ndonjë shkrim?

Ai siç e ka zakon që s'ta përton ja pat:

— Jo, për ju!

— Për mua!? — dhe ngriti supet duke më hedhur një shikim pyetës.

— Jam e fejuar.

— S'jua thashë për atë — u hodh Bujari — po ra bëri shumë përshtypje ardhja juaj këtu. Zakonisht vajzat në tren ose rrinë pranë vajzave, ose ulen me pleq e me fëmijë. Le që ka shumë që nuk udhëtojnë kurrë vetëm. Aq më tepër që ju qenkeni dhe e fejuar.

— Unë ju vura re që në autobus. Këtu në tren s'kisha ndonjë të njohur. Udhëtimi vetëm është i mërzitshëm.

— Varet nga vjen e ku shkon — thashë unë.

Me gjithë tonin tim serioz ajo e kuptoi rëntekstin dhe më tundi kokën.

— Dhe unë erdha këtu. Ka ndonjë të keqe? Jo. Unë gjithmonë kam menduar se gazetarët janë nje-

rëz interesantë dhe kanë muhabet të këndshëm. Dhe kështu duhet të jetë. Përveç që ju keni dhe manjetofon e mund të dëgjojmë rdonjë çikë muzikë.

E ndeza manjetofonin dhe në vagon u përhapën tingujt e një tangoje të vjetër. Ndonëse ajo mundohej të mos tregohej, dukej që s'i pëlqente.

— E bukur, ë? — e ngacmoi Bujari.

— Zakonisht për plakat thuhet: ka qenë e bukur. Dukej që edhe asaj s'i mungonte humori.

— Si s'keni gjetur ca pjesë më të freskëta — tha pastaj. — Në autobus dëgjova edhe diçka tjetër. Më duket se ishte nga «Sonata e Hënës» e Bethoverit.

— Ka mbetur vetëm një fragment i shkurtër. Kishim edhe pjesë të tjera, por i prishëm se na duhej shiriti.

Bujari ma rrëmbeu manjetofonin.

— Kemi edhe të tjera, mos u mërzitni. Dhe vuri një hoblinë tjetër. E ngriti volumin deri në fund. Gjëmoi labçja:

«U vra Ziguri në portë,
ç'u vra Zigur Lelua.»

Papritur Bujari e mbylli manjetofonin. Ajo na pa me vërejtje. Dhe recitoi vazhdimin e këngës:

«Burra, djemtë smokthirjotë,
seç u bëtë lakëra,
si aty edhe më poshtë,
majë vreshtave të mëdha.»

— Për nder unë do t'ju fus në reportazh — tha Bujari i entuziazmuar.

— Jam labe, — tha ajo — Me këto këngë jam rritur. Dhe në doni të dini ju, labçja nuk këndohet rjëlloj kudo. Kjo që keni inçizuar ju është smokthinjotshe. Sa ditë qëndruat në Smokthinë?

— Nja dhjetë ditë.

— Me siguri jeni kënaqur. Janë njerëz shumë të pritur. Edhe të muhabetit. Pothuajse s'ka shtëpi pa dëshmorë.

— Shumë kanë luftuar — pohova urë.

— Po kanë bërë edhe dashuri, ama — tha Bujari me ton solemn. — Dhe që në vakt, jo tani!

— Por shumica e tyre ishin vrarë — i kujtova unë.

— Prandaj dhe unë rjël kapitull të reportazhit do ta titulloj «Dëshmorët e Dashurisë».

U kujtua për diçka e seç po kërkonte në bobinat e manjetofonit.

— Megjithatë të tjerët prapë dashuronin — tha Tefta.

— Po — tha Bujari dhe e la manjetofonin. — Mbase më jepni ndonjë mendim interesant. Atje gjetëm disa pleq që kishin nga dy gra.

— Ka — tha ajo.

— Te njëri prej tyre kaluam rjël natë. Të them të drejtën njerëz të shkëlqyer. Na pritën si s'ka më mirë. Ishin vetëm ata të tre, xha Nevruzi dhe dy gratë. Fëmijë s'kishin. Na e treguan gjithë jetën e tyre. Diçka edhe e kemi inçizuar. Atë kërkjoja... Nejse. Xha Nevruzi ishte nja shtatëdhjetë vjeç. Aty afër edhe gruaja e parë. E dyta ishte nja dhjetë vjet më e re. Rrinin të tre pas vatrës e na tregonin. Herën e parë xha Nevruzin e kishin martuar prindërit, kurse herën e dytë e shoqja. Ajo s'bënte fëmijë. Dhe kishte futur njerëz t'i gjenin një grua tjetër. Ai

s'kishte dashur, po ajo kishte ngulur këmbë dhe xha Nevruzi e kishte marrë edhe të dytën. Me atë lindi një djalë. Dhe u gëzuan të tre. Po më shumë u gëzua nusja e madhe. Dhe ai atë dinte për nënë. Kur u bë nja pesëmbëdhjetë vjeç, djali vdiq nga një sëmundje e ligë, siç thoshin pleqtë. Ata u zeherosën. Tani kanë mbetur tre pleq. Duhet shumë, siç pamë. Nuk është e çuditshme!? Megjithëse siç e sheh ky rast nuk është tipik. Xha Nevruzi s'duhet të ketë qenë qejfli grash dhe siç të thashë e martoi gruaja e parë. Po edhe gjetiu na thanë se në përgjithësi dy gratë e një burri shkonin mirë. Mua më duket si e pamundur. Hipokrizi. Gratë tora me një shoqe të të shohin në rrugë e s'të lënë pa një orë konferencë.

Ajo dëgjoi me vëmendje. Tani ishte serioze dhe e menduar.

— S'është për t'u çuditur. Edhe janë dashur, sepse s'kanë patur tjetër mbështetje veç njëra-tjetrën. Sidoqoftë është shumë e rëndë. T'i lëmë të tjetrat e të mendojmë vetëm... Si ta them unë! Që burri një natë i përket njëres e një natë tjetrës.

Bujarit në këto lloj bisedash s'i rrihet pa folur:

— Ajo është kryesorja!

Tefta s'ja vuri veshin dhe vazhdoi me seriozitetin e saj:

— Edhe nënshtrimi ka nxjerrë dashurinë e tij, një dashuri të dhimbshme por që atyre u duhej për të jetuar. Pastaj lindnin fëmijë dhe ato të mjera sikur kapeshin pas jetës.

— Ju sikur keni mbaruar për sociologji — tha Bujari.

— Diçka lexoj.

Treni kishte ndaluar në një stacion. Unë u mata të dilja për të marrë diçka në bufe.

— Ju doni ndonjë ëmbëlsirë apo më mirë ndonjë frut? — e pyeta vajzën.

Ajo më kapi për krahu dhe më uli.

— Do t'ju qeras unë.

— Kjo nuk shkon — tha Bujari.

— Mos u bëni... — Seç desh të shtonte, por si duket s'e gjeti dot fjalën e duhur aty për aty. — Le që këto të miat janë pa shpenzime. M'i ka dhënë vjehrra.

Na dha nga një mollë të madhe.

— Isha në Vlorë tek i fejuari. Shkova të shtunën pasdite, ndejta dje dhe sot nga treni drejt e në uzinë... Kam turnin e dytë.

— Edhe kjo e fortë! — tha Bujari.

— Me ju po shoh që edhe gazetarët habiten për gjëra që s'jarë aspak të jashtëzakonshme.

— Mos ja vini re — thashë unë — ai shkruan pothuajse vetëm për realizimin e planeve, për rendimentet...

Bujari desh të sqarohej:

— Jo, se zakonisht shkojnë të fejuarit te të fejuarat. Kemi re një shok që mbeti trenave. Shkon çdo javë në Elbasan. Dhe gjithmonë kthehet me rrufë:

— Edhe ne çdo javë takohemi po e kemi me radhë, një herë shkoj unë, një herë vjen ai.

— Për nder, unë do të shkruaj për ju! — bërtiti Bujari i ertuziazmuar.

— Lëre, se e merr vesh i fejuari dhe i jep ndalim qarkullimi.

— Ai është king, s'e çan kokën për këto gjëra.

— Sa mirë! Keni qëlluar të dy njëlloj.

— E kemi gjetur njëri-tjetrin.

— Po kështu, nga kashta? — tha Bujari. — Mos ma merrni për të keq, po ju jeni mjaft simpatike...

Më falni, hë, po do të më mbetej merak po të mos
jua thosha.

— O, ç'numër! — Qeshi me zë ajo.

Po flisnim fare shpënguar, sikur aty të mos kish-
te njerëz që na dëgjonin. Dhe as që kishim vënë re
se po na shihnin me kureshtje, disa edhe si me dyshim.

— Bateritë e thashethemeve në gatishmëri të
plotë — thashë unë.

Ajo hodhi sytë përçark:

— Qeni ha atë që ka frikë, zakonisht.

— Megjithatë mua më kanë dërguar një letër
në redaksi një herë — tha Bujari.

— E pse?

— Për një rast pak a shumë si ky i sotmi.

— Ç'komedi!

— Ashtu thashë edhe unë, po ecë e t'i mbushje
mendjen kryetarit të komitetit profesional. Janë
fjalë kot, i thosha unë. Megjithatë, shok i dashur,
më thoshte ai, kritika duhet marrë parasysh. Punët
e femrave janë me zarar. Mirë, ta zëmë se janë
thashetheme. Po, të jemi realistë. Ka një të vërtetë
këtu. Të paktën tridhjetë për qind. Ç'tridhjetë, more,
i thosha unë. Mirë, thoshte ai, e zëmë njëzet e
shtatë. Dhe sado që u mundova unë ai s'e uli
dhjetë përqindshin.

— E keni prapë atë kryetar?

— Ai ka dalë në pension po mua që atëherë më
thërrasin «Dhjetë përqindsh».

Për herë të parë heshtja jonë gjatë këtij udhë-
timi zgjati disa minuta. Më kishte futur në mendim-
e kjo vajzë. Më kishte zgjuar dhe një ndjenjë të
vagëlluar keqardhjeje. Pse nuk janë të gjitha vaj-
zat kështu?!

— Të martuar jeni?

— Kemi dhe nga një trashëgimtar.

— Unë fatkeqmirësisht kam vajzë — më pasoi Bujari.

— Ku ka si vajzat!

Ai nisi të shpjegonte fatkeqmirësinë e tij. Pasoi një heshtje e shkurtër. Ajo po merrej me butonat e manjetofonit. Duke luajtur padashur njërin prej tyre, një zë plaku lëshoi një të sharë vençe. Ajo s'dinte ta ndalonte dhe ktheu manjetofonin nga unë.

— Në majë të gjuhës i kishte të sharat xha Veseli — tha Bujari.

— Me inçizimet me siguri e keni të vështirë?

— Jo me të gjithë.

— Sidomos me pleqtë — tha ajo.

— Më tepër me të rinjtë — u hodh Bujari. — Pleqtë janë babaxhanë e flasin si në muhabet. Kurse ka ca të rinj që të marrin shpirtin. O do të pregatiten me shkrim, o një fjalë s'të thonë.

— Kam folur edhe unë një herë. Në një emision për rininë më duket. Ishte hapur një anketë për dashurinë. Ka patur diskutime interesante.

Bujari e pyeti me shejtanllëk:

— Ishit fejuar atëherë?

— Pothuajse. Në atë emision kemi diskutuar bashkë me Gimin. — Ajo qeshi. — Patëm edhe një debat në mikrofon. Ama ai redaktori na e punoi. «Ta zëmë se ne të dy dashurohemi» — tha Gimi. «Jo ta zëmë po duhemi me të vërtetë» — desha të sqaroja të tjerët unë dhe harrova që isha para mikrofonit. Dhe filluam të diskutonim se si duhet të ishin marrëdhënjet tona. Në fund, kur e dëgjua bisedën, i thashë redaktorit që ta hiqte atë ndër-

hyrjen time. Ai më premtoi, por s'e kishte hequr. Kështu që ne e shpallëm publikisht dashurinë tonë. E jo dosido po në radio. Ajo na solli ca telashe në shtëpi po i kaluam. — Dhe qeshi përsëri. — Natyrisht, pa dëme.

Treni ngadalësoi shpejtësinë. Pasagjerët po pregatiteshin për të zbritur. Mbi ne akoma binin dhjetëra shikime. Nëpër buzë po mbinin fjalë.

— Po ju erdhi edhe një letër në redaksi u bëtë njëzet përqindsh — i tha Bujarit ajo duke rregulluar flokët e derdhur supeve.

Ai kishte nxjerrë blokun e diç po shkruante.

— Do të shkruaj për ju. Për nder, do të shkruaj!

Treni qëndroi. Ajo hodhi borsetën mbi sup e na shtriu dorën.

— Do të dalim bashkë — thashë unë.

— Mos ju shohin gratë? — Dhe më tregoi me kokë Bujarin.

Në qeshëm. Megjithatë hodhëm një sy vjedhurazi nga dritarja. Ajo na vuri re.

— Na ka marrë malli — tha Bujari.

— Me këtë punë që keni ju, të mjerat ato po qenë xhelozë!

Kishim zbritur. Ecëm një copë rrugë pa folur. Ne mendonim për të. Ajo kushedi për se. Dhe ecte shpejt. Kur dolëm në udhëkryq qëndroi.

— Unë e kam këtej. Do të shkoj drejt e në punë. Pas njëzet minutash fillon turni. Mirë u pafshim!

Si bëri disa hapa u kthye përsëri nga ne:

— Hajdeni ndonjëherë nga uzina. Shkruani për prodhimet e reja, për filialin e universitetit...

— Edhe për ty — tha Bujari.

Ajo na përshëndeti me dorë dhe vrapoi të arrinte urbanin e unazës.

Ecnim në heshtje.

— Sa e mirë! — thashë unë.

— E, ç'gazetare do të qe bërë! — tha Bujari.

Ecnim dhe mendonim për të.

KOLEGËT

Nikua po kthehej në qendër të kantierit me një tufë projektesh në duar. Kur mori kthesën e korpusit kryesor pa disa punëtorë të brigadës së tretë që po shtynin një soletë të rëndë për t'i hapur rrugë vinçit.

— Hë, bre, akoma!? — tha Nikua dhe hoqi peliçen, futi projektet midis saj dhe e lëshoi mbi një grumbull tullash.

Punëtorët e lodhur e të mbytur në djersë u gjallëruan e u përtërinë. Duke i dhënë levës me sa mundte Nikua thërriste:

— Ohop... Edhe një herë... Hopa!

Muskujt e të gjithëve tendoseshin. Pas çdo thirrjeje të tij soleta bënte gjysmë metri përpara.

Dikush e thirri që larg. Ai as që e ngriti kokën.

— O, hopa!

— Të kërkon një shok nga Tirana.

— Kush, more?

— S'e njoh. Një inxhinier është. Po pret në zyrë.

— Le të presë një çikë se s'u bë kiameti de... Edhe një herë... Safet, kujdes këmbët...

— Niko, shko, or ti, se e shtyjme ne — tha një nga punëtorët.

— Hajde, hop!

Ai që kishte shkuar ta lajmëronte rrudhi buzët e ngriti supet. Priti një çast e iku. Nikua s'u largua gjersa e nxorën soletën nga rruga. I dha ballit një të fshirë me shpinën e dorës dhe e hodhi pelicën kraheve. Diç mërmëriti dhe u nis drejt asaj së ndare të vogël të një godine të madhe që po ndërtohej, ku kishte një tryezë të sajuar dosido, një stol e një karrige të vjetër e të dalë boje. Muret ishin të pasuvatuara. Trualli gropa-gropa. Kjo pra ishte zyra e tij, siç e quanin. I ardhuri ishte strukur në gubin e tij të rëndë dhe nxirrte avull nga goja. Nikua fshiu duart e lerosura pas pantallonave dhe i zgjati të djathtën.

— Ç'kemi, or shok?

— Falemi nderit! — tha me përtesë e me një zë pa ngjyrë inxhinieri dhe rراسi përsëri dorën në xhepin e thellë të palltos. Si hodhi një shikim nga dritarja shtoi si me dëshpërim:

— Po pres përgjegjësin e objektit.

— Qenki mërziur si duket! Unë jam përgjegjësi i objektit.

— Ashtu!? — Njëfarë habie që i lindi vetëve-tiu aty për aty sikur ja shkundi plogështinë.

Nikua i zgjati paqetën mbushur mbarë e prapë me shifra e shënime:

— Ftohët këtej nga ne, hə? Andej nga ju më ndryshe. Punohet më mirë dimrit andej.

Inxhinieri ende s'po përmbledhej.

— Vajta ndërpreva betonimin se po fillon ngrica — tha Nikua. Po, kur pa se ai s'ishte i muhabetit, i ra drejt:

— Si e keni punën? :

— Unë jam inxhinier.

— Më thanë.

— Më është ngarkuar ndërtimi i një objekti.
— Ç'është?
— Një fabrikë... Po më rekomanduan të vija këtu për të parë si i përgatisni shtyllat e kapriatat. Ju i përgatitët vetë, këtu pranë objektit më duket.
— Vetë i kemi bërë parafabrikatet.
— Të gjitha?
— Pothuajse... Shumicën.
— Diçka pashë kur erdha. Kapriatat s'kishin dalë keq. Po ku i gjetët kallëpët, modelet?

— I bëmë vetë. Po, na lehtësuan shumë. S'ishte punë dhe ajo. Na vinin nga Elbasani, 160 kilometra larg. Vetëm për objektin tonë duheshin nja 300 rru-gë maqine. Bëj hesap tani... Kurse këtu vëru vin-çin e hop në vend. Pastaj, kur i ke materialet pranë të shkon puna sahat.

Inxhinieri hodhi sytë nga sheshi i mbushur me shtylla e kapriata betoni. Nikua e shoqëroi me një buzëqeshje kënaqësie.

— Edhe unë kështu do t'i bëj — tha inxhinieri.
— Të jep dorë shumë. Po ç'madhësi ka objekti?
— Komplet zë gati gjysmë hektari.
— Me sa korpuse?
— Një korpus ka të madh pastaj anekse, depo,

zyra.

— S'besoj të keni ndonjë zahmet të madh... Ma ha mendja që shumë-shumë nja dyqind treqind elemente ju duhen, jo më shumë. Kurse ne e kemi me pesë korpuse. Njëmijë elemente e zor se do na dalin.

— I keni skicat? Të paktën sa t'u hidhja një sy se mbase i ruani për ndonjë... — Dhe inxhinierit i shkau një buzëqeshje, që Nikos nuk i pëlqeu, por nuk i kushtoi rëndësi.

— Ç'sekret do ruajmë, o derëbardhë. Ja, or, ku i ke skicat.

Inxhinieri i mori, i hapi mbi tryezë dhe u përqëndrua mbi to.

— Gjëra të thjeshta. — tha Nikua.

— Kjo juaja po, kurse tipi i kapriatës sime do të jetë ndryshe. Është shumë e komplikuar, do më nxjerrë telashe — dhe shpalosi projektin që kishte me vete.

Shikimi i Nikos voziti një çast mbi skeletin e fabrikës në letër.

— Pse e bëni kaq të vështirë? Edhe ju në formë V-je i keni!

— Forma njëlloj është, por pa shikoni me kujdes krahët?

— Ja krahët, njëri katër metra e dyzet, tjetri pesë e gjashtëdhjetë. Dhe kanë afërsisht dy ton peshë. Ku është vështirësia?

— Si s'e kuptoni!? Soletat e mia s'mund të jenë kurrsesi si tuajat. Le pastaj kapriatat. Ju i keni krahët simetrikë. Veç kësaj keni përdorur konstruktion tri pjesësh.

— Ju mund ta pregatisni edhe të gjithën komplet. Ne e bëmë tri pjesësh, sepse përdorëm vinçin e vogël për t'i ngritur. Kurse ju s'është nevoja ta ndani më trish.

— E pamundur!

— Më falni që po ju pyes. Mos ma merrni për keq. A jeni marrë ndonjëherë me zbatim? — tha Nikua duke buzëqeshur, kur pa se inxhinieri po bëhej nevrík.

— Ky është objekti i parë, — tha inxhinieri dhe vërejti Nikon mos zbulonte ndonjë dyshim në sytë e tij.

Në zyrë hynë një grup punëtorësh. Hynë pa trokitur e pa ndrojtje, si në shtëpi të tyre.

— Niko, pjerrësia e tubave të shkarkimit në projekt s'është në rregull. Na del më pak se dy për qind. — tha një nga punëtorët.

— Të paktën duhet të jetë tre për qind. — pasoi një tjetër.

— Edhe puseta do spostuar pak nga e majta.

— Ne u vërtitëm e u vërtitëm po s'kemi ç'i bëjmë. E ka fajin projekti.

— E po si thoni ju? — pyeti Nikua.

— Ta shkelim projektin, ndryshe s'bëhet.

Nikua nxori një projekt nga sirtari i tryezës. Një nga punëtorët ndoqi një vijëzë me gisht.

— Tre për qind s'do të jetë keq — tha Nikua.

— Edhe pusetën spostojeni nga e majta.

Punëtorët dolën duke biseduar me njëri-tjetrin.

— Nganjëherë projektet kanë pasaktësira — tha Nikua.

Inxhinierit se si i erdhi nga ato që pa e dëgjo. Ndoshta ngaqë i kishin prerë fjalën në mes a kushedi. Nikua u përkul përsëri mbi skicat e kapriatave:

— Unë them që ju mund t'i bëni edhe njësh.

— Po ngritjen nuk e mendoni? Është e pamundur!

— Pse, bre inxhinier? Po të përdorni traun metalik për të fiksuar pikat e mbështetjes kur ta ngreni me vinç...

— Por mos harroni se krahët e mi nuk janë simetrikë. Ku t'i nxjerr pikat e mbështetjes?

Nikua se ç'llogariti mbi një copë letër.

— Afërsisht këtu do të dalin pikat e mbështetjes. Inxhinierit ju duk e udhës të mos e vazhdonte

më debatin, megjithëse e ndjente pushtetin dhe shkahtësinë praktike të kolegut.

— Çfarë formash keni përdorur për derdhje? — pyeti inxhinieri. — Unë kam ndër mend të përdor format prej druri. Mendoj se janë më të mirat.

— Mund të përdoren edhe prej druri po s'para kanë rendiment. Ne i kemi veshur me llamarinë.

Biseduan gjatë. Inxhinieri hera-herës rrate duart në xhepet e ngrohta të gubit, ndërsa Nikua vazhdimisht i shoqëronte fjalët me lëvizje të kokës e të duarve. Bënte skica e llogaritje. Nikua i bëri edhe disa vërejtje për projektin. Por një çast heshti e sikur u përmend. U kujtua që inxhinieri gjithmonë thoshte: soletat e mia, kapriatat e mia, objekti im. Kjo gjuhë i vriste veshin. Dhe si njeri që s'ta mban ç'ka për të të thënë, po priste rastin t'ja thoshte. I bëri nga një kopje të skicave të shtyllave e kapriatave dhe, mbasi u vuri dhe shënimet përkatëse, ja dha inxhinierit, i cili s'priti më po filloi të ngrinte gjakën e palltos për të dalë.

— Sidoqoftë do ta kem vështirë. Jam vetëm fare — u qa ai. — Po ju sa jeni këtu?

— Plot. Edhe ju s'do të jeni vetëm. Mos e merrni me frikë, inxhinier. Si ka thënë Majakovski? «I vetmi as trungun pesë pëllëmbë s'e ngre dot...»

— Majakovski s'bënte fabrika po vjersha.

Nikos ju duk përçmues toni i inxhinierit ndaj s'ju ndejt pa i thënë:

— Jo vjersha — këtu e zvargu zërin — por poezi betonarmeje.

— Sa vjet keni në ndërtim? — pyeti inxhinieri.

— Po i mbush nja pesëmbëdhjetë.

— Çudi! Dukeni shumë i ri. Kur e keni mbaruar shkollën?

— Vjet mbarova teknikumin e mbrëmjes.

Kjo ishte e papritur për inxhinierin. Ai gjithë kohën e kishte menduar se po bisedonte me një koleg. Kishte ndjerë një xhelozë të thellë profesionale për shkathtësinë e sigurinë e tij, po në fund të fundit e justifikonte me kohën e tij të gjatë të punës në zbatim. Kurse na doli një teknik me shkollë nate. Diçka desh të thoshte, por ajo ishte e pakuptueshme dhe shumë e ngatërruar. Lëshoi një buzëqeshje që s'i kuptohej domethënja dhe shtriu dorën e butë e të ngrohtë. Kur Nikua ja shtrëngoi me pëllëmbën e tij të ashpër, ai sikur u lirua nga ai komb i çuditshëm që i kishte zënë fytyrën. Dhe doli.

— Sukses! — e uroi me përzemërsi Nikua.

Ai e përsëriti edhe një herë buzëqeshjen pa domethënje dhe u çapit i menduar. Si u largua ca ktheu kokën pas. Nikua po bisedonte me disa punëtorë. Vinçi po ulte mbi shtylla një soletë të gjatë. Inxhinierit ju duk sikur ja lëshuan mbi shpatulla. Dhe vazhdoi rrugën nën peshën e saj.

ZENEPJA E BUKUR

Sapo hyri në sallën e postës ajo tërhoqi vëmendjen e të gjithëve. Ishte e bukur. Që nga flokët e verdhë krehur thjesht, balli i skalitur, mollëzat e faqeve si guacka deti, sytë me kthjelltësinë e një qielli të larë pas shtërgatës, mjekra e mprehtë, të gjitha tiparet krijonin tek ajo një harmoni që të ngacmon të shijosh mendueshëm të bukurën.

Ajo erdhi në postë bashkë me një shoqen time, Merin. Meri u ul pranë meje.

— Nga e paskë gjetur këtë shoqe të bukur?

— Të pëlqen?

— Shumë!

— Punojmë bashkë. S'ka një javë që ka ardhur. Është e mrekullueshme! Të paktën me kaq sa e njoh unë.

Meri i tha që të ulej me ne dhe unë u largova për t'i bërë vend por ajo buzëqeshi dhe u mbështet mbi banakun prej plastmase. Në gropëzat e syve të saj dallova ca si hije të zbета.

— I ka ndodhur një fatkeqësi — tha Meri .

— Vdekje?

— Jo u nda nga i shoqi.

— Pse? ?

— Për arësyen më të pa arësyeshme.

— Thahetheme? — pyeta i pasigurt duke

menduar se ato s'u mungojnë kurrë vajzave të bukura.

Në sytë gjysmë të mbyllur të Merit u duk një buzëqeshje e hidhur.

— Sepse është e bukur.

E papritur dhe e pakuptueshme!

Biondina lëvizte me nervozizëm gishtërinjtë mbi plastmasin e zi dhe të shëndritshëm të banakut. Bukuria e saj tani filloi të më dukej enigmatike.

— Sot kishin seancën e fundit të gjyqit — tha Meri. — Isha edhe unë. I shkurorëzuan.

— Kush ishte fajtor?

— Ai. Një mizerje...

Tani revolta kishte pushtuar gjithë qenjen e saj.

— Zenepja me Shkodrën, kabina dy — lajmëroi centralistja.

Biondina pa një herë nga ne dhe si këmbyen nga një buzëqeshje me Merin hyri në kabinë.

— Alo! alo! Po... unë. Ti, Sania je? Dëgjo! Sanie, ne u ndamë krejt... Si? Po, moj, krejt, krejt. Shpëtova, Sanie! Shpëtova!

Ajo fliste me zë të lartë, pa e çarë kokën që e dëgjonin të tjerët. Një çast bile m'u duk se thërriste që ta dëgjonin të gjithë. Fjalët e saj të fundit ishin vërtet një thirrje.

— Si ishin martuar?

— Me atë mblesëri që disa e quajnë dashuri. Ai kishte qenë nja dy javë me shërbim në fshatin e tyre. Zenepja punonte në mensën e kooperativës. Atij i pëlqeu. Dërgoi njerëz, e kërkoi dhe ja dhanë. Ajo as kishte këmbyer ndonjë fjalë me të.

— Alo! Djalin ma dhanë mua.

— Pastaj?

— U martuan. Javët e para kaluan me hyrjet

e daljet e miqve e shokëve. Beqiri ishte i kënaqur nga grua ja e tij e bukur. Edhe vjehrra s'kishte pse të qajej. Nusja ja mbante hatërin si jo më mirë, e si cupë fshati që ishte për punët e shtëpisë s'ja dilte kush. Zenepja priste e përcillte duke ndarë bonbone e sheribrand. Kështu shkuan javët e para. Po një natë ajo i tha të shoqit:

«Ç'po bën për punën time?»

«Ç'punë!?»

«A s'do hyj në një punë unë?!»

Ai kishte qeshur.

«Budallage! Përse bëhesh merak! Ti s'ke për të hyrë në punë kurrë. Unë rrogën s'e kam të keqe. Nëna ka pensionin e babait. Hëpërhë s'na duhen më shumë. Kështu që ti rri si zonjë në shtëpi e mos e çaj kokën. Unë ta thashë që ditën e parë të martesës».

«Kujtova se tallesh.»

«Mirë, mirë. Ja ku po ta them përsëri e vëri pikë këtij muhabeti.»

Dhe ajo bisedë u mbyll me aq. Zenepes s'i vinte mirë t'ja prishte aty për aty të shoqit, i cili dukej se kujdesej shumë për të. Dhe në familjen e tyre jeta vazhdoi si më parë. Zenepja lante rrobet, gatante, vadiste të vetmen vazo mullage që kishin në oborr dhe dëgjonte emisionin e përditshëm të radio vjehrrës: «Këshilla për nuset me barrë.» Në mbrëmje i shoqi i sillte gjithmonë ëmbëlsira. Asaj i pëlqente sidomos keku. Por megjithatë mendjen e kishte të puna. Në fshat kishte punuar disa vjet dhe për të tjerët s'kishte qenë e humbur. E vetmja gjë që e kishte ngrohur sadopak në martesën e saj ishte se do të vinte në Tiranë, në këtë qytet të madh, plot

gjallëri e lëvizje dhe ajo do të ndryshonte shumë. Kurse ditët e saj po kalonin të mbyllura. Beqiri rrallë e merrte me vete kur dilte. Dhe atëherë shkonin në ndonjë film apo shëtisnin vetëm. Një natë kishin vajtur në një lokal të bukur, ndriçuar me neon dhe kishin pirë verë. Kishte orkestër, dhe plot çifte kërcenin. Kishte kërcyer edhe ajo një herë me të shoqin. Ishte habitur pse e shikonin aq shumë njerëzit dhe i kishte ardhur turp. Kurse Beqiri dukej nervoz. Me të mbaruar kërcimi kishin paguar dhe ishin kthyer në shtëpi. Ajo kishte qenë një natë e bukur për Zenepen. Por shkonin muajt dhe ajo mbetej vetëm një natë, që s'po përsëritej më. Mëngjezeve merrej me punët e shtëpisë, pasditeve ndiqte sebetpet me vjehrrën dhe mbrëmave i shoqi i sillte kek. Ajo s'i kishte parë, por me të dëgjuar e dinte se shokët e Beqirit dilnin shpesh bashkë me gjithë gratë, ose mblidheshin herë te njëri e herë te tjetri dhe kalonin mbrëmje të gëzuara. Dhe habitej pse i shoqi e mban-te larg këtyre njerëzve! Po sidomos asaj i punonte mendja te puna. Dhe këtë filloi t'ja përmendte gjithmonë e më shpesh. Por ai i fliste i ngrysur dhe ftohët. Ajo ende s'e kuptonte. Dhe më në fund ai i tha një natë:

«Vetë e ke fajin.»

Zenepja e kishte parë në sy.

«Je shumë e bukur!»

Fjalët e tij dolën si duke kërcitur. Ajo u shkuq prej turp-it, sikur të ishte lakuriq para një të panjohuri.

Ai ulëriu papritur:

— Unë kam frikë! Dëgjon ti, apo jo?

Më mirë ta kishte sharë. Fundja edhe ta kishte qëlluar. Do ta kishte duruar më lehtë se atë fyerje

të rëndë. Dhe ditët e javët kalonin në topitje. Ajo i tha të mos i sillte më kek. Kishte filluar ftohja. Megjithatë ai saherë vinte nga shërbimi i sillte copëra të bukura e të modës. Garderoba e saj e mbushur plot i ngjante një vetrine të mbyllur rrobave qepësie. Por ajo donte punë. Donte jetë. Dhe s'mund të duronte dot më:

«O më gjej punë, o do të gjej vetë.»

«Po të pat ikur mendja!»

«Po më ikën këtu. Nuk rri dot më kështu.»

«E ku merr vesh ti, moj e gjorë! Je mësuar në fshat ti! Këtu të qepen njerëzit e s'të ndahen. Ti je e bukur! Ty do të të...»

«Mos!» — Ajo i zuri gojën me dorë dhe qau e fyer, e zemëruar. Dhe tha përmes lotësh:

«Si s'ke turp!»

«Ti s'merr vesh nga jeta... Ka njerëz të poshtër... Kam frikë!»

Ai u afrua ta përkëdhelte. Dora e tij i dogji hidhur, si na djeg të ftohtët e një cope akulli. Dhe e urreu atë çast. Të nesërmen shkoi në komitetin ekzekutiv për të kërkuar punë. S'pyeti se ku. Veç punë të ishte. Të dilte nga shtëpia, të jetonte. I shoqi e kishte marrë vesh. Në mbrëmje plasi përsëri shamata:

«Nuk ke për të shkuar në punë!»

«Kështu nuk mund të rri dot më.»

«Të kam marrë për vete... Ta kam thënë që ditën e parë. S'ka punë për ty! Dëgjon apo jo?»

«Nuk dua të të dëgjoj më.»

«Pse s'thua atëhere që ta ka qejfi të...»

«Si s'ke turp!»

Atë natë ai e qëllloi me pëllëmbë dhe i tha se

s'kishte për të dalë nga shtëpia. Megjithatë ajo priste ta lajmëronin për të filluar punën. Në komitet i thanë se do t'i përgjigjeshin shpejt. Nuk e dinte ajo se i shoqi kishte vajtur dhe i kishte hequr vizë emrit të saj.

Pas dy muajsh lindi djalë. U gëzuan të tre sipas mënyrës së tyre. Ai përsëri i çoi kek në maternitet. Dhe përsëri ajo as e shpëstolli. Kur u kthye në shtëpi, ai i tha:

«Më çave veshët, punë, punë. Se ishe mërzitur demek. Ja, tani do të merresh me djalën».

Ajo s'foli.

Beqiri i ledhatoi flokët. Nga dora e tij nuk kishte shkurirë akulli. Djali u bë një muajsh. Ajo shkoi përsëri në komitetin ekzekutiv. Emri i saj nuk gjendej. Dikush i tha se e kishte shuar i shoqi. E regjistruan përsëri. Ajo u tha se askush nuk kishte të drejtë të shuante emrin e saj. Në fund të javës e lajmëruan. Në fillim të muajit tjetër do të fillonte punën. Ai u bë si i çmëndur. E fyti, e shau, e kërcënoi. E vjehrra i zbrazti ca fjalë të ndyra. Pastaj i tha të birrit:

«Të thashë... Mos e merr të bukur se do gjesh belanë. Të bukurat janë...»

Zenepja u skuq e tëra dhe u habit se si mund ta nxirrte goja e një gruaje atë fjalë. Dhe s'mund të rrinte pa ja kthyer. Ai e qëlloi përsëri dhe i tha prerë:

«Po vajtë në punë, këtu nuk shkel më!»

Ajo nuk qau më. Të nesërmen shkoi në gjyq dhe kërkoi shkurorëzim.

Meri mori frymë thellë.

— Dhe unë pashë një nga ndarjet më të çudit-

shme. S'më ikin nga mendja fjalët e tij, kur po dilte nga gjyqi. Dikush e pyeti:

«A të kërciti gjë këtu brenda nga kjo që ndodhi?»

«Zëre se m'u thye një vazo kristali!»

— Ç'poshtërsi!

Meri mori përsëri frymë thellë.

— Alo! Si the, Sanie? Në Shkodër? Jo. I thuaj babës se do të rri këtu. . . Po. Për gjithmonë. Hiç mos keni merak. Jo, jo, këtu do të rri. Ata atë duan, që të mërzitem e të iki. Si the? Ushtar? E di që ikën Skënderi po nuk vij dot. Kam filluar punën. Skënderi le të vijë po të dojë. Unë kam dhomën time. Si? Djalin e çoj në çerdhe. . .

Në sallë ishte qetësi. Të gjithë dëgjonin atë. Centralistja pa orën. Tri minutëshi kishte kaluar me kohë, por ajo s'desh ta ndërpriste atë bisedë me zë të lartë.

— Që femra të bëhej fatkeqe edhe nga bukuria, kjo është e tmerrshme. — i thashë Merit.

— Ajo s'e duron dot t'i thuash fatkeqe.

— Alo! Djali, the? më ngjan mua.

— Sa mirë! — thashë me vete dhe s'e di pse u gëzova aq shumë.

Kur doli nga kabina Zenepja ndeshi në sytë e të gjithëve. Dhe nuk u turbullua aspak. Hijet kishin ikur nga sytë e saj. Buzëqeshi dhe i futi krahun Merit.

— Natën e mirë!

— Natën e mirë dhe ti, Zenepe e bukur!

Më erdhi inat që kishte atë emër të vjetër.

Gjithë atë mbrëmje kërkova një emër të bukur për djalin e sai.

... PËR TRENIN DHE PËR GRURIN

E kush e mbante xhá Hyskën atë natë! Ishte bërë me fletë, si i thonë fjalës. E sillte cigaren e trashë me duhan gërxhall nëpër gishtërinjtë gungaçë, kruante mjekrën e kuqërremtë që i ngjante një cope lëkure dhije të porsaqethur dhe bënte ç'bënte i thoshte djalit të mesmë, Musait:

— Demek, punë e mbaruar thua? Do të na ardhka i uruari!? — dhe priste kushedi për të satën herë aprovimin e tij.

— Aman, bre baba, po akoma s't'u mbush mendja? Kjo mbaroi ti... akoma. Nga maji me sa dëgjo-va fillojnë punimet.

— Po thua, o të shkretën, që shpëtuam de... — dhe sillej nga e shoqja:

— More vesh apo jo, plakë... ë!? Do të na shkojë shemendeferi mu...

— Baba! — e kujtoi për diçka djali i pleqërisë.

— E, de, e, sikur s'e di unë... treni... Po e thashë ashtu turçe a arapçe ç'është, për të tëmë... Dëgjon plakë!? Do na shkojë treni përpara fshatit... Le e le po do na u bëka edhe një stacion këtu ndër ne... Tashti një e dy e zotrote në qytet — Dhe përsëri ju kthye të birit:

— Musa! Po biletat sa thua të jenë. Shkruante gjë gazeta, a?

I biri qeshi.

— E, or, po ty si ta merr mendja. . !

— Ku e di unë, o baba! Po mund të jenë një lek e gjysmë... Shumë shumë dy.

— Hiçgjë, badiava, thua. . . Shpëtuam, për përrëndi!

— Baba! — e kujtoi përsëri djali vigjilent i pleqërisë. një trembëdhjetëvjeçar çapkën, që s'i kishte lënë gjë të atit nga fytyra, sikur ta kishte nxjerrë për hundësh.

Kjo sikur ja preu hovin plakut dhe mbeti një hop në heshtje me sy të pulitur e me dorë në mjekër. Mendonte Hyskë Vatha. Mendonte dhe gëzohej:

«S'i thonë shaka të të vijë treni në fshat. Tashti më s'do bëjmë nga dy sahat rrugë për të dalë në xhade të maqinave të minierës. Të bie halli, se të gjallë jemi, njerëz jemi, një e mirë, një e keqe, fap biletën, shtriu atje në kolltuk... Ohoho... e ku të duash të shpie... Apo s'është i sagllamtë, i shkreti! Minutën s'e lot siç thonë... Apo i rehatmë... Shkon si njeri, bre. . .»

Mendonte Hyska dhe kruante mjekrën si lëkurë dhije.

Herë luante kokën. Herë harronte dhe fliste me vete. . . Ishte qejf e gaz i tëri.

— Po është i mirë, bre, i uruari... Apo i madh... Hajde, bir, hajde... tërë ai gollozdrum... Kushedi sa merr?

Dhe pa Musain në bebëz të syrit.

— Nja pesëqind e ca. . . Në mos më shumë — tha Dukja, më i madhi i djemve të Hyskës.

— Jo. . . O! — Dhe prapë vështroi të mesmin se si më i shkathët e më me shkollë që ishte kishte më shumë besim tek ai.

— Njëmijë i merr pa frikë — tha i sigurtë Musai.

— Ua, shiko, shiko! Demek fshatin tonë e merr me dhi e me mace e me qen, e... hajde, ç'ka bërë frëngu, ju mbylltë dera...

— Këtë e ka bërë kinezi — u hodh i vogli.

Hyskës atë natë s'ja kishte qeifi thumbat e të birit, që vetë ja kishte mësuar dhe kënaqej me të mbrëmjeve. Ai donte të ngopej me gazin e tij.

«S'i thonë shaka, bre... të të vijë treni në shtëpi. Të zë e mira a e keqja, mbaron punë fët e fët. Pastaj, ndryhe do jetë dhe fshati. Le po do ketë edhe një stacion. Ka të mira kjo punë, o byrazer...»

Ai u përmend.

— Si, si?

— Jo, mo, nëna pyeti se nga ç'anë do shkojë treni — tha i mesmi i djemve. — Ku ta di unë.

Hyska puliti përsëri sytë dhe shikimi i tij përfshiu tërë fshatin.

— E nga do shkojë, o t'u mbylltë, andej poshtë nga stallat? Hë, më thuaj ti, nga do shkojë tjetër? Andej vendi vjen më i rrafshët. Pastaj del te Guri i Kuq dhe merr përposhtë grykës së Shkozës.

— Këto i dinë ata që bëjnë projektet — kundërshtoi i biri.

— Dëgjomë, bre, mua ti. I di unë si hapen rruget. Në kohë të ushtarllëkut më ka rënë bretku mua.

Pastaj e mori mashën dhe filloi t'u shpjegonte të bijve dhe gruas duke hequr vija mbi hirin e vatrës.

— Ja, do dalë që këtej... Kështu... u... Hop... Do shkojë rrëzës e rrëzës, pastaj vjen këtu... u... drejt e drejt, merr nga kodra e futet grykës.

— Kështu si thua ti do t'u bjerë stallave për-
mes — u hodh Dukja.

— Jo, jo, jo... do shkojë më poshtë. Po mua
ma ha mendja se te stallat do ngrihet stacioni.
Më të mirë vend s'ke ku gjen. E po fundja treni
të vijë, pa pyesim ne për stalla. I ngremë të reja...
andej nga lëmenjtë. Ja, këtu...

Duke vizuar me mashë ai dëgjonte drang-dun-
gen dhe xhuf-xhufet e trenit. Atë natë fjeti nën
ato ritme të reja për pesëdhjetë e kusur bukët që
kishte ngrënë duke ngjitur e zbritur ato shpate.

* * *

Kaluan tre muaj. Ndoshta ajo natë nuk u përsërit
më por treni tani kishte hyrë në familjen e Hyskës
dhe në gjithë fshatin. Për të bisedohej përditë, hiq-
shin viza mbi tokë në kohën e pushimeve të punës,
diskutoheshin oraret e kalimit të trenave, format e
stacionit, bile të gjithë kishin bërë kushedi sa e sa
udhëtime imagjinare. E pra treni që do të vinte në
këto anë pas dy-tre vjetësh e kishte freskuar që tani
jetën e fshatit me fishkëllimat e tij gazmore. Fshata-
rët mezi po prisnin të fillonin punimet. Hyska ishte
gati të vinte bast me të gjithë se rruga e hekurt do
të kalonte andej nga thosh ai, dhe se duhej men-
duar që tani për stallat e reja.

Dhe një mesdite...

Maji sapo kishte hyrë në javën e dytë, por mo-
ti kishte marrë për mbarë e dukej si mes qershori.
Meqë punën e kishin patur aty pranë, Hyska me
të shoqen e me djemtë ishin kthyer e kishin ngrënë
drekën në shtëpi... Si kishin mbaruar së ngrëni ai

qe mbështetur pas gardhit, thithte cigaren e trashë dhe i kishte ngulur sytë grurit të kopështit të tij. Bima kishte mbirë e dendur, qe rritur e shëndetshme, me ato fletët jeshile të errëta që të ngrohnin zemrën dhe tregonin për prodhime të mbara.

E shihte e s'ngopej dot Hyska. S'kishte në fshat grurë si të tijin. Ama punën s'ja kishte kursyer. Tokën bukëvale e kishte bërë kur e mbolli, farën e zgjodhi nga më e mira e barin ja qëroi rrënjë për rrënjë. Nja katër kuintalë do t'i merrte si një e një bëjnë dy, por atij i ndjente zemra për më shumë.

Mendonte Hyska dhe s'kishte vënë re se dy të panjohur kishin hyrë në mes të arës, ishin përkulur aty e seç jepnin e merrnin me njëri-tjetrin. Veç kur dëgjoi ca goditje sqepari mbi dërrasë Hyska u përmend dhe u habit me veten. Si ishte e mundur! Në grurin e tij s'kishte hyrë një pulë, dhe ja tani futeshin njerëz të panjohur ashtu fare papritur, pa e pyetur dhe pa çarë kokën për të. I hipi gjaku në tru dhe u nis ledhit me hap të shpejtë.

— Hej, ç'bëni aty, ju, more... More, juve po ju them... Dëgjoni apo jo, mo... — E lëshoi zërin deri në fund pa e ndalur hapin. Të panjohurit sec pëshpëritën dhe qeshën nën buzë. Pastaj hodhën sytë tutje nga përroi dhe i bënë zë dikujt:

— Në rregull, në rregull, hajdeni!

Hyska u qe afruar. I theri në zemër kur pa se ata i kishin rënë grurit përmes dhe e kishin bërë lëmazhdë. I kërcyen damarët dhe dhëmbët i kërcisnin.

— Ç'bëni, more, aty — u thirri që nga ledhi.

— Mirë dita, xhaxho! — ja ktheu qetë qetë një nga të panjohurit, një djalosh me fytyrë të brishtë e me sy të qeshur.

— More je në vete ti, apo jo... Hyn më prish grurin e më thua mirë dita, pa le! — Dhe u sul drejt tyre. I panjohuri tjetër vinte më i bëshëm nga trupit dhe ishte muskuloz por edhe ai i qetë dhe i qeshur si shoku i tij. I doli përpara Hyskës duke mbajtur me duart pas shpine një copë makaz me një vizë të kuge që sapo kishin filluar ta ngulnin.

Ai me fytyrë të brishtë bëri nja dy hapa më tej pa çarë kokën se po shkelte grurin. Hyska u tërbua fare.

— More, lojtët nga mendtë ju, apo ç'është kjo?..

— Ngadalë, shok, ngadalë, mos u nxeh.

— Or po qenki tuafë, o ju mbylltë... Si, ore, të mos nxehem? Mua më kanë rënë kockat, ju...

— Xhaxho, do të të japin tokë gjetiu — tha ai më i dobëti.

— Merrni, or, këto takravatet dhe hiqmoni këtej, oj! Më hyni si në mall të babait...

Hyska kishte marrë zjarr e hajde ta shtroje... Po për fat të dy djemtë kishin qëlluar të urtë e të duruar. Ai ju sul makazit.

— Dale, një herë, të merremi vesh — foli ai më i shëndoshi dhe s'e la të bënte ç'kishte menduar... Ne jemi gjeometra, byrazer.

— Oj, po akoma ky, ore... Po perëndi s'qenki?..

— Prit një herë, or vëlla. Ne po piketojmë rru-gën e trenit. More vesh? Hekurudhën...

Hyskës ju prenë krahët. Fytyra e tij e egërsuar, u zbeh. Zbrazti frymën dhe u kërrus pak nga pesha e së papriturës. Djaloshit se si i erdhi, kur pa se e mbuluan djersët ballin e fshatarit.

— Atyre që u shkon hekurudha do t'u japin tokë tjetër — dhe zëri i gjeometrit u bë edhe më i butë.

Djaloshi me fytyrë të brishtë ja kishte ngulur sytë Hyskës dhe ju duk sikur i erdhi keq për të...

Hyska heshte, gëlltitej, djersinte, zbehej dhe shikonte grurin e rrafshuar përtokë. Edhe të tjerët heshtën gjersa foli ai.

— Mos e keni gabim, or djema... Hekurudha shkon matanë fshatit. Andej është vend i rrafshët.

— I sheshtë, po këtej shkurton gjysmë për gjysmë.

— Pa shikojeni edhe një herë, bre... Dëgjomëni mua... Do e keni gabim. — Në zërin e tij tani kishte dhembje, shumë dhembje dhe pak shpresë.

Ndërkohë në krye të arës doli një burrë rreth të tridhjetave që mbante në sup një dërrasë të gjatë me vija të kuqe e të zeza dhe numra. Pas tij vinte Zydiu.

— Ti kot shqetësohesh. Kooperativa do të të japë tokë tjetër. — Dhe gjeometri trupmadh u mundua të buzëqeshte. Po ku ngjiste buzëqeshja e tij! Hyska ishte bërë i gjithi zeher.

I shtiu sytë të birit. Edhe ai buzëqeshi. E ndjeu trupin të rëndë dhe gjunjët të këputur. Gjeometrat u kthyen të vazhdonin punën. Atij ju përpëlit gjuha disa herë në gojë dhe nxori një si belbëzim.

— Po... sikur... nja njëqind metra më poshtë — tani zëri i tij kishte lutje, shumë lutje.

Por i biri kishte marrë sqeparin dhe i binte pike-tës sa i hante krahu. Hyskës ju këput belbëzimi. Pas çdo goditjeje të sqeparit ai sikur mblidhej, sikur kërrusej dhe djersët në ballë ju ftohën.

Një nga gjeometrat provoi piketën nëse luante. Grupi u përshëndet me plakun dhe vazhdoi rrugën drejt, nëpër grurë. Me të iku dhe i biri. Ai e ndoqi me sy gjersa dolën nga kopështi i tij pastaj shikimin ja turbulloi një si perde që ju var nga poshtë kapa-

këve. Mezi e ktheu trupin e tij të rëndë e të këputur. U nis drejt ledhit duke i rënë grurit mes për mes. Nëpër gishtërinjtë e tij të hapur si krehër fëshfërinin bimët e shëndetshme. Dhe përmes asaj fëshfëritje ai dëgjonte trenin.

«Drang-drung, xhuf-xhuf. . .»

— Si s'u dhamë nga një kupë dhallë atyre djemve — i tha e shoqja.

Ai heshtte dhe çapitej rëndë.

Nëpër dejt e tij kalonte treni.

SHËRBIMI I PARË

Binte shi, një shi i imtë e gënjeshtar që s'ta mbushte syrin por që të bënte qull.

Si qëndrova një copë herë në mes të udhëkryqit, me veshë ngrehur se mos po dukej ndonjë maqinë u futa nën strehën e dyqanit që shërbente njëkohësisht edhe si pikë shitjeje për bileta udhëtimi. Për drej, maqinat s'dukeshin gjëkund. Kishin kaluar nja tri a katër, bile njëra prej tyre për andej nga desha të shkoja unë, por edhe ajo me ngarkesë. Vendet e para i kishte të zëna.

Kisha mbaruar punë në kooperativën aty pranë e tani më duhej të shkoja në rrethin fqinj. Dhe prisja. Për herë të parë po e provoja sa e mërzitshme ishte pritja në një udhëkryq të ftohtë, nën një shi monoton si muhabet i përgjumur netve të dimrit, pa patur në mos një shok, të paktën një të panjohur për të këmbyer dy fjalë. Të hyja në dyqan kisha frikë se mos më kalonte ndonjë maqinë e pastaj më rruat muhabeti, megjithëse s'pata shumë kohë të merresha me këtë mëdyshje, të hyja a të mos hyja sepse pas pak dyqanxhiu doli, vari «Tutiusin» e rëndë mbi derën e dyqanit dhe ngriti jakën e palltos ushtarake. Ishte me një sy. Në skaj të ballit kishte një shënjë plage si një gjysmë drapëri.

— Tani dimrit s'para lëvizin maqina këtej nga ne — më tha miqësisht.

— E po udha i ka këto...

— Shoferët i kemi të mirë. Po të thashë, është koha që s'para ka maqina...

Ai u nis me një hap të hallakatur dhe pa zgjedhur shumë se ku shkelte. Vërshëllente me qejf një melodi popullore mjaft të njohur të muajve të fundit.

E ndoqa me sy gjersa u var poshtë bokës e pastaj sytë ja ngula «Tutiusit» të ftohtë sikur të kishte ai fajin që më la në vetmi të plotë. Shiu vazhdonte me të tijën si një përrallë e stërzgatur monotone. I rashë disa herë nga kreu në fund atij rripi të thatë toke nën strehën e dyqanit dhe një herë padashur i kisha numruar hapat. Në të kthyer i numrova përsëri. Më dilnin më pak. Pa e kuptuar as vetë kisha hapur punë. E përsërita të paktën nja dhjetë herë matjen e gjatësisë së dyqanit me hapa.

— Ty-ty-ty...

Boria vinte e largët. Mbajta vesh gjatë, por prapë e kisha të vështirë të përcaktoja drejtimin e maqinës derisa pashë një fragment të dy fashave të dritave mbi kodër. E lashë strehën dhe me shpresë se do të lija edhe vetminë u sula në udhëkryq. Por përsëri kot. Shoferi si duket më kishte vënë re që larg. Lëshoi timonin dhe më bëri shenjë me një kryqëzim të duarve duke ngritur supet:

«Ç'të bëj!? Shikoje vetë, s'kam vend!»

Përsëri nën strehë. E lashë matjen e dyqanit dhe po mendoja për atë gjurmë plage mbi ballin e shitësit. E çfarë nuk sajon në një vetmi si kjo e imja? Andej nga u duk maqina e parë dëgjova një bori që binte me intervale.

«Ç'të jetë!?!» — mendova. «Le që o janë të sigur-

të këtej nga karambolet shoferët o s'ka rrugë.»

Pastaj më pëlqeu të mendoja si kalama se ajo maqinë kishte dalë për të më kërkuar mua dhe se boria e saj po më thërriste. Maqina ishte ende larg kur zura mesin e udhëkryqit, si polic trafikui. Shoferi e ndali maqinën pa pritur t'i jepja shënjë.

— Ku? — më pyeti dhe nxori kokën nga kabina.

— Në B. . .

— Paske rrugë të gjatë, s'të çoj dot. Po deshe gjer te Ura e Selës. Për mua hipë. Atje lëvizin shumë maqina. Do të gjesh një se s'bën. Si të duash... Unë kaq kam në dorë — dhe ngriti supet si për t'u shfaqësuar. Priste përgjegje. Unë si i pamësuar në udhëtime s'dija ç'të bëja.

— Hipë, bir, hipë! — tha pasagjeri plak në krah të shoferit.

Hipa.

Me të vënë dorën në spondin e prapëm dikush më kapi për krahun për të më ndihmuar. Brenda, nëpër terr lëvizën silueta. Ai që më kishte ndihmuar s'ma lëshoi krahun derisa u ula.

— E? — pyeti shoferi.

— Jepi — ja ktheu dikush.

Maqina filloi të lëkundej nëpër gropëzat e rrugës. Ishte një kamionçinë e vogël mbuluar me mushama. Karrocëria ishte mbushur plot dhe rrinim shtrënguar. Një herë, shoferi, që po e ngiste shumë shpejt maqinën si duket s'mundi t'i shmangej një grope nga krahun im. Më zuri koka në një nga hekurat që mbanin mushamanë dhe lëshova një «Të martë dreqi, të martë!»

— Mos u mërzit, se ashtu e kemi punën — më tha një nga bashkudhëtarët dhe më ra shpatullave Boria vazhdonte të binte herë pas here sikur

ajo maqinë të kishte dalë për të mbledhur gjithë ata që i kishte zënë nata rrugëve.

Në maqinë ishte errësirë. Ato rreze të mekura që hynin nga kabina e shoferit s'mjaftonin as për të ndarë mirë siluetat njëra prej tjetrës.

Pas pak dikush nxori paqetën dhe e kaloi dorë më dorë. Në maqinë filluan të ndriçonin shtatë-tetë xixëllonja. Me ç'munda të kapja nga ndriçimi i tyre vura re se në përgjithësi bashkudhëtarët e mi kishin tipare të ashpra. Kurse nga ato pak fjalë që ishin hedhur deri tani kisha mësuar se ata po bënë një udhëtim të gëzuar dhe ishin ose të afërt ose shokë me njëri-tjetrin. Dikush ja nisi një këngë të asaj krahine. Ju përgjegj një i dytë dhe pasoi isoja në tre zëra. Fjalët dridheshin nga lëkundjet e maqinës.

Kënga ishte shkrepjsja për t'i vënë zjarrin gazit e muhabetit.

— Jo, or Keno, jo — ja pat një zë basi!

— Të kanë hyrë ethet që tani më duket... Aha...

— Po s'tu drodhën gjunjët ty, mua... të më preç kokën.

— Mos ngatërroç radhën kur t'u japësh dorën se na turpërove...

— Unë ta kam bërë këngën gati...

— Epo merrja, or de... të shkretën...

— Jo, or, jo, kur t'ja shtrojmë...

— A ja ke qëndisur mirë?

— Me sa kam mundur e...

— Një e hidhte e tjetri e priste fjalën në çast pa e lënë të këputej muhabeti. Flisnin shkujesur, pa i zgjedhur fjalët e pa u menduar t'i rendisnin bukur, siç bëjnë disa kur udhëtojnë me ndonjë të panjohur.

— E shiko, kur të shkoç ta marrësh mos m'u capit si mushka e Zalos... Mblidhi ato të uruara këllqe...

— Rri, or djall! Unë jam në hall, ti!..

Ky ishte zëri i Kenos, më i ndruajturi i të gjithë zërave.

— Po ç'do thuash, ç'do thuash, aman?

— Këtij ju lidh gjuha që tani!

— Pse, kollaj të duket ty? — u dëgjua prapë

Kenua.

— E, or, e, sikur s'ta ka qejfi ty...

— Ke vënë edhe kapistall pa le...

— More po edhe si era kolonjë po na vjen, ë?

— Rri, Dhimo, për kokën tënde...

— Lëri, more, ato... Këtë, këtë që të themi ne... Të mbajmë për trim, de, po shiko mos na bësh ndonjë proçkë, t'u mbylltë, se na djallose.

Dikush psherëtiu. Të tjerët ja dhanë gazit.

— Oho... Këtij i iku gjaku që tani...

— E kam thënë unë, s'je ti për këto punë.

— Ti e ke thënë një herë unë njëqind herë...

Ju vetë e ngatërruat këtë mesele... E tani bëni hallatke me mua... Domosdo... — Kësaj here zëri i Kenos ishte ankues.

S'po orientohesha dot nëpër këtë bisedë, e cila me sa dukej ishte vazhdimi i një bisede të nisur kohë më parë e që ndoshta ishte ndërprerë kur shoferi ndaloi maqinën për të më marrë mua. Vetëm njëri nga bashkudhëtarët, ai që ishte përballë meje, s'po fliste, vetëm se merrte pjesë gjallërisht në gazin e tyre.

Me ç'ma preu mendja duhet të ishte punë dasme.

— Do të jenë të largët — thosha me vete -- shkojnë që sonte të shtunën mbrëma dhe nesër kthe-

Nen me gjithë nuse. Nganjëherë Kenos i qaja hallin se m'u kujtua një kushëri im që e bënë për ujë të ftohtë me romuze e me shpoti të tilla. E hutuan fare dhe ai këputi një gafë në çastin kur mori nusen sa akoma e sot kur e kujtojmë s'ngopemi së qeshuri.

Shiu në të tijën, maqina po me gazin në dërrasë, boria ty-ty-ty, ty-ty-ty-tamam për dasmë. Muhabeti sa vinte e ndizej.

— Ta dija... — diç desh të thosh Kenua, por u përmbajt.

— Tani e shkele fare.

— Po ç'taksirat të duroj tërë këto tuajat?!

— More këto s'janë gjë hiç, po atje, atje si do bësh ti?

— E hap sytë, se ma ke atë dorë si darë nallbani, mos fillosh dhe aty shtrëngo e bot si me ne de...

— E... e, — shtoi Kenua.

— Je në siklet? — bëri sefte në muhabet ai që kisha përballë...

— Lëre mos e pyet, byrazer... Kam kaluar të mira e të liga plot po më ngushtë se sot s'e kam parë kurrë veten... Këta qeshin... Ç'ke me këta ti... Unë do dal aty si në ekspozitë... Këta...

— Hë, se e ke hak, e ke hak... Lëre modhestinë.

— Jo, bre, po këta ma bënë... Këta më ngatërruan... Pa të kem t'i shoh në këmbë time pa pastaj flasim ne... Dil tashti atje në mes të njerëzve si në ekspozitë... Sikur... Kur vjen puna në brigadë të lavdërojnë e të skuqen veshët, jo pastaj...

— Kot që s'morëm «doktorin» ne... u dëgjua prapë basi... Dale, dale, nëma dorën këtu... Thashë unë, kot që s'e morëm... Djersë të ftohta, për ideal, djersë... Mblidh, or veten, t'u mbylltë, sikur po të shpiem në gjyq...

— Pse e vogël të duket ty, a?

— Lëre ç'flasim ne, po unë të jap hak... Me siklet është, or byrazer... E kam provuar vetë unë... Ti e the mirë, tamam si në ekspozitë të duket vetja... Tërë sytë aty i mbajnë... Dëgjo lëvdata e bot, shtrëngou duart të tërëve, puth këtej, përqafo andej... Lëre mos e pyet...

— Posi, ore, po...

— S'na thatë gjë hiç...

— As të lavdëron, as të puth e as të përqafon njeri kot... Hakun të jep...

— Hakun.

— Po s'e sheh?! Unë i rënë nga qielli.

.....

— Merrja një herë, o Stefi, asaj, që ja ke qëndisur këtij kapedanit, aman...

— E thashë unë, kur t'ja shtrojmë...

Shoferi ngadalësoi shpejtësinë, frenoi dhe trokiti në xhamin e dritares së vogël midis kabinës dhe karrocerisë.

— Ura — thirri dikush.

U urova udhë të mbarë të tjerëve dhe zbrita. Zbriti dhe ai tjetri që ishte përballë meje pasi shtrëngoi një dorë nëpër errësi dhe tha:

— Urime!

Unë sa nuk e pasova me një :

— Të trashëgohesh!

Por maqina u nis. Mori një kthesë dhe u zhduk. Ne hodhëm disa hapa në heshtje.

— Nga ju kemi? — më pyeti bashkudhëtari.

— Gazetar! Jam me shërbim. Po ju?

— Gjeolog...

Shiu vazhdonte si dhe më parë, i imtë e pa patur

ndër mend të pushonte e as të ndërronte ritëm, si ata që dinë të kërcejnë vetëm tangon e që janë gati ta vazhdojnë atë deri në mëngjez nga frika se mos orkestra merr valsin. Veç këtu ja prishte nganjëherë monotoninë era e grykës së lumit që frynte me hope.

— Ç'do të shkruani? — pyeti përsëri tjetri.

— Diçka për heroizmin e njerëzve tanë... Nëse ju ka rënë në sy, kemi një rubrikë të posaçme...

— Po... Nganjëherë del interesante...

Përsëri disa hapa në heshtje dhe përsëri bisedën e hapi ai:

— Pse nuk shkruani për Kenon dhe për ata të tjerët?

— Urdhëro?

— Shkruani për ata punëtorët, them, me të cilët bëmë një copë rrugë. Mund të dalë një gjë e bukur.

— Edhe mund të dalë, po... siç ju thashë dua të shkruaj për heroizmin, për ndërgjegjen e lartë, për... si të thuash... për thjeshtësinë e njerëzve me shpirt të madh. Ndryshe puna e dasmës... Pastaj, ndonjë element të dukshëm të së resë s'vura re... Kështu i ka ndodhur edhe një kushëritim tim këtu e ca vjet të shkuar...

— S'ju kuptoj...

— Për ata të maqinës e kam fjalën... S'di ç'vlerë mund të kishte për shembull një shkrim me një përmbajtje të tillë:

«Shqetësimet e një dhëndrri...»

Ai qeshi.

— Me sa duket jeni gazetar i ri?

— Po.

— Ndryshe s'do t'ju kishte shpëtuar.

— Kush?

— Tema e shkrimit tuaj. Ju udhëtuat me të më se gjysmë ore dhe e latë t'ju ikë për duarsh. Ju mungon nuhatja. S'besoj të më keqkuptoni... Ju e përkufizuat mirë atë çka mësuar në maqinë. Veç bëtë një gabim... Fundja mund ta quash edhe hero... Pse jo? Shqetësimet e një heroi, ose diçka të afërt me këtë.

— T'ju them të drejtën unë i mora për dasmorë e Kenon për dhëndërr. Bisedat e fillimit këtë përshtypje më lanë... Pastaj u mundova të mendoja për shkrimin tim dhe nga fragmentet e tjera të bisedës s'mësova ndonjë gjë të re. Veç, ju thashë, shqetësimet e një dhëndri që shkon të marrë nusen.

— Shqetësimet e një heroi që shkon të marrë Urdhërin e Punës... Unë kisha ndonjë çerek ore para teje që udhëtoja me ta... Mbase në vend tënd ashtu si mori biseda as unë s'do i kisha rënë dot në të...

— Dhe si është puna?

— Ata janë punëtorë të një sektori të thellë të sharrave. Kenua ca kohë më parë shpëtoi një shok nga vdekja përmes tufanit, a një maqinë nga gremisja... S'e di me saktësi po afërsisht diçka e tillë do jetë. Kishte rrezikuar jetën. Këto ditë ka dalë nga spitali. Sonte në qendër të ndërmarrjes organizohet një mbrëmje për nder të tij. Do t'i dorëzohet dhe Urdhëri... Po kishte një thjeshtësi të çuditshme.

— Tani e kam të qartë — thashë unë dhe instinktivisht ktheva kokën andej nga qe zhdukur maqina. Gjeologu e kuptoi.

— Iku tani ajo. Më këmbë ndërmarrja është larg prej këtej dhe mbi të gjitha zor për ta gjetur

në një natë të tillë. Por diçka mund të shkruani dhe me kaq sa dini.

— Mbase!

Me gjeologun kishim rrugë të ndryshme. Tek ura s'na u desh shumë të prisnim për maqina. Ai hipi në një shytë dhe më përshëndeti.

— Natën e mirë, gazetar... shkruaje, shkruaj për ata me të cilët bëmë një copë rrugë.

Unë sikur isha topitur. Kur maqina ishte larguar u shkunda si nga një e ngjethur e gati sa nuk i thirra gjeologut nëpër errësirë... As emrin nuk i mësova...

S'vonoi shumë e gjeta dhe unë një maqinë... Më dukej sikur ende udhëtoja me karrocerinë e kamionçinës... Por në vend të ish-bashkudhëtarëve përfytyroja vetëm silueta me tipare të papërcaktuara, pa dalluar cili prej tyre ishte Kenua, cili Stefi e cili ai me zë basi... Edhe zërät e tyre më përzihe-shin e midis tyre dalloja vetëm atë të Selos. Më vinte inat me veten. Megjithatë vendosa të shkruaja.

E përfytyroja shkrimin tim të mbaruar, pastaj më dilte përpara shefi e më dukej sikur më thosh duke mbledhur buzët:

— I ke rënë me spond, s'ke qullosur gjë... gjëra të tërthorta. Mungojnë detajet, mungon elementi i gjallë. Tek ata për të cilët shkruan duhen vënë re të gjitha, që nga lidhëset e këpucëve e deri te jaka e këmishës... Pastaj, ky Kenua si e ka mbiemrin? Këta të tjerët kanë apo s'kanë emra? Po një çikë ambient nga ceremonia, po nja dy fjalë të të deleguarit, po premtimet e Kenos... Pastaj edhe portreti fizik duhet të dalë... Ti s'ke asgjë... Si mund ta ndash portretin fizik nga portreti moral... Këto janë alfa...

Pastaj natë, shi, errësirë fund e krye... Mos harro rolin e ambientit, të terrenit e të motit në shkrim... Vërtet ishte natë, binte shi por prandaj je gazetar, t'i gjesh detajet, të krijosh figurat... Për shembull ndalu pak te dritat e maqinës, ose si të thuash krijo një ndriçim me një figurë, me një krahasim, me njërën e me tjetrën... Natë, shi, zymtësi... Kapu te dritat...»

Ndjeva një tendosje të tmerrshme nervash. As unë s'e di pse më dukej se dilnin të tilla fjalë nga goja e tij. Ndoshta nga dëshira e madhe që kisha për të shkruar për ato silueta në karrocërinë e kamionçinës. M'u kujtua gjeologu dhe u shkunda. Të paktën t'i kisha marrë atij emrin dhe mbiemrin... Të kisha të paktën një njeri me emër dhe mbiemër të plotë në shkrimin tim. Edhe fytyrën s'ja mbaj mend... Ja pashe vetëm një herë vetëtimthi në dritat e maqinës... Ta shoh nesër me siguri nuk e njoh...

Mos është edhe ai hero për një shkrim tjetër?

— Folë, or një fjalë — më thotë shoferi.

M'u duk sikur ai nuk foli, por më zuri për krahu dhe më shkundi.

— Ç'thotë puna?

— Puna, puna e...

Fillova ta vëzhgoja me kujdes shoferin për të fiksuar në kujtesë tiparet e tij.

— Si ju quajnë? — e pyeta që për çdo rast të mos më ndodhte si me ata të kamionçinës.

— Demir — shoferi më pa me vërejtje. Si duket i bëri përshtypje që unë pyeta drejt e për emrin. Vura re se sytë i ishin skuqur, duart e mëdha e të ashpra të përlyera, flokët dhe rrobot të lagura, kurse mbi fytyrë ca gjurmë rrëshesh të vogla djerse e balte.

— Po ty si të quajnë? — më pyeti?.

— Kastriot.

— Paske emër trimash, ta gëzosh... Ç'punë bën?

— Gazetar...

— Hm... paske zanat të bukur...

Maqina ecte ngadalë. Ne heshtëm një çast. Shoferi filloi të mërmëriste nën zë një këngë gazmore. Ndërsa unë bluaja me mend nëse mund të shkruaja për të... Te ky njeri i përlyer me baltëra e vajra, i qullur e që s'mund ta fshihte lodhjen e që megjithatë këndonte një këngë gazmore më dukej se kishte diçka heroike. Para nesh ecte ngadalë një skodë me rimorkio. Prisja që shoferi ta kalonte atë por më kot. Hera-herës ai nxirrte kokën nga kabina dhe shikonte rrotat e rimorkios që ecte para. Më shkuan përsëri sytë te fytyra e tij e lodhur dhe e përbaltur.

Diku afër llamburitën dritat e qytetit B. Para se të arrinim atje maqina që ecte para ktheu në të djathtë dhe qëndroi. Shoferi i saj na doli para. Edhe maqina jonë qëndroi.

— E? — pyeti Demiri.

— Në rregull... Falemi nderit e ta paça borxh...

Pastaj i shtrëngoi dorën Demirit dhe na uroi udhë të mbarë.

Edhe ai ishte i qullur dhe i përlyer kokë e këmbë.

— Natën! — ja ktheu Demiri dhe nisi maqinën.

— I qe këputur aksi i rimorkios. Kështu e ka rruga jonë!

Maqina tani ecte shpejt. Kur arritëm në B. Demiri ngadalësoi shpejtësinë.

— Ti do të zbreç këtu, ë?

— Jo.

— Po ti sikur... Le që mirë ja bëre... Këmbejmë një fjalë rrugës...

Nuk ju përgjegja dhe kështu zu fill një heshtje e gjatë. Demiri prapë zu të mërmëriste nën zë atë këngë gazmore me të cilën me sa dukej ishte dashuruar. Kurse mua më kishin mbërthyer mendimet. Ndërsa maqina ecte nëpër qytet, mudohesha të merrja me mend se ku mund të ndodheshin zyrat nëpër të cilat do të isha sjellë të nesërmen për të gjetur heronjtë.

Derisa arritëm në Tiranë këmbuem më të rrallë ndonjë fjalë. Edhe kur zbritëm nga maqina një copë rrugë e bëmë bashkë. Pastaj u ndamë duke buzëqeshur dhe duke shtrënguar duart fort. Shiu vazhdonte me monotoninë e tij të mërzitshme. Pa e kuptuar as vetë kisha shpejtuar hapin. Thuajse vrapoja. Dhe qeshja me vete. Më shoqëronin të njohurit e asaj nate nëpër errësi. Shkrimi s'priste më për të nesërmen.

Ajo natë me shqetësimet, gëzimet, ethet e mia do të më mbetej në mendje si mbrëmja e paharruar e takimit të parë.

PAS PROVIMIT TË FUNDIT

Në dhomë ishim ne të tre, unë, Bardhi e Shpëtimi. Po bisedonim për fletërrufenë që i kishin vënë një pedagogu disa studentë të vitit të parë. Biseda kishte nisur rastësisht po fjala nxori fjalën dhe të na dëgjonte njeri pas derës me siguri do të habitej që ne, shokët e ngushtë, që kishim kaluar katër vjet si vëllezër në atë dhomë konvikti, po ziheshim.

Unë thosha se studentët e ngrinin drejt problemin në fletërrufe por disa nga kërkesat e tyre më dukeshin tendencioze. Bardhi e aprovonte plotësisht atë, bile thoshte se disa gjëra duheshin thënë më me guxim dhe s'ishte çudi që të nesërmen të bënte një shtojcë. Kurse Shpëtimi nuk ishte aspak dakord.

— Për mua është një çilimillëk. — thoshte ai.
— Profesor Nuni nuk është ashtu. Pastaj ata që në vit të parë... Të paktën për respekt... Unë do t'u përgjigjem.

Me sa dukej ne s'kishim për t'i hapur lehtë rrugë njëri-tjetrit, megjithëse ishte kohë provimesh e orët e humbura na kushtonin shtrenjtë. Ashtu të acaruar na gjeti Kozmai, «këndi humoristik» i kursit, siç e quanim ne.

— S'qenka Ligori? — na pyeti me të hyrë. Dhe, ndonëse për këtë ishte i bindur, priti përgjegje.

— E lamë pazarit. Ishte me një fshatarin e tij.

— Nga ora gjashtë, kur kishit dalë ju, erdhën dhe e kërkuan në konvikt.

— Ai ndoshta ishte!

— Kush?

— Fshatari.

— Si ishte ai që patë ju? — pyeti përsëri Kozmai.

— Nja pesëdhjetë; pesëdhjetë e pesë vjeç.

— Me qeleshe e me rrobe shajaku.

— Xhaketën e kishte prej kadifeje.

— Nejse, pantallonat...

— Me opinga. Fshatar, o vëlla.

Kozmai ishte prishur në fytyrë dhe po na shihnte si me habi. Me siguri diçka e rëndësishme kishte ndodhur se Kozmai nuk ngrysej kollaj. Ne të tjerët këmbuem nga një pyetje me sy.

— A kishte një të prerë në faqen e majtë? — pyeti prapë Kozmai.

— Jo.

— Mos ja fut kot, ne ishim larg e s'e vumë re.

— Kishte. E pashë unë — tha Shpëtimi.

— E tmerrshme!

Kjo na çoroditi fare.

— Spurdhaku! — shau nëpër dhëmbë Kozmai.

Pastaj ngriti zërin: — Ju kam thënë, mor jahu, ai është mistrec, është i lig!

E kishim harruar fletërrufenë dhe merrnim me mend gjithfarë ndodhirash. Shikonim Kozmain në gojë dhe prisnim.

— Po që të arrinte deri këtu s'ma merrte mendja kurrë.

Prapë s'kuptova gjë. Pashë Bardhin. Ai ngriti supet. Shpëtimi s'e mbajti më:

— Nxirre të shkretën, se na plase!

Por siç duket edhe vetë Kozmai s'besonte tek

ajo që mund të kishte ndodhur, ndaj na pyeti përsëri për atë çka dinim ne mbi fshatarin. U munduam t'ja tregonim sa më shpejt, duke i prerë fjalën njëri-tjetrit se s'na pritej të dëgjonim ç'kishte ndodhur.

— Ishim në bulevard kur e pamë Ligorin me atë fshatarin.

— Ligori ishte në trotuarin tjetër e ne shkuaam t'i thoshim se dëgjuam që kishte marrë dhjetë në provim. . .

— Ai me të na parë u shkëput nga fshatari e na doli përpara.

— S'ka dashur t'ju njohë me të — tha Kozmai dhe priti të vazhdonim.

— I thamë për notën.

— Unë e pyeta ç'e kishte atë. Ai më tha se ishte një bashkëfshatar.

— Atë kohë fshatari buzëqeshi e u nis të vinte drejt nesh, po Ligori na la dhe i doli përpara.

— Dhe na tha se do të vonohej sonte.

I kishim thënë të gjitha. Heshtnim dhe shikonim Kozmain. Edhe ai heshte, por papritur shpërtheu sikur të ishte ndonjeri nga ne fajtori.

— Epo kjo s'durohet de. . . Ai është i poshtër!

— S'të marrim vesh!

— Hë, mo, dhe ju! Ju ka gënjyer, s'e merrni vesh tani?

Me atë që na tha na habiti. Fshatari na paskëshqenë babai i Ligorit.

— I poshtëri, karrieristi. . . — shau me gjithë shpirt Kozmai.

U ulëm nëpër shtretër. Mendonim dhe heshtnim. Të nxehur dhe të revoltuar. Kaluan minuta të gjata e të rënda. Veç rrallë e tek dilnin fjalë të shkëputura. Njëri nga ne kujtoi ditën e parë kur kishte

ardhur Ligori në auditor, para katër vjetësh, dhe biseda sikur gjeti binarët.

Ai kishte ardhur në fakultet me një javë vonesë, kur ne të tjerët i kishim këmbyer përshtypjet e para. Pas leksionit dikush pa një rrodhe në trikon e tij. Një tjetër ja hoqi duke lëshuar një shaka të lehtë. Disa qeshën pa të keq, sidomos dy vajza. Edhe ai u përgjegj pa i mbetur qejfi, bile me njëfarë krenarie:

— Epo fshatar, moj shoqka! Dje kur u nisa për këtej u ndava edhe me lopën time dhe ajo më vuri distinktivin e bujkut, që të mos e harroj. Më dha edhe të fala për ju. E quaj në Madalena.

Qeshëm të gjithë...

Ulur përballë njëri-tjetrit nëpër shtretër ne kujtonim:

— E mbani mend mbrëmjen e parë të vallëzimit?

Në atë mbrëmje Ligori bënte ç'bënte dhe porositte valle popullore. Dhe i hiqte, jo shaka! Nora, shoqja më gazmore e kursit punoi me shumë durim gjersa i mësoi foksën dhe valsën, se tangon e dinte, megjithëse nganjëherë, siç i thoshte Kozmai, sikur e ngatërronte me rreshtoren. Ndoshta mësimi i dansit ishte parathënja e dashurisë së tyre. Nora, që s'rrinte dot pa qyfyre dhe s'mbante dot sekret e ngacmonte Ligorin edhe në mes të kursit. Ajo i lutej me shaka një shokut tonë poet që t'i bënte një vjershë dhe i thoshte:

— Të ndihmoj edhe unë. Të jap figura sa të duash. Ligori më thërret shqerkë, dredhëzë, oqiçkë...

Ai në fillim qeshte me ne të tjerët e s'i zemërohej. Edhe nëpër biseda s'ishte e vështirë të dalloje prirjet fshatarake të ndjenjave të tij. Fliste me pasion për bujqësinë dhe përdorte shumë fjalë të urta

pleqsh. Ai u vinte dicitura bisedave tona me proverba të bukura. Shpesh ankohej se disa shkrintarë temën e fshatit e trajtonin cekët dhe kapeshin pas gjërave të vjetra. Në veprat e tyre ai kërkonte të gjente të atin, të ëmën, xha Nurkën, xha Tefikun.

Gjer nga mesi i vitit të tretë ai mbeti një copë e shpirtit të çiltër fshatarak. Në mësim ishte një nga më të mirët e kursit. I zellshëm, i kujdesshëm e sistematik. Dhe thoshte gjithmonë:

— Studenti i ngjan bujkut. Punon tërë vitin e në fund ka lëmin, provimet.

E, kështu Ligor i gjer nga mesi i vitit të tretë. Pastaj dalëngadalë sikur nisën të ftoheshin ato ndjenja prej fshatari të mirë. Për temën e fshatit në letërsi s'ishte më ai kritik i parë. Bile në një diskutim ngulte këmbë se tani sidomos ishte koha e letërsisë qytetare. Megjithatë ky ndryshim s'u bë menjëherë e s'na ra shumë në sy. Por vitin e fundit ndryshoi puna. Në një sesion shkencor të studentëve ai mbajti një kumtesë që u prit mjaft mirë. Pas kësaj filloi të flitej se do ta mbanin pedagog në fakultetin tonë. Ai po bëhej më i mbyllur, fliste rrallë, shakatë s'i pëlqenin më dhe hidhej përpjetë po ta ngacmoje. Nuk shkonte mirë sidomos me Kozmain, që i kishte thumbat në majë të gjuhës. Nora filloi të ankohej. Një natë ishin grindur keq dhe ajo u betua se midis tyre kishte mbaruar çdo gjë. Duke qenë më afër domosdo që i ndjente më shumë se ne ndryshimet e Ligorit. Me t'u zbehur çiltërsia e tij ajo po ndjente shënjat e para të ftohtësisë. Dhe tani nuk i shpjegonte dot ndryshimet e Ligorit.

— Unë e kuptoj, njeriu ndryshon, piqet, formohet por tiparet kryesore të karakterit qëndrojnë — na thoshte neve. — Ju betohem, ai është krejt ndryshe nga ç'e kam njohur në fillim.

Ne, që nganjëherë e merrnim Norën për mendjelehtë mundoheshim ta bindnim se ai s'kishte ndryshuar aq shumë dhe në qoftë se ishte bërë si shumë serioz e i mbyllur kjo vinte se që dhënë shumë pas shkencës.

Megjithatë ne edhe vetë ndjenim diçka. Njëfarë mendjemadhësie, një preokupim i thellë, intim e kishte pushtuar. Sidoqoftë rrezikun ende nuk e shihnim.

Nora u rregullua përsëri me të, por përkohësisht. Dhe u nda pas dy javësh duke mos e respektuar as si shok klase.

Kur filloi semestri i dytë atë e caktuan asistent të një pedagogu në kursin e parë. Pas kësaj ai u bë më i rëndë. Me disa nga shokët e kursit krijoi një farë distance kurse me ne mendohej të mos tregohej, por dukej që ishte i sforcuar. Në pushimet e dimrit prindërit e pritën në fshat, por ai shkoi në një kamp dimëror bashkë me dy pedagogë të rinj.

Pas këtyre ne i dhamë të drejtë Norës. Edhe atij i folëm disa herë por s'pranoi asgjë.

Siç pëshpëritej emërimi i tij si pedagog në fakultet tani ishte bërë punë e mbaruar. Dikush tha se edhe me ministrinë ishte zgjidhur problemi, megjithëqë kishte qenë e vështirë pasi e kërkonte rrethi. Siç ndodh zakonisht në muajt e fundit të jetës studenteske ka shumë pëshpëritje. Asgjë s'dihej me siguri. Edhe vetë ai thoshte se s'dinte asgjë. Megjithatë kishte bërë një kostum të zi (s'kishte shumë që kishte bërë një tjetër) dhe kishte blerë një çantë të shtrenjtë në dyqanin me komision. Studjonte shumë. Dukej që gërmonte literaturë për pregatitjen e leksioneve të lëndës që mendonte se do të jepte. Më shumë rrinte në dhomën e dy pedagogëve të rinj, që ba-

nonin gjithashtu në konvik, se sa me ne. Me një fjalë i kishte pjekur kokrrat para se të vinte vjeshta, megjithëse ishte bir bujku e ligjet e bujqësisë i dinte mjaft mirë. Dhe i përdorte aq me vend dikur.

.....

I kujtuam të gjitha këto me nervozizëm. Të lodhur nga provimet e shtetit inati na rrëmbente shpejt, sidomos Kozmanë, të cilin s'e paskëshim njohur si nevrrik kalibri. Atë natë nuk mund të studjonim dot më. Si kaloi ora dhjetë ramë të flinim. Të mërzitur e të heshtur. Nuk mund të flinim. Herë kërciste njëra sustë e herë tjetra. Ndonëse s'kishim thënë asgjë të katër prisnim Ligorin. Dhe minutat shkolin të rënda e shqetësuese.

— Mizerja! — U zbraz më në fund Kozmai.

Të gjithë këtë prisnim, sa të hapte gojën i pari.

— Kulmi, për nder të familjes!

— Përse e bën këtë?

— Për Tiranën, për profesorllëkun... Norën e la se, domosdo, profesori mund të zgjedhë një më të mirë...

— Tani mohon edhe të atin. Idioti! I vinte rëndë të na thoshte që ishte i ati, se kishte dy gisht djersë mbi qeleshe, se ishte me opinga!

— Megjithëse me atë djersë i ka blerë teritalet dhe çantën.

— Edhe tani kushedi në ç'qoshe të humbur e ka futur të atin. Kushedi ç'i përrallis.

Dhe përsëri mbi ne ra heshtja e rëndë gjersa ndjemë kërcitjen e derës.

— Ligor? — pyeti ashpër Kozmai nëpër errësirë.

— E, s'paske fjetur akoma? — tha ai me gjysmë zëri. I merrej pak goja.

Kozmai s'ju përgjegj. Edhe ne të tjerët, ndonëse zjenim përbrenda s'folëm. Ai u zhvesh, shau nëpër dhëmbë, kur u pengua në tryezë dhe ra në shtrat. Heshtje. Dhe përsëri zunë të kërcisnin sustat. Hesh-tjen e çau Ligori.

— O..ho... ho!

Ishte një gogësimë përgjumjeje dhe dehjeje.

— Profesorëve s'u ka lezet të dehen. Do të diskreditohesh. — Për çudinë tonë Kozmai foli shtruar, megjithëse nëpër errësirë e dalluam fare qartë ngjyrën e fjalëve të tij.

— Piva nja dy birra...

— Me atë fshatarin?

— Po...

Ishte një pohim i shurdhët e i dobët. Gjithshka kishte qenë e vërtetë.

— Frikën ta kisha, po që të arrije gjer këtu s'e mendoja kurrë. — tha Bardhi.

Ai seç u përpoq të thoshte, por kur pa si qe thurur lëmshi s'ja gjente dot fillin.

— Më fal që po të them po qenke i lig! — ja këputi me gojën plot Shpëtimi.

Ai u kapërdi me zhurmë.

— Mos kishte ardhur për të të thënë që të kërkosh emërimin në fshat?

— Jo... Kishte shoqëruar një tufë lopë që ja kishin dhuruar një kooperative në Kukës dhe qëndroi të më takonte.

Zëri i tij ishte i mekur dhe dilte copa-copa i këputur nga kombet e mbledhura në fyt.

— Për nder të familjes qenke i poshtër!

Nëpër errësirë dalluam siluetën e tij që u ngrit

me përtesë. Diçka donte të thoshte, por në vend të fjalëve dëgjuaam përsëri gurgullimën e pështymës në fytin e tij. Dhe atë çast që e patëm menduar si kulmin e zemërimit u shtrimë në heshtje. Gjumi na zuri kushedi se kur. Atë e lamë ashtu, ndenjor mbi shtrat, duke lllapashitur midis brigjeve të hesh-tjes sonë.

.....

Gjithë kursi kishim vendosur që atë ditë, pasi të jepnim provimin edhe ne që kishim mbetur pa e dhënë të djeshmen, të bënim mbrëmjen e fundit, mbrëmjen e lamtumirës. Pasdite, aty në auditor, pasi na komunikuan notat dikush propozoi orën shtatë për të filluar mbrëmjen.

— Më vonë. Ose mund ta bëjmë nesër. — tha njëri nga shokët e dhomës.

Kozmai nuk la që të ndizeshin diskutimet:

— Kemi edhe një provim akoma.

— Lëri numrat e ruaji për në mbrëmje — qeshi dikush.

— Ka ndodhur diçka e rëndë. Mua më duket e turpshme.

Kryqëzim shikimesh, habi dhe pëshpëritje.

Ligorin e mbuluan djersët.

— Uluni.

Ishte i vështirë ky provim pas provimit të fundit.

SAZEXHINJTË

Ilamba e gjatë e neonit mbi vetrinën e banakut lëshoi ca përpëlitje drite. Kërnetistit s'i pëlqeu loja e dritës. Ktheu me përtesë kokën e madhe duke tërhequr me zor gushën e rëndë dhe puliti sytë e përhitur gjumashë. Nën qerpikët e poshtëm i kërcyen dy qeska sa një kokër arre, të rënda e të mavijosura sikur në to të kishte mbledhur ato mijëra net të gdhira dasmave dhe ahengjeve.

Sazexhinjtë e tjerë e thërrisnin Temo po emrin e vërtetë kushedi si e kishte. Ishin katër. Ai qe violinist, një tjetër me mandolinë dhe një djalë i ri, njëzet e dy-tre vjeç, xhezbanist. Tre më të vjetrit ishin pothuaj të një moshe, të paktën të një brezi. Gjersa erdhën në këtë bufe me llamba neoni, abazhurë kristali e tryeza plastmasi që u dukej e zbrazët dhe e ftohtë duhet të kishin bërë një rrugë shumë të gjatë, të përbashkët, duke hyrë e duke dalë shtëpive të panjohura dhe duke trazuar e ndezur me tingujt e veglave të tyre gëzimet e njerëzve. Shikimet e tyre ishin të turbullta e të shpëlara dhe kur takoheshin shkonin në një rrjedhë pa u dalluar. Edhe lëvizjet, reflekset i kishin pothuajse të njejta. Heshtja dhe përgjumja e tyre kishin të njejtën domethënje: lodhjen e njeriut që ka ecur gjithmonë duke parë poshtë gjersa i janë mpirë gjunjët dhe sytë.

Rrinin mbledhur në karriget e buta pa u mbështetur në tryezën prej plastmase që u dukej e huaj dhe e ftohtë.

Xhezbanisti ishte i ri dhe i shëndetshëm. Duhet ta vëreje me kujdes që të dalloje si shfaqeshin rrallë e tek gjestet e sazexhiut.

— Shiko edhe një herë — tha Temua.

— Bie — tha violinisti. Ai kishte një fytyrë si të gdhendur në eshkë.

— Shikoni një herë nga penxherja — tha prapë Temua.

Xhezbanisti hapi kanatin e madh me xham të trashë. Vërshoi ajri i lagësht dhe troku i shiut mbi asfalt.

S'kishte vend për fjalë po, meqë duhej folur, mandolinisti tha:

— Më shumë.

Të tjerët lëvizën si për t'u shkundur.

Neoni prapë bëri një lojë përpëlitjesh.

— Palo drita — tha Temua. Dhe pas një gogësimi të gjatë: — Si të mbushura me dhallë.

Bufeja ndahej nga salla e madhe e lokalit me xham të trashë akulli. Zërat që përtej vinin të dobët e të pakuptueshëm dhe përziheshin me zhurmën e ekspresit.

— Sa vajti? — tha Temua.

— Shtatë — tha ai me fytyrë eshke.

— Tërkuzë e bënë. Aliu tha se kanë filluar që në pesë...

Në sallën e madhe maturantët e një shkollë kishin takim me një shkrimtar për romanin e tij të fundit. Pas bisedës takimin do ta kthenin në mbrëmje vallëzimi... Po mbledhjes s'po i dukej fundi. Temua zjente por mundahej të dukej sikur

s'e çante kokën, mandolinisti dremiste kurse violinisti përgjonte. Dëgjoheshin zëra pa kuptim djemsh e vajzash, basi i shkrimtarit, shpërthime të qeshurash, trokitja e lapsit të profesorit mbi tryezë.

— Edhe këtë javë s'kemi gjë... — tha mandolinisti.

— S'para ka dasma dimri — tha violinisti.

Temua kroi gushën e varur mbi jelekun e lerosur nga mezetë.

— S'ka bërë vaki të rrimë tri javë pa na thirrur gjëkund.

Fjalët e tij i shqetësuan të gjithë. Veç xhezbanisti s'para u turbullua. Ishte i menduar.

— Ç'e paskan tërë këtë konferencë! — tha mandolinisti si për të larguar një frikë të pakuptueshme.

— E lidhe ti telin e mandolinës?

Zëri i Temes tani ishte i vrazhdë e pothuaj urdhërues. Atë çast të kujtonte ndonjë djalosh fare të ri, që kur kalon nëpër vende të panjohura këndon duke trashur zërin për t'i mbushur mendjen vetes se është burrë e s'ka frikë.

Mandolinisti, një ziosh me mollëza të kërcyera e buzë të përveshura sa i dukeshin gjithmonë dhëmbët, nxori nga këllëfi i ndotur prej doku instrumentin e dalë boje dhe filloi të merrej me të. Duart e tij lëviznin me ngathtësinë e njeriut pa pasione. Dhe ashtu, nëpër atë plogështi ju përgjegj vetes:

— Kanë mbledhje me një shkrimtar, sikur tha Aliu.

— Kur u hap dera dhe e pashë qëparë m'u duk si leshko — tha violinisti. — Po paska tërë atë llaf.

— Ama ç'na the dhe ti! Po me llafe ha bukë, o t'u mbylltë! Se mos di t'i bjerë kërnëtës! — tha

Temua me përçmim e me krenari që kishte nxjerrë fjalë me mend.

— Kur thua ti..! Ai mbush me llafe tërë ato libra e jo mos dërdëllisë një sahat me kalamajtë — tha mandolinisti dhe provoi me gisht telin, që lëshoi një tingull gërvishës.

Xhezbanisti rrinte në heshtjen e tij të menduar. Dëgjonte dhe s'fliste. Diçka ndjente, mbase të amullt e të pakuptueshme, por me siguri diçka që tre të tjerët s'e kishin provuar. Ishte një nga ato ndjenjat që të japin zagushi.

Temua qeshi nën hundë me fodullëk.

— Temo... o, s'të kam pyetur, ke kënduar ndonjë libër? — i tha violinisti.

— Atë që ke kënduar edhe ti... Abetaren, kur na futën ahëre për alfabetizmin. E ç'kemi humbur thua?

— Ky ka kënduar, domosdo... Ka bërë ca shkollë — tha mandolinisti për xhezbanistin.

Ai uli kokën si i fyer nga ndonjë sharje. Shikimet që ranë mbi të ishin të shpëlara e tallëse.

— Po për ne kanë bërë ndonjë libër këta shkrimtarët, mo? — pyeti Temua.

Ndoshta ishte hera e parë që ata flisnin për shkrimtarë e për libra.

Xhezbanisti ngriti supet e mblodhi paksa buzët

— More, thonë që shkrimtarët pinë shumë raki, — tha mandolinisti.

— Limonadha pinë — u ngërdhesh Temua.

Që prapa banakut doli përgjegjësi i klubit, një buçko që, ndonëse tregonte më pak, duhet t'i qe afruar majës së pesëdhjetave po me sa dukej pa u lodhur shumë. U afrua duke u mblaçitur dhe u hodhi sazexhinjve një buzëqeshje pa formë e pa

ngjyrë. Duke u ulur i thirri banakieres me kapadaillek .

— Marta, pesë kafe!

Dukej që njihej me sazexhinjtë. Me Temon kishte dhe njëfarë intimiteti që e kishte zanafillën në dasmën e kushedi kujt.

Sazexhinjtë lëvizën si për t'u shpirë.

— Lëri mo, ç'i do! — tha me një zë të dyshimtë violinisti.

— Ama shi! — tha përgjegjësi.

— Ama llafe, thuaj! — tha Temua dhe bëri me kokë nga salla e madhe.

— Duhet të mbarojnë tani — dhe përgjegjësi pa orën e madhe të murit.

Heshtja e përgjumur filloi të binte përsëri mbi gjymtyrët, shikimet, mendimet e tyre. Po mandolinisti, pasi u hodhi nga një sy kolegëve si për të marrë aprovim, tha:

— Allahile, këta shkrimtarët a kanë bërë ndonjë libër për ne, o Ali?

Të gjithë kthyen kokat nga përgjegjësi.

— Domosdo që do kenë bërë... Shkrimtarët shkruajnë për të tëra.

— Na farosnë fëmija nga paratë — tha fytyreshka .

Në sallën matanë u dëgjuan duartrokitje dhe përzjerje zërash.

Ata hodhën duart mbi vegla si mbi armë.

Temja zbrazi mushkëritë dhe gjithë durimin e tij e të shokëve.

— Mbaruan!

Marta solli kafet. Përgjegjësi u ngrit dhe i tha t'ja çonte filxhanin e tij në banak. Dera u hap e salla e vogël e bufësë u mbush me zëra e zhurmë karrigesh.

— Po lirojnë sallën — tha violinisti.

Xhezbaniisti uli kokën e dukej sikur fshihej pas trupit të majmë të Temes.

Të rinjtë dilnin gazmorë, togje-togje, dhe as që u bënte përshtypje prania e sazexhinjve. Ndonjë nga ata që u kalonin pranë u hidhte shkaraz ndonjë shikim të ftohtë e mospërfillës dhe shkonte në banak. Shkrimtari doli në mes një tufe djemsh e vajzash. Ai seç u tha dhe ata qeshën me gjithë shpirt.

— Ky është? — tha Temua.

— Ky — tha violinisti.

— Tamam leshko duket. E ti thua pinë raki këta!

Shkrimtari u ul në tryezën e qoshes me katër-pesë të rinj. Pas pak njëri prej tyre u ngrit.

— Do të pini një kafe? — i tha shkrimtarit.

— Apo një konjak? — pasoi një tjetër.

— Më mirë të dyja. Thonë se kafja shkon me konjakun. — tha një vajzë që si nga fytyra e nga zëri dukej se kishte lindur për të qeshur.

U ngrit edhe shkrimtari:

— Do t'ju qeras unë. Merrni nga një pastë!

Po të rinjtë ashtu si e kanë, me vrull, s'e bëjnë të gjatë e porositën.

— Për ne, kakao! — i tha vajza djalit që po i jepte porosinë banakieres.

Shkrimtari qeshi.

— T'i marr leje profesorit?

— Mos na ofendoni tani... As për një kakao s'jua mbushim syrin? — tha me shaka një nga djemtë. Kurse vajza mori një pozë aktorese dhe tha me solemnitet:

— Ç'është e vërteta, shoku shkrimtar, jeni ca konservator... Harrova se do ta kisha thënë edhe aty në diskutim... Ata dy të rinjtë e romanit tuaj

dashurohen e dashurohen po s'i latë të puthen një herë.

Qeshën të gjithë. Zëri i saj ngrihej mbi të tjerët.

Salla e vogël e bufesë ishte mbushur plot. Fjalët me zë të lartë, të qeshurat e shpenguara, fytyrat e çiltëra e të shëndetshme, lëvizjet plot gjallëri sikur transformuan gjithshka duke i dhënë jetë edhe neonit, edhe ekspresit, edhe plastmasit, edhe ajrit. Në këtë blerim të ndezur rinie tryeza e sazexhinjve i ngjante një cope toke të murrme, të zhveshur e të zyrtë.

Përgjegjësi i klubit u duk te dera e sallës së madhe, me profesorin e me një djalë flokëzi, me një palë sy që i lëvrinin. Me një lëvizje të kokës diçkë desh t'u thoshte sazexhinjve. Ata s'e kuptuan, por morën me mend diçka të mërzitshme e të dyshimtë që u dogji.

Djaloshi ishte nxehur. Profeshori dukej shumë i zyrtë. Përgjegjësit i qenë skuqur faqet e fryra. Jepnin e merrnin sa njëri, tjetri. Rreth tyre u mblodhën edhe të rinj të tjerë.

Sazexhinjtë heshtnin. Hera-herës këmbenin ngandonjë shikim shkaraz dhe prisnin të ndodhte diçka.

Zërat sa vinin e ngriheshin, dhe tani ata diçka dëgjonin.

— Jo, mor vëlla, ç'na duhen sazë! Ne duam orkestër. Duam të kërcejmë. Jemi të rinj ne... Edhe do këndojmë — thoshte djaloshi flokëzi.

Përgjegjësi mudohej t'i mbushte mendjen:

— Dëgjo, mor djalë, dëgjo. Unë rashë dakort me profesorin. Kështu, profesor?

— Po unë thashë...

— Prit një minutë... Erdhe për sallën ti? U morëm vesh. Doni orkestër të thashë. Duam më the.

— Orkestër po jo saze. Ne s'jemi mbledhur të

dëgjojmë këngë mejhanesh... Jemi rini ne, xhaxho!
Duam të kërcejmë... Të këndojmë këngët e reja,
këngët e festivalit... — tha njëra nga vajzat.

Përgjegjësi vazhdonte në të tijën.

— Po ne bëmë edhe pazar, profesor. Dyqind
më the ti, dyqind u thashë unë. Dhe erdha.

-- Unë thashë për orkestër.

— Orkestër është, profesor, me kërnetë, me
violinë... Edhe me xhez, mor jahu... Këta i njeh
gjithë Tirana.

Dikush thirri:

— Hej, do të bëhet apo jo?

— Kot, profesor... Më mirë të kishim marrë
fizarmonikën e shkollës... — thoshin të rinjtë.

Kur panë që përgjegjësi s'tundej nga e tija, një
nga djemtë ja përplasi.

— Kushedi ç'ke ngatërruar ti me ta, po rri tani!..

Orkestër, thotë!

Përgjegjësi u hodh në sulm.

— Jeni edhe djem shkolle, pale... Po ta merrni
vesh, këtu është lokal shteti! Kështu! Ka rregulla
këtu! Ato orkestra që doni ju s'hyjnë dot këtu.
Mos doni të këndonit e të kërceni si nëpër ca...

Pastaj s'u mor vesh asgjë. Ju sulën të gjithë
përgjegjësit. Sytë e sazexhinjve ishin ngulur tek
ai si te varka e shpëtimit.

— Po ata ç't'i bëj unë? — tha i lodhur për-
gjegjësi.

— Merr një faqore e shko shtroja në shtëpi
po deshe...

— Kot që grindemi... E gjetëm... — tha dikush
dhe bashkë me një tjetër dolën nga lokali me nga
një pardesy mbi kokë. Grumbulli u qetësua dhe të
rinjtë u shpërndanë. Përgjegjësi megjithatë s'i ndahej

profesorit, por edhe ai s'ja zgjati më dhe e la në mes të sallës.

— S'kam ç'të bëj. Rinia do orkestër.

Ngriti supet, u buzëqeshi sazexhinjve si për t'u shfaqësuar dhe shkoi te nxënësit.

Përgjegjësi ju afrua pa fjalë tryezës së sazexhinjve. Ata e shikonin të hutuar.

— Fundja u thoshe dhe njëmijë e pesëqind — tha Temua.

— Duan orkestër! — imitoi duke gërryer gurmazin përgjegjësi.

— Po ne ç'jemi?! — tha Temua dhe pa një herë me radhë të tjerët dhe veten.

Diçka e frikshme dhe e zbrazët mbeti në fund të fjalëve të tij dhe në shikimet e të tjerëve.

Shiu vazhdonte të rrihte dritaret e mëdha.

— Le të gjejnë orkestër tani! — shfryu nëpër buzët e përveshura mandolinisti sikur të kishte lëshuar një mallëkim.

Nga tryeza ku ishte ulur shkrimtari shpërtheu një e qeshur si një krismë fishekzarësh.

— E kanë me ne — tha violinisti.

Temua s'foli. Xhezbanisti s'guxoi të ngrinte sytë.

— E marrtë djalli e marrtë — tha befaz Temua — ku e sollëm kokën këtu?

Të rinjtë që kishin mbetur në bufe ishin të paktë. Salla e madhe gumëzhinte përsëri.

— Të marrsha të keqen e dasmës — tha mandolinisti.

— Dasma, dasma po s'po na e varin më...

Le po s'vijjnë as nga fshati të kërkojnë. Sa u bënë?

— Tri javë — tha mandolinisti

— Shumë — tha Temua.

Dera e lokalit u hap me krismë. Dy djemtë që patën ikur hynë duke mbajtur diçka të rëndë, të mbështjellë me mushama.

— Kaq shpejt? — u habit profesori.

— Me taksi — thanë djemtë dhe ashtu siç qenë me mushamatë në kokë u turrën në sallë.

— Manjetofon — tha si me vete xhezbanisti.

Në bufe sazexhinjtë mbetën përsëri vetëm, në një heshtje të trazuar. I vidheshin shikimit të njëri-tjetrit. Kishin humbur diçka që kishin frikë ta kërkonin.

Nga salla erdhën tingujt e një ritmi. Ata panë si u çuan siluetat pas xhameve, pastaj një grumbull të madh të përzjerë në mes të sallës. Dikush mbylli me forcë derën e xhamtë.

— Ngrihuni! — tha Temua urdhërues, duke ju drejtuar më shumë vetes.

— Bie shumë — tha xhezbanisti.

— Xhezin lëre pas banakut. E marrim nesër — tha prapë Temua.

Futën veglat e dala boje nën pallto dhe ikën. Te dera xhezbanisti u ndal dhe ktheu kokën prapa.

Të tjerët kishin dalë në bulevard.

Shiu i ndiqte me trok.

SHPIRT BUJKU

Nga fillimi i qershorit të kaluar më qëlloi një shërbim andej nga jugu dhe me atë rast shkova nja dy ditë në qytetin e lindjes për të parë pleqtë. Në shtëpinë ku ke lindur e je rritur, ku ke bërë të mbarat e të prapat të bien menjëherë në sy ndryshimet. Edhe unë që atë pasdite, sa kalova prakun e shtëpisë pashë se oborri s'ishte më ai që kishte qenë. Rreth e qark rrëzë mureve ishte mbjellë panxhar sheqeri. E kishte ardhur një panxhar i bukur e i mbarë me gjeth të zi e të krekosur që lëre mos e nga. Po dukej që dhe puna s'i kishte munguar. Plakun e gjeta me një teneqe në dorë, duke e vaditur rrënjë më rrënjë.

Pleqve domosdo ju bë shumë qejfi kur më panë dhe më mbytën me pyetje. Babai mori dy karrige dhe u ulëm në mes të oborrit, kurse nëna shkante e vinte nëpër shtëpi duke më pyetur saherë hynte e dilte:

— Do një gotë dhallë?.. Mos të hahet bukë?.. Ka mbetur ca byrek nga dreka, të ta sjell?

Nejse, si e kanë këto punë, folëm sa folëm e ra fjala te panxhari.

— Sa parashikon të marrësh për hektar? — e ngacmova plakun me shaka.

Ai ma ktheu duke vënë lehtë buzën në gaz e duke kruajtur kokën:

— More talluni ju me mua, talluni, pa të shohim në vjeshtë. S'dal pa tre-katër kuintalë unë.

— S'e thashë për t'u tallur.

— E, or, e, po mbushja mendjen sat ëme në qofsh i zoti.

Nga ajo nënqeshja e hollë që mbështillte fjalët e tij e mora me mend se panxhari do t'i kishte nxjerrë telashe me plakën.

— Po s'e sheh, edhe panxharin kishim eksiq ne! — u hodh nëna që përtej.

E kështu fjala nxori fjalën.

Një buzëmbremje babai kishte marrë belin dhe u qe futur rrëzëve të oborrit.

— Do mbjell panxhar — i kishte thënë nënës.

Ajo kishte kërcyer përpjetë:

— Unë mezi i solla lulet në din, ti dashke të m'i prishç. Mezi i mblodha, lip këtej e lip andej... Ç'është ky panxhar në shtëpi!? S'të ngop tërë ajo fushë? Ç'të hipi në kokë?!

— Mirë, moj grua, mirë! — kishte folur nën buzë plaku, siç bën gjithmonë kur s'do ta zgjasë muhabetin dhe kishte vazhduar të tijën. Me të mbaruar rrëzën e një muri kishte filluar tjetrën.

— O, o, o... — bënte plaka. — Po ç'bën, mor i uruar? Po bukën të hëngrën lulet ty, që u vure belë? Ç'është ky panxhar që do të mbjellç, mor ditëzi? Ty s'të ngopën tridhjetë dynymët që kishe...

Ajo fliste e ai më thellë i jepte belit, si për inat.

— Hë, mos i mbiftë fara, mos i mbiftë! Se mos ke lopë e t'ua japç. Ç'e do, mor ditëprerë?

— E, moj, e!

— Apo do ta bësh pekmez? Po ky i shkretë të faros nga drutë. S'më le një lule s'më le!

— Mjaft i ke saksitë de, se më plase. Oj! Në daç lule shko e kapardisu në lulishte. Përse i ka bërë qeveria?

Plakës i kërceu damari:

— Mos i mbiftë fara, mos i mbiftë! Të lanë mëndtë tani në pleqëri, mor i zi! Le që ti tërë jetën e ke pasur një damar...

Plaku s'kishte hapur gojë gjersa kishte mbaruar punë.

Me gjithë mallëkimet e pakursvera të nënës panxhari kishte mbirë zinxhir fare, si për inat të saj. Plaku i rrinte mbi kokë. Tërë ditën fushave punonte në mes të misrit, patateve, panxharit e prapëseprapë sa vinte në shtëpi sytë te panxhari i mbante.

Si është kjo punë e bujku! Vështirë ta kuptojë kushdo këtë ndjenjë që e lidh bujkun me bimën. Nuk është thjesht dashuria për pronën. Një dashuri më e madhe, më e gjerë. Unë e kam vënë re shpeshherë në mbjellje tim atë. Ajo fytyrë e ashpër, me ato rrudha të trasha e me atë shikim pak të vrazhdë merr një brishtësi që s'di ta tregoj. Bujku bëhet xheloz për bimën, bëhet sentimental, gazmor por kurrë i rreptë.

Nejse, të kthehemi te panxhari. Përse e kishte mbjellë plaku atë? Përse ja kishte prishur plakës atë kornizë të bukur lulësh që mezi e kishte rregulluar? Lopë s'kishte, pekmez panxhari s'mbaj mend të kemi bërë ndonjëherë. E pyeta.

-- Të bëhet një herë pa këtu jemi. Do hyjë në

punë. Fundja është bereqet e jo lulka. — më tha.

S'm'u ndejt pa e ngacmuar:

— Aha, lëre! Akoma gjallë krimbi i pronës private! E mua më shkruaje në letër se kur latë t'redynmshet ti...

— Ndonjë ditë prit kur të na mbjellë çatitë — tha nëna.

Ai qeshi lehtë dhe hoqi thellë tymin e duhanit nga llulla. E pashë që s'i erdhi mirë nga fjalët e mia dhe desha t'i thosha se bëra shaka po nëna s'priti:

— Do marrë një kosh panxhar këtu e do bëhet zengjin!

Ai prapë u përmbajt. Por, kur nëna nisi të fliste përsëri, ai ja preu:

— Mbylle de, se më plase! S'kam mbetur unë për... — dhe më pa mua. — Më vjen inat me ty pa asaj aq ja pret.

Dhe i vuri kyçin muhabetit të panxharit.

Në vjeshtë u ktheva përsëri te pleqtë për pushime. Panxhari ishte shkullur. Plaku i kishte prerë gjethin dhe e kishte pastruar si për ta çuar në fabrikë. E kishte vënë në qoshe të oborrit, nëpër arka. Ditët e pushimit kalonin dhe unë panxharin e shihja po aty, mbuluar me letër katrama. Por në fund të javës së parë njëra nga arkat ishte boshatisur.

«Kushedi, mendova me vete, e kanë çuar fëmijët në furrë ose ja kanë dhënë ndonjë komshiu.»

Një ditë u ngrita herët se kisha për të nisur një porosi për në Tiranë. Sapo kishte zbardhur. Atë

kohë edhe plaku po nisej për në punë. Dolëm bashkë. Ai kishte hedhur krahut një torbë të hirtë mbushur plot. Dukej që ishte e rëndë, se ja tendoste fort gjalmin mbi sup. Kur kaluam pranë klubit ai u kthye të merrte cigare. Torbën ma la mua. Nga kureshtja e hapa. Hoqa një pecetë të lidhur ku ishte mbështjellë buka e mëngjezit dhe...

Torba ishte mbushur me panxhar të grirë riska-riska.

— E paske mbushur sikur do shkosh një javë në mal — i thashë kur mori torbën, pa e bërë veten.

— More edhe për sot s'na del, ti thua për një javë. Jemi tre ne.

Dhe kujtova pendën e qeve të kooperativës me të cilën punonte që prej katër-pesë vjetësh plaku.

Të nesërmen në mëngjez ai e gjeti torbën të mbushur me panxhar të grirë. Kur u kthye nga puna më tha:

— Ke të fala nga Bardhua e nga Balashi.

— Vetëm mua? — i shkela syrin duke treguar nënën.

— Edhe sat ëme i marrin dorën — qeshi plaku.

— Posi, posi... Se mos mbetën qetë e kooperativës për dy qillo panxhar që u shpie ti — ja ktheu plaka si me qesëndi, por pa inat.

Në sytë e tij jepte dritë shpirti i bujikut.

— Lodhen qetë, grua, lodhen.

AKTI I FUNDIT I DRAMËS

E gjeta dramën në aktin e fundit. Heroi, pasi kishte kaluar nëpër vorbullën e ngjarjeve, tani jepte e merrte me ato monologët e gjatë e të heshtur...

Bërxollat avullonin duke përhapur aromën e erëzave. Kamerieri solli birrën.

— Raki! — tha prerë dhe rëndë heroi. Fjala e tij e vetme u rrokullis nëpër heshtje si një teneqe bosh nëpër shkallë.

— Hë?!

— Rakia...

Ç'është e vërteta unë xheku e kam pirë rakinë, natyrisht me raste, ndërsa ai, kurrë. Po tani që është në dramë... Mbase jo më kot shkrimtarët e fusin aq shumë rakinë nëpër drama!

— Mos e bëj kaq tragjike! — thashë prapë unë, më shumë sa për t'u ndodhur në muhabet.

Ja, kështu, nëpër këtë gjendje të turbullt kisha hyrë në dramën e shokut tim. Njëfarë prologu të saj e kisha dëgjuar që në tren. Një i njohur më tha se Kujtimi ishte ndarë me të shoqen. Kjo e papritur m'u duk e pabesueshme. Unë e kisha njohur gruan e tij që në fejesë. Më vonë edhe më mirë. Tani isha vetë në ato ujëra dhe thosha gjithmonë me vete se

sa mirë do të qe sikur të më qëllonte ndonjë grua si ajo Ida e Kujtimit. Kurse ajo...

— Thonë se e kanë kapur me një tjetër. . .

Atë që më tregonte s'e njihja për gënjeshtar por prapë s'më bëhej t'i besoja. Megjithatë mallëkova veten që isha nisur në këtë drej shërbimi. Dhe ç'kisha hequr për ta rregulluar se. . . Se të them të drejtën jam ca hileqar për punë shërbimesh, gjithmonë nuhas rrugët që të shpien te shokët e te miqtë. Shërbimi domosdo është detyrë dhe atje ku shkoj punën s'e lë kurrë pa bërë po si i thonë fjalës, një rrugë e dy punë. Kështu që shokët e miqtë e mi s'kanë pse të ankohen se, në mos tri po të paktën dy herë në vit u shkoj pa tjetër.

Dhe ja tani që mora vesh ç'i kishte ndodhur Kujtimit tërë entuziazmi im iku e vate. E mallëkova veten që isha nisur. Për Kujtimin më vinte keq. E njihja mirë. Si njeri i turtë e me karakter të butë s'para i pëlqenin dramat. Do ta kishte vështirë i ziu. Po ajo drej ç'desh më tepër! Kështu nga pamja Kujtimi është alamet djali, i mbledhur e për shtëpi po si ai. . . Për të dashur me ç'dija unë e donte shumë të shoqen. . . Ç'të ishte kjo lajthitje kaq papritur?

Vendosa që me të mbëritur në qytet të zija një dhomë në hotel e të mos e takoja. Pasditeve s'do të lëvizja shumë. Megjithatë ishin dhjetë ditë të shkretat. Ku i dilej me ilegalitet! Veç kësaj mua më njihnin pothuaj të gjithë shokët e tij. Po fundja në do të më dilte ndonjëherë përpara do të bëja sikur s'dija gjë dhe do t'i thosha se sapo kisha mbërritur. E di dhe vetë që kjo s'është aspak e ndershme për një shok të ngushtë, por ja që kështu jam gatuar.

Me të zbritur nga autobusi fillova të zbatoja

pikë për pikë planin e ilegalitetit tim. Kalova rrugicave dhe zura vend në një hotel në qoshe të qytetit ku ma merrte mendja se s'ja zinte këmba Kujtimit. Nata e parë kaloi mirë. Edhe e nesërmja gjer atëhere kur do të dilja për të ngrënë darkë s'vajti keq. Dy ditë po iknin. Tetë të tjerave do t'u bija shkurt. Ky mendim sikur më lehtësoi dhe si i liruar nga një brengë ndjeva uri. U ngrita. Por, s'kisha veshur ende mirë njëren mëngë të xhakëtës kur hapet dera pa trokitur dhe... Kujtimi.

Atë çast ra një tërmet i fortë që e ndjeva vetëm unë. Ai rrinte me duar në xhepe.

— Mirë mbrëma, shoku Kostë!

Buzëqsha dhe desha ta përqafoja por s'ma mban-te. Ai u ul mbi shtrat, mori një cigare nga «Arbëria» ime (në shërbime unë pi gjithmonë Arbëria) dhe e ndezi. Instinktivisht po merresha me xhakëtën, e rregulloja nga supet, e tërhiqja nga mëngët, nga poshtë... Duart vepronin jashtë vullnetit tim sikur të mos ishin të miat po të një rrobaqepësi që po më bënte provën e xhakëtës.

— Paskë bërë xhakëtë të re, shoku Kostë..!

— Kush të tha që kam ardhur?

— E bukur dhe kjo e jotja! Hajde, Kostë, Kostë!

U ula në krevatin përballë dhe siç merret me mend e ndeza edhe unë. E kisha humbur fare.

— Ç'kemi andej? — tha ai.

— Punë, telashe, shërbime... .

Mezi gjeta dhe unë një shteg për të folur si njeri dhe kujtova se do ta merrja veten. Por më dukej se ai s'më dëgjonte. Mora zemër dhe e pashë drejt e në sy. Kujtimi s'ishte më ai i pari. Dukej i vrarë dhe i plogët. Më erdhi keq. Dhe më tepër më vinte inat që s'kisha si t'ja bëja, ç'të thosha! Ta

pyesja për pleqtë!? Po si ta kaloja nusen!? Ta pyesja edhe për atë, demek se s'dija gjë... më dukej shpejt t'i hapja plagën, duke ditur edhe ç'kirurg i fortë jam. Dhe e pyeta kot:

— Po ç'kemi këtej?

— Punë, telashe, drama...

Ma mblodhi. T'i thosha që e kisha marrë vesh më vinte turp se do mendonte që për këtë s'i kisha shkuar në shtëpi. (Se kur shkoj me shërbim në B. ai s'më lë kurrë në hotel).

— Pse ma punove kështu?

— Hë, mo, si bëhesh edhe ti!.. Do të rri këtu sa të ngopesh, dhjetë ditë. Do të vija nesër nga shtëpia.

Ai s'foli më. Me bishtin e «Arbërisë» ndezi një nga «Partizani» i tij. Kisha ethe. Kaluan çaste kësh-tu, me heshtje, me fjolla tymi, me ethe.

— E more vesh?

Kjo ishte bombë. Një copë e saj sikur ma këputi gjuhën. Kjo ka qenë një nga përgjigjet më të vështira në jetën time. Do të më pëlqente të isha i guximshëm e t'i thosha po. Në mos le të isha gjënjesh-tar e t'i thosha jo. Në fund të fundit le të isha hipo-krit atë çast e të habitesha nga pyetja e tij. Por fatkeqësisht nuk isha asnjëri. Vetëm e pashë në sy me një hutim të pakuptueshëm. Vura re se diçka lexoi në sytë e mi. Ndoshta frikë. Dhe u ngrit.

— Dalim?

U ngrita si një mekanizëm. Ai ecte përpara. Tani vetëm një gjë kisha të qartë, ai kishte arritur në aktin e fundit, luftonte me veten. Edhe sytë e lodhur, edhe zëri i plogësht, edhe balli i shkarë, madje edhe hapat e tij të zvargur tregonin lodhje lufte. Për herë të parë mendova se kjo drej natyre që kisha

ishite fatkeqësi për mua. Ecnim përmes bulevardit. Unë kërkoja të gjeja midis shëtitorëve spektatorët e dramës. Ashtu si e dija unë punën e Kujtimit më thosh mendja se spektatorët do të ishin të shumtë. Por s'po i ndeshja shikimet e gjuajtura vjedhurazi të kureshtarëve.

«Epo gruaja s'i paska vënë brirë» — thashë me vete.

Ky mendim më lehtësoi e sikur u bëra burrë.

— Si dreqin...

Vetëm kaq. Dhe ai më tregoi aktet e tjera ashtu me copëra frazash të përziera me heshtje. Edhe në tregimin e tij dukej lufta. Ishim futur në birrari.

— As unë s'e marr vesh... U zumë... Për një grindje me pleqtë...

— Për këtë iku?

— Edhe vetë s'e di akoma mirë, iku apo e përzura...

Dhe kërkonte nëpër heshtje sikur do ta gjente atë çast të vërtetën.

— Ndodhi fare papritur... Një mbrëmje, para një jave... Unë po kthehesha nga mbledhja. Isha i lodhur e nevrrik. Poteren e dëgjova që pa hyrë mirë në korridor. Dhe që aty sikur e parandjeva që do të ndodhte diçka. Të thashë, isha shumë nevrrik nga mbledhja, i kishim bërë gjyq një maskarai. Diç më tërhiqte drejt sherrit. Sapo hyra në dhomë nëna ja dha të qarit.

«Po ç'u bëre, mor bir, se na mbyti jot'shoqe... Na mbyti...»

Ida që bërë flakë në fytyrë. Buza e poshtme i dridhej nga zemërimi.

— Ç'keni? — thirra unë.

— Janë çmëndur të dyja — tha babai.

Po zieja i tëri. Nëna më lutej që ta bëja zap gruan. Ida më kishte ngulur sytë dhe priste përkrahje. Babai i shante të dyja dhe kërkonte aspirina. Ishte hera e parë që ndodhesha kaq hapur midis dy zjarresh. Nëna qante dhe më thoshte se nusja e kishte sharë e vetëm kurvë që s'i kishte thënë. Ida më thoshte se nëna gënjente. Dhe plasa gjersa mësova diçka të saktë për ç'kishte ndodhur.

Ida ishte kthyer në shtëpi pa vajzën. Nëna e kishte pyetur dhe ajo i kishte thënë se e kishte marrë nga çerdhja dhe e kishte çuar te i ati. Do ta linte aty gjersa të shërohej plaku im. Mjeku tha se gripin e ka të fortë e ngjitës. Ida kishte frikë mos i ngjitej vajzës... Nëna ishte xhindosur. Një fjalë njëra e një fjalë tjetra dhe kishte plasur.

«Ti e këtilla, e atilla! Na zaptove djalin... Tani po na zaptton edhe çupën... Plaku s'ka verem... Ikë e sill çupën në shtëpi...»

Ida s'kishte pranuar. Ç'është e vërteta vajzën s'e kemi aq të shëndetshme dhe ajo e ruan shumë. U ndez shamata.

«Ti kështu je... Se mos çan kokën për ne! Mbetete jot'ëmë...»

Nëna ja kishte numruar të gjitha... Midis tyre kishte kohë që dukej një luftë e ftohtë. Kishin këmbyer edhe ndonjë fjalë por unë gjithmonë i shuaja këto shkëndija... Kështu më dukej, se në të vërtetë i paskam mbuluar. Kur më ankohej Ida për nënën i thosha të mos ja vinte re se pleqtë janë si fëmijët, kur më ankohej nëna i thosha se Ida ishte e re e do të mësohej. Kemi dobësira të gjithë, dreqi e mori...! Nuk e sheh dot nënën të mërzitur!

.....

Një herë nëna u nxeh keq se Ida kishte mbledhur gjithë çarçafët dhe i kishte shpënë për t'i larë në lavanderi. Një herë tjetër na erdhi një kushëri nga fshati, me gjithë të shoqen, për të ndenjur nja dy net. Kur do flinim nëna tha që t'u lironim kre-vatin tonë. Ida s'donte. I tha se kishim shtresa e t'u shtronim në dhomën e pritjes... Një herë tjetër... Kush e mban mend!..

Po kohët e fundit këto gjëra po shtoheshin. Dhe unë gjithmonë i thosha Idës të mos ja prishte qejfin nënës. Ajo më bindej megjithëse gjithmonë e më me zor. Bile ca ditë para se të ndodhte kjo u grindëm gjer në mesnatë.

Ai heshti përsëri. M'u duk se seç do të thoshte për Idën, por e kapërceu.

— Dhe puna arriti gjer këtu. Më në fund kishte plasur ajo që pat zjerë kaq kohë. Vajza ishte vetëm shkak.

«Ti ke rroitur! — thoshte nëna — Ç'të duhej të martoheshe kur s'je për burrë, për vjehrrë e për fëmijë?... S'të kemi marrë për sytë e bukur... Sa më kanë lutur mua për djalin..!»

«Unë s'e mora me zor!»

«I hodhe trutë e gomarit. Sot më hoqe foshnjën nga shtëpia, nesër do të heqësh edhe tët shoq... Ta di mendjen ty unë... Ti kërkon të ndahesh. Domosdo... kush i do pleqtë barrë në kurriz!»

«S'ka thënë njeri për t'u ndarë».

«Moj po s'të lë unë të më nxjerrç djalin nga dora... Atje i kam sytë e mendtë... Je nuse, moj derëzezë! Mos do të të mbajmë në pëqi zotrote? Ti duhet të bëhesh copë për ne, copë të bëhesh!»

«S'ju kam lënë gjë mangut më duket... Me sa kam mundur».

E fjalë pas fjale nëna tha:

«Ti je çmendur!»

Ajo ja pat:

«Ti je matufepsur!»

Heshti sërish dhe hoqi thellë cigaren.

— Këtu e gjeta sherrin. Nëna siç të thashë ja dha të qarit me të më parë. M'u dhims shumë. Kam një dobësi të tmerrshme për të! Dhe nuk di pse më çmendte ai shikimi krenar i Idës!

«Kësaj i ka plasur cipa! — thoshte nëna — Kjo është e poshtër!»

Ida më tha mua:

«Kjo është matufepsur fare!»

Më pushtoi një e ngjethur e tmerrshme.

«Mbylle gojën!» — Unë nuk bërtita. Por fjalët e mia që mezi dëgjoheshin ishin një ulërimë e mbytur nëpër dhembë.

«S'më la gjë pa thënë» — vazhdonte nëna.

«Gënjen!» — tha Ida. — «S'ke turp!»

Dhe atë çast unë isha vetëm një instinkt. Bërtita sa më dhembën mushkëritë:

«Mjaft!»

Për çudinë time sytë e Idës u ndezën më keq. Dhe m'u shkreh:

«S'ke faj ti jo... Unë e kam fajin... Të kam dëgjuar gjithmonë. E kam mbyllur gojën... Të mos ja prishnim qejfin mamasë... Po unë nuk mund të duroj tërë jetën...»

«Merr vesh ti, apo jo!? Mjaft!»

Por ajo e ngriti edhe më shumë zërin:

«Të kam dëgjuar gjithmonë! Dhe jam nënshtruar... Po unë nuk jam shërbyese këtu!»

«Është çmendur!» — tha nëna.

«Unë nuk jam çmendur po ti...»

I zura gojën me dorë. Ajo ma largoi me forcë:
«Faleminderit!»

Edhe zëri i saj ishte një ulërimë nëpër dhëmbë.
«Ose mbyll gojën ose...»

Dhe, ta marrë dreqi... që atë çast e kuptova se s'kisha për të thënë më shumë se aq... po të thashë isha i tëri një instirkt... Ajo nuk foli po më pa ngultas. Flegrat e hundës i fërfëllonin. Dhe unë... i tregova derën. Ajo zbrazi frymën gjer në fund sikur do të derdhte gjithë ç'pat për të thënë dhe iku.

«Mirë ja bëre!» — tha nëna.

Unë dola nga kuzhina pa folur. Dera e korridorit ishte e hapur. Ajo ngjethja e tmerrshme më pushtoi prapë. Nuk guxova ta mbyllja. Shkova rë dhomë dhe u shtriva në shtrat. Gjithshka më dukej e çuditshme dhe sikur s'kishte ndodhur me ne... Dola dhe e përplasa derën fort. Diçka duhet të përplasja.

Tërë atë natë nëpër kllapi më dukej sikur trokiste dera.

.....

Ai trokiti gotën e tij pas times. U shpërgjuma. Kisha hyrë i gjithi në dramë dhe pa e kuptuar isha bërë dublanti i rolit të tij.

— Gjashtë ditë sot! — tha Kujtimi.

— Shumë! — thashë unë pa e menduar mirë përse.

Ai rgriti sytë.

-- Bela! — sikur desha të justifikohesha.

Dhe lufta e heshtur vazhdonte.

— Ç'do të bësh tani?

— E kam vrarë shumë mendjen këto ditë...

Prisja. Natyrisht përgjegje s'mund të merrja. Ai edhe vetë priste ende. Kërkonte dhe priste. Tre-

gimi i tij më kishte bërë shumë përshtypje. Kishte treguar butë, me dhembje. Më dukej se ai nuk e gjykonte Idën.

— Ç'mendon? — Më pyeti.

— Ti e do Idën?

Uli kokën dhe sillte gotën midis gishtërinjve nervozë. Dhe e toku përsëri me timen.

— Jam lodhur shumë këto ditë!

— E rëndë!

— Jo vetëm e rëndë, Kostë! E vështirë, e ngatërruar... Më dhemb koka shumë.

Mendonim. Mendohesha t'i vija në kandar fajet e të gjithëve. Nganjëherë shikoja sytë e tij. S'më dukeshin aq të turbullt si atë çast, kur erdhi në hotel. Diçka ndriste nëpër turbullirë.

— E do Idën!? — përsëriti fjalët e mia me një nënqeshje. Ishte një pohim dramatik nga ato që dinë t'i shpjegojnë vetëm regjizorët.

--- Nëna ka faj, Kujtim.

— E dua shumë.

— Jemi të rinj...

— E kam nënë, Kostë!

— S'duhet të bëhemi sentimentalë!

Ai psherëtiu:

--- Sa jam lodhur. Qenka e tmerrshme kur rënke midis zjarrit të dy dashurive.

— Po, duhet të jemi realistë.

Fjalët e mia i bënë mirë plagës së tij.

— Gëzuar!

Ishte hera e parë që uronte të tryezë. Ngjyrat e heshtjes ishin çelur ca. Dhe përsëri ai pëshpëriti fjalët e mia. Kësaj here me buzëqeshje.

— E do Idën?

Në sytë e tij po shtohet drita. E kisha parandjerë që kur më tregonte.

— S'e marr me mend, sa jam lodhur, Kostë?

Edhe zëri i tij po kthjellohej.

Dhe përsëri heshtje, por një heshtje e çuditshme. S'e mbante vendi. Gjithshka te ai kërkonte lëvizje, sytë s'i përqëndronte dot gjëkund, buzët mërmërisnin, duart s'linin gjë pa kapur mbi tryezë.

U ngrit dhe i shkoi kamerierit te banaku. Kur u kthye thuj se vraponte.

— Çohu!

Më futi krahun. Ecnim shpejt. Përsëriste fjalët e mia si refren:

«E do Idën!?»

Ecnim kot. Ai donte lëvizje. Dhe u gëzua që i lindi një mendim kaq i rëndomtë:

— Do të shkojmë në kinema!

Unë i kisha parë reklamat që në mëngjez kur kërkoja qoshe të fshehta për t'ju vjedhur syve të tij.

— Është film mizerje. Do çmendemi.

Ai as që ma vuri veshin. Heshtte dhe përsëriste refrenin e tij.

Kur u afrum te sporteli u grindëm ca. Ai kishte paguar ç'kishim pirë. Të paktën biletat do t'i prisja unë.

— Dy! — i thashë sportelistit.

Kujtimi më kapi për krahu.

— Tri.

E pashë.

Ai qeshi me gjithë shpirt:

— E do Idën!?

PËRTËRITJE

Kryetari erdhi dhe u ul pa fjalë në krahun tim. E përshërdeta me kokë dhe vazhdova të shkruaja. Njerëzit derdhnin gëzimin e tyre për dritën dhe unë e mblidhja me sa mundja në faqet e blokut tim. Shtëpia ku kisha shkuar ishte e re. E re shtëpia, të reja shumica e orendive, të rinj dhe njerëzit. Ndërtesa kishte mbaruar nja dy muaj e ca më parë, por të zotët e kishin lënë ashtu dhe hynë këto ditë bashkë me dritën. Për këtë po më tregonin. Flisnin të gjithë: plaka, plaku, djali, nusja, fëmijët.

Kur muhabeti u duk se reshti për një çast dhe vazhdoi me një refren buzëqeshjesh, ku merrnin pjesë të gjithë, kryetari mendoi se ishin thënë ç'më duheshin mua dhe u ngrit:

— Tani na falni! — u tha të zotëve të shtëpisë.

Natyrisht ndarja nuk ishte aq e lehtë. Nuk del dot kollaj nga shtëpia e fshatarit, sidomos në të ngrysur, kur po delnim ne. Megjithatë kur u tha kryetari se do të shkonim te Beqiri për darkë u bindën shpejt. Kjo më bëri shumë përshtypje dhe mundohesha të merrja me mend se ç'mund të ishte ky Beqiri.

— Pate fat! U kthye xha Bequa. — më tha kryetari në të dalë dhe ma shtoi më shumë kuresh-tjen. Ndërsa morëm rrëzë një bokërrime ai nisi të më tregonte:

— I la të shtatëdhjetat xha Bequa... Po ç'të të them, xhevahir njeri! E di. Ti e ke hallin te dritat, po aty do të dal edhe unë. Javën e kaluar si mbaruan instalimet në lagjen e poshtme, elektrikistët morën këtej sipër. I erdhi radha edhe xha Beqirit. Djemtë hoqën nga supet turrat e telave e çantat me vegla, ç'kishin dhe u ulën të çlodheshir. Xha Bequa u dha duhan e plaka, se vetëm plakën ka Bequa, u nxori nga një gotë qumësht. Si mbaruan cigaren djemtë u ngritën.

— Ku e ku do t'i vesh dritat, xhaxho? — e pyetën.

— Juve ju lumshin këmbët e më rrofshi po unë s'do të vë dritë.

Ata u habitën dhe panë njëri-tjetrin.

— Ne dy pleq jemi, sot për nesër, me një këmbë në dhé... Me këtë kandil që na bëri kaq do t'i shtyjmë edhe këto pesë ditë që na kanë mbetur.

— Bëmë një vit të tërë që punojmë në këto anë po s' kemi gjetur njeri të thotë se s'do dritë — tha njëri nga elektrikistët.

— U ngrysmë ne tani, bir...o! Edhe shtëpia do regulluar, do çati të re, po do qëndrojë gjersa të na nxjerrë ne. Kështu edhe për dritën. Fëmijë s'kemi. Një që patmë siqe kësmet të na bëhej. Ç'e duam dritën! Plaka s'ka për të punuar gjergjefin. Apo do të këndoje librat unë!

Djemtë e shkretë u munduan t'i mbushnin merdjen. I thanë se instalimet s'kushtonin një djall e gjysmë sa mund të mendonte ai. Edhe nga drita s'do të kishte ndonjë shpenzim kushedi se sa. Ai s'e bënte veten.

— Jo mo, s'e kam aty... Po bëjmë si bëjmë

edhe me kandil ne. Vazhdoni më tej ju... Ju lumshin krahët!

Elektriciçistët panë ç'panë dhe u nisën më tej. Megjithatë ja vunë dy izolatorët në qoshen e murit për lidhjet e jashtme.

— E kështu që thua ti — vazhdoi kryetari — Xha Bequa s'desh që s'desh t'i vinte dritat. Elektriciçistëve u qe mbushur mendja top se plaku pa tjetër e kishte hallin te shpenzimet. Kishin njëfarë të drejte. Edhe unë pata dëgjuar kur u thoshte njerëzve:

«Ja, u bëra shtatëdhjetë. Po këmba e dora s'më ka lënë. Këta të kryesisë më ndihmojnë, më gjejnë punë të lehtë dhe gjer tani i kam bërë nga nja tre-qind ditë në mot. Po nesër në mbetçja ulok! Se pleq jemi de... Kështu që duhet menduar edhe për më të keqen!»

— Ne gjithmonë e kemi ndihmuar dhe do ta ndihmojmë. Kopështin personal ja lërojmë e ja mbjellim, edhe shtëpinë në pranverë do t'ja rregullojmë. Po si njeri i ndershëm që ka rrojtur tërë jetën me djesën e ballit i vjen rëndë. Sa për punë të dritave nuk është vetëm halli i parave. Ai ka patur një djalë. I vdiq këtu e nja katër vjet të shkuar nga një hemorragji cerebrale. Ishte nja shtatëmbëdhjetë — tetëmbëdhjetë vjeç. Që atëherë, burrë e grua e kanë humbur, s'u hyn gjë në sy. Janë vrarë shumë! Në fshat, e aq më tepër për atë moshë që kanë ata, s'është shaka të mbetesh pa fëmijë. Megjithatë xha Bequa ka qëndruar më mirë se ç'mund të qëndronin shumë të tjerë më këmbë të tij. Njëpër dasma e gëzime të tjera qesh e këndon e bën shaka. Po zemrën prapëseprapë plagë e ka. Mbyllen në shtëpi burrë e grua e japin e marrin me njëri-tjetrin. Me një fjalë, o ti vëlla, u është mbushur mendja top se gaz për

ata s'ka më. Këtu lidhet edhe ajo puna e dritës. Ç'është e vërteta tërë fshati sillet shumë mirë me ta, u shkojnë shpesh në shtëpi, i ftojnë për çdo rast, po plagët e zemrës në pleqëri s'u shërokan kollaj.

Një copë rrugë s'folëm.

— Po pastaj si u bë puna e dritave të xha Beqos?

Kryetari vuri buzën në gaz:

— Domosdo që i vumë... Por i vumë pa e pyetur... Kur më treguan elektriciçistët ç'u kishte ngjarë me plakun u thashë se do të flisja vetë me të. Po atë ditë më thirrën për dreq në seksion të bujqësisë, për një ngatërresë me ata të transportit... Po na e vononin shumë plehun kimik. Nejse. Kur u ktheva s'e gjeta xha Beqon. Plakën e kishte zënë një e prërë në stomak e ndihmësmjeku që kemi në fshat i kishte thënë se duhej çuar në spital. Kishte rrezik t'i pëlçiste. Kur e zbritën të sëmurën në qendër të kooperativës dhe e hipën në maqinë i thanë xha Beqos të kthehëj se në spital do ta shpinte ndihmësmjeku, por ai kishte ulur kokën pa folur dhe qe futur në kabinë. Në mbrëmje kur u kthye ndihmësmjeku na tha se Fetia e kishte kaluar rrezikun por xha Bequa kishte merak e qëndroi në spital. Prita edhe të nesërmen gjer në drekë po plaku s'u duk. Pyetëm në telefon. Na thanë se plaka ishte mirë.

— Xha Bequa s'ndahet nga plaka po, o burra, t'ja vëmë dritat vetë — u thashë elektriciçistëve.

Dhe ja hapëm shtëpinë. Aty më të errur, ja në këtë vakt kështu, i dhamë fund. E pastruam dyshe-menë, vumë nëpër vende gjëra që patmë luajtur dhe ikmë. Dje në mëngjez më erdhën në zyrë nja tre-katër nga të rinisë:

«Kemi menduar një gjë — më thonë — t'i ble-

jmë një radio xha Beqos, propozoi Selvia mbrëmë në mbledhje. Të gjithë ishim dakord. Lekët i kemi mbledhur. Po kemi hall mos na zemërohet xha Bequa. Prandaj erdhëm këtu... Sikur ta rregulloni këtë punë...»

— S'më beson sa m'u bë qejfi. Të them të drejtën s'më kishte shkuar nëpër mend kjo e rinisë. Ja shpunë edhe radion e ja vunë mbi oxhak.

Unë qesha me vete.

— Hë? — pyeti kryetari.

— Thuamani të shkretën, ç'bëri xha Bequa kur u kthye?

Tani qeshi kryetari:

— S'di gjë, tani do ta shohim bashkë se ç'po bën. S'ka dy orë që është kthyer. S'e linte plakën vetëm. E priti dhe erdhën të dy.

— Rrugën që na kishte mbetur e bëmë pothuaj pa fjalë.

— E paska ndezur! — më tha kryetari dhe më tregoi dritaren e vogël të një shtëpie të ulët.

— Si u afruam qëndruam një çast në oborr. Ajo që pamë ishte mallëngjyese! Plaku luante me hijen e tij si fëmijë. Dhe qeshte. Plaka ishte ulur në qoshe dhe e shihte e hutuar.

Kryetari trokiti.

— Bujrum! — thirri plaku që brenda dhe pa u shuar ende zëri i tij hapi derën.

Kryetari i shtriu dorën, por ai ju hodh në qafë dhe e puthi në të dyja faqet. Më puthi edhe mua. Pastaj na kapi për krahu dhe na tërhoqi brenda. Dhe thoshte papushim:

— Ju lumshin këmbët! Ju lumshin këmbët!

Nga sytë e tij rridhnin vezullime. Ai ishte i tëri një gaz i madh e i papërmbajtshëm.

— E gëzofshi dritën! — uroi kryetari.

— Me shokë e me miq! Me shokë e me miq!

Xha Bequa doli dhe i bëri zë kushedi se kujt nga komshitë. Ai që ju përgjegj dukej nga zëri që ishte i ri.

— Hidhu një vrap, bir i xhaxhait, dhe thuaju të vijnë sonte...

— Kë?

— Njerëzit, bir! Kë të gjesh! Sa më shumë!

— Njerëzit!? Po kë?

— Kë të mundç! Kë të gjesh!... Po atë mos harro, aman, atë Selon... Është zjarri i këngës ai qerrata!

Plaka dëgjonte e ngazëllyer dhe qante. Pastaj dëgjuam kakarisjen e pulave të trembura dhe klimën e një gjeli. Fetia doli.

— U hapëm telashe! — i thashë kryetarit.

— S'ka gjë! Këtu është me gjithë mend për të bërë një gaz të madh!

— E, si jam unë sonte, si jam unë... Pesëmbëdhjetë vjeç djalë! — ja pat që në derë i zoti i shtëpisë.

— Të them të drejtën, xha Beqo, s'e prisja të të gjeja kështu — tha kryetari. — Edhe ata të rinisë erdhën e më thanë për radion.

Plaku ja preu fjalën:

— I mora vesh të gjitha! Të gjitha i mora vesh! E, ju paça sa malet, o bij, ju paça! Po ju s'të lini të vdeç bre! Po mos kujto se unë kam qenë kokë derr, o kryetar! Jo, or, jo! Tërë këto kohë luftë ka bërë xha Bequa. Ja, këtu. Dhe i ra gjoksit me grusht. Luftë. O, luftë! Po dhashë e dhashë e s'mbaj dot më, or de! Ju shëroni gurin e jo mua! Ore, për... për kokën tuaj unë do të bëj dasmë sonte.

Kryetari u ngrit dhe hapi radion.

— Ngrija zërin... Ngrija gjer në fund. Të bucasë. Është gjallë Bequa, kryetar! S'të lini ju të vdeç, or, jo!

Filluan të vinin fshatarët.

— Bujrum! Bujrum! O ju lumshin këmbët, ju lumshin!

Dhe shkante e vinte me këmbë të lehtë plaku nëpër shtëpi:

— Plakë, moj! O grua! Ku e ke lënë rakinë, moj e uruar!

Përsëri alarm në kotecin e pulave.

Pas gjysmë ore dhoma ishte mbushur plot. Ishte më shumë se një dasmë. Xha Bequa i shikonte të gjithë me radhë dhe ngazëllehej. Shikonte dhe llambën elektrike në tavan e dritën e saj e ndjente thellë në trup, gjer në palcë.

Si ishin shtruar mezetë xha Bequa e mori Fetien pranë vetes.

— Ti e ke vendin këtu. Tani le të shërbejnë të rinjtë. Merre gotën!

Dhe pleqtë u ngritën në këmbë. Dëshën të flinuin. U panë në sy si s'ishin parë kurrë në jetën e tyre. Sa shumë deshën t'u thoshin atyre njerëzve që po prisnin me gota në dorë! Por për gëzimet e mëdha fjalët janë të vogla! Xha Bequa u kapërdi disa herë. Feties ju drodh mjekra.

— Ta pimë... — Por ai që kishte pirë një lumë raki në jetën e vet e që kishte ngritur mijëra dollari s'gjente dot një fjalë në shtëpi të vet.

— Për partinë — u hodh një nga të rinjtë.

— Të sajat qofshin edhe këto pesë ditë të bardha që na kanë mbetur neve pleqve!

Xha Bequa nuk foli por brohoriti.

— Amin! — zbrazti shpirtin Fetia.

Dhe askujt s'ja vrau veshin kjo fjalë, që me
dhjetëra breza ka gjunjëzuar njerëzimin para së pa-
qenës. Ata tinguj ishin një vërshim zemrë.

Pleqtë ngritën gotat. Dhe qanin të lumtur!

Në sytë e tyre gjeta një titull të bukur:

PËRTËRITJEN

BREGU...

Ishte nata e parë.

— Ç'ke? — e pyeti ai që ishte poshtë.

Flinin në krevate marinari, dykatëshe.

— Ftohët! — tha Alekua.

Ishte mbrëmje gushti.

— Unë po fle — tha përsëri ai që ishte poshtë.

Alekua s'lëvizi. Në fund të barrakës dy punëtorë luanin domino. I përplasnin gurët fort mbi tryezë.

Ishte nata e parë.

Maqina e la në xhade. Shoferi i tregoi me dorë një grykë malesh dhe ishte nisur. Kishte rënë shi. Në këmbë i rëndonte balta e kuqe. Mbi supe dyzet vjet. Në kokë një rrëmujë mendimesh. Qeshi hidhur me vete:

«Në prodhim, për riedukim!»

Me këtë motivacion të thjeshtë të kolektivit kishte marrë këtë rrugë të re mes malesh. Ecte dhe shpëstjillte fillin e asaj mbledhjeje të gjatë e torturuese. Ndërlidhësit e dinë ç'do me thënë të shpëstjellësh turrën e telit duke ngjitur shpatet. Po të shpëstjellësh lëmshin e mendimeve duke tërhequr pas vetes edhe rimorkion e rëndë të sedrës!? Ecte dhe djersinte. Nëpër këto male fjalët e punëtorëve

në atë mbledhje seç kishin një oshëtimë të çuditshme:

«Të duket se pa ty kantierin e merr lumi! Rri, o shoku Leko, për kokën tënde! Po ne ç'bëjmë këtu!? Bar hamë?»

«Oj, po një fjalë s'të thotë dot njeriu se kërcen përpjetë sikur të ka ngrënë zekthi. Çudi e madhe!»

«Ti një, dy, o vëlla dhe... E di unë! Kështu them unë! Kështu është e s'ka si të jetë ndryshe! Do të bëhet kështu e pikël!»

«Sa herë të kemi thënë, mor shoku Leko? Sa herë? Ti në tënden që në tënden. Epo u mbush kupa de...»

Në fillim ai ishte revoltuar nga fjalët e punëtorëve, kishte bërëtitur, ishte ankuar se po e merrnin nëpër këmbë, po fjalët e tij s'ngjishnin gjëkund. Punëtorët ja kishin nisur shtruar e po i shikonin gjërat një për një. Dhe ishin të gjithë të një mendimi. Kjo e vriste më shumë Lekon. Ajo e folur e punëtorëve, ashtu urtë e butë, pa u nxehur, pa bërëtitur atij i dukej hipokrizi. Dhe për një çast ju mbush mendja top se ishin ngritur kundër tij për ta hequr qafe e pastaj të bënin si të donin, se zor të gjendej njeri që t'ua mblidhte rripat si ai!

Dhe filloi të djersinte si s'kishte djersitur kurrë. Mbledhja vazhdonte si një zjarr i madh që digjet shtruar. Ai si u lodh së ankuari mori kokën në duar dhe fshinte djersët orë e çast. Kolektivi vendosi:

«Në prodhim, për riedukim!»

«Do të të bëjë mirë. Ja, ke për të parë, e do të më kujtosh» — i pat thënë saldatori plak, xha Nakua sikur po e përcillte në ndonjë vend klimaterik. Dhe i kishte rënë shpatullave.

Të nesërmen Alekua kërkoi të shkonte në kantierin më të largët. Disave u erdhi mirë e kujtuan se

ai kishte filluar të kuptonte. Kurse Alekua, i fyer gjer në kockë e i lodhur e bëri këtë që të ishte sa më larg atyre njerëzve, që e kishin shtrydhur. Me këto mend u nda Alekua me detyrën e përgjegjësitet dhe mori rrugën për në atë kantier mes maleve.

Një fshatar që zbrishte përballë tij e shikonte me vërejtje. U hutua. Si kishte kaluar fshatari ktheu kokën pas. Ai përsëri po e shihte. Dhe u kujtua se kishte qenë duke folur me vete.

— Do çmendem!

Ju dhimbs vetja e desh ta flakte atë lëmsh mendimesh që po e këputnin kësaj së përpjete. Por duke luftuar me vete gryka sikur i solli oshëtimën e fjalëve të drejtorit në çastin e ndarjes:

«Po të kesh mendjen, xhevahire do të gjesh te punëtorët» — Dhe i kishte shtrënguar dorën fort.

Por tani kishin filluar të zbuloheshin konturet e kantierit dhe atë e shqetësonte diçka tjetër më e ngutshme.

Si do ta prisnin!?

«Si dhia në mes të dhenve! Sytë e tyre do të më ndjekin ngado që të shkoj. Unë për ata do të jem edhe kinemaja, edhe teatri, edhe estrada, edhe... Do të tallen me mua... Do të sillen si me një fëmijë që s'di asgjë nga jeta e do t'ja mësojnë të gjitha! Për drejt shumë nga ata i njoh. Edhe Nuren e njoh mirë, e kam patur brigadier në kantierin tim... Kurse tani po shkoj t'i paraqitem atij, përgjegjësitet..!»

Ju kujtua një grindje që kishte patur me të para nja dy vjetësh. S'mbante mend përse qenë grindur veç e dinte mirë se ishte nxehur keq, i kishte bërtitur dhe e kishte nxjerrë nga zyra. «Qindin ka për të më punuar!» — hungëroi i xhindosur.

Por në kantier e pritën krejt ndryshe. Nurja e përqafoi si shok të vjetër, i zgjati paqetën e cigareve, e pyeti për gruan, për fëmijët, për shokët, bile mbante mend edhe për reumatizmen që kishte patur në krahun e majtë. As që ja vuri gishtin në plagë. Pastaj e njohu me kantierin, e çoi cep më cep, e njohu me shokë të rinj, i tregoi barakat e fjetjes, mençën, klubin dhe i tha të mos mërzoj se do ta kalonin mirë.

Edhe të njohurit e tjerë e pritën sikur të mos kishte ndodhur gjë.

Ai nuk dinte si ta merrte këtë pritje. Dashuri apo... Sidoqoftë këta u ngjanin shumë në çdo gjë atyre që kishte lënë në atë mbledhje të çuditshme. Kjo e ngacmonte!

E caktuan të punonte me montatorët. Shokët e brigadës as që ja zunë në gojë si e qysh e kishte punën. Dhe, ndonëse hetonte, në sytë e tyre s'gjeti kureshtje. Vetëm Nurja i tha shumë shoqërisht:

— Mos e merr me ndrojtje, Leko! Ne jemi të gjithë shokë. Në brigadë ke punëtorë të mirë, njerëz të dashur, të sinqertë... — Dhe i uroi punë të mbarë.

Meqë s'e njihnte mirë zanatin, Lekua merrej me punë të thjeshta ose u ndihmonte mjeshtrave. Po si njeri me sedër ai s'mund të vazhdonte kështu. Kishte aq forca sa t'u tregonte njerëzve se, kudo që ta çonin, ai dinte t'ja dilte punës. U fut në një kurs që ishte hapur për montatorët e rij, grumbulloi ç'gjeti literaturë dhe studjonte shumë. Dhe ecte. Me këtë sikur po i gjente kullotë edhe sedrës. E kishin dërguar për të mësuar dhe ai po mësonte, po bëhej punëtor. Në kurs dallohej, literaturës i kushtonte pothuaj tërë kohën e lirë, lëkura e duarve po i trashej.

Dita ndiqte ditën e java javën. Punëtorëve u bëhej qejfi që po i hynte zanatit me themel.

— Do të bëhet montator i mirë, — thoshte një nga mjeshtrat e brigadës.

— Montator ndoshta do të bëhet po, siç e ka zënë, punëtor si zor të bëhet — thoshin të tjerët. — E, po s'qe punëtor, s'je as montator. S'pare ja ka qejfi muhabetet me ne. Edhe këtu ul kokën, punon e s'thotë një fjalë. Pasdite shtrihet në krevat e lexon libra gjersa ngriset. Asnjë fjalë, asnjë shaka...

— Ndofta i vjen zor akoma... Do të mësohet kushedi... Një muaj ka që ka ardhur...

— Nëpër mbledhje s'ndihet fare...

— I duhet thënë. Fundja s'ka ardhur të mësojë të montojë, po të bëhet punëtor.

Dhe ja thanë:

— Duhet të biesh erë punëtori.

— Punëtorët e thonë copë, kjo është e bardhë, byrazer, kjo e zezë.

Lekua ngrinte supet.

Ç'është e vërteta tani kishte çaste, ndonëse të rralla e të shkurtëra që u jepte njëfarë të drejte punëtorëve të kantierit të tij. Po një të drejtë si të turbullt. Mbase kjo i vinte edhe prej Nures, i cili pothuaj se s'kishte zyrë fare. E gjeje qoshe më qoshe të sektorit. Punëtorët s'e thërrisnin kurrë shoku Nure por shkurt, Nure. I bënte përshtypje Lekos. Edhe një gjë tjetër i binte në sy dhe e turbullonte. Kishte raste që edhe Nurja nxehej, edhe bërtiste, edhe shante, po të tjerët s'i zemëroheshin. Dhe s'i thërriste në zyrë po u thoshte aty në mes të të gjithëve ç'kishte për t'u thënë. Këtu bërtiste, pastaj këpuste qyfyre me ta, luante edhe futboll me ta. hidhte e priste edhe shakara.

«Po fundja — thoshte Lekua — kështu është prerë Nurja. Unë jam unë».

Dhe përsëri kishte ngritur supet. E kaloi shumë i mërzitur atë mbrëmje. Jepte e merrte me vete. Kujtonte fjalët e xha Nakos, të drejtorit, të sekretarit të partisë, të Nures...

«Do të gjesh xhevahire...»

«Të mësosh nga punëtorët... Të jetosh si ata, të mendosh si ata, të ndjesh si ata...»

«Qëndrou më afër... S'ka për të të dalë keq...»

«Të biesh erë punëtori!»

Kjo ishte më e pakuptueshmja. Dhe më e padurueshmja.

«S'i marr vesh këta njerëz! Më çmendën! Çfarë të bëj më unë!? Në një kazan me ta ha, në një barrakë fle, me ta punoj... Erë graso ata, erë graso unë... Ku i kanë brirët xhanëm që s'u a shoh!? Fundja erdha këtu që të mësohem të më urdhërojnë të tjerët siç i urdhëroja unë. Gjer më sot gjysmë fjale s'u kam kthyer... Ç'duan prej meje këta njerëz!? U ka mbetur në majë të gjuhës... «Të biesh erë punëtori!» Erë djersë ata, erë djersë unë. Pse s'ma thonë copë, dreqi e mori... Të më thonë do të mësosh këtë e këtë e të më marrin në provim. «Pse s'flet?» thonë! Po ja që s'mi ka qejfi muhabetet... Kështu jam unë... Një e dy dhe «erë punëtori...» Vërtet punëtor s'kam qenë ndonjëherë po kam njohur me mijëra... Ç'dregerë na qenka kjo!?»

Një ditë u nxeh e i tha Nures:

— S'marr vesh kështu unë. M'i caktoni gjërat... Më thoni do mësosh këtë e atë e më merrni në provim.

Kishte qeshur Nurja:

— Më tregonte një ditë një bari nga këto anë!

Vjet në dimër e kishte zënë një i ftohët i madh në mal, vetëm. Natë ishte. Do të kishte ngrirë e do që bërë kallkan. Por pa një zjarr në malin përtej. Dhe shpëtoi. Ishte larg shumë. E shikonte zjarrin dhe ngrohej.

— Lëri përrallat, Nure... Ma thoni copë mua...

— Nuk është përrallë, Leko... Bariu shikonte zjarrin e largët e ngrohej...

— E pastaj?

— Desha të të them që zjarrin mund ta kesh edhe ndër këmbë e të mos e ndjesh të ngrohtët po t'u mbush mendja që është ftohët...

S'e zgjati më Lekua. Ishte i menciëm përgjegjësi i vjetër dhe i kuptonte gjërat e holla.

— Do përpiqem, — i tha kur u ndanë.

Dhe mundohej Lekua të gjente të pakuptueshmen.

— Ç'ke? — e pyeti ai që flinte poshtë.

— Zagushi!

Në të vërtetë më shumë i dukej si ethe.

— Sotiri e ka këmbën mirë. Mos u merakos.

— ...

— Fli të çlodhesh. Nesër kemi punë shumë. Natën!

Atij trupi i bumehej si toka në mars dhe i dukej sikur diçka i bulonte në gjithë qenjen e tij. Kishte kaluar java e pestë. Jashtë kishte filluar të dukej vjeshta.

Dikush nga fundi i barrakës pinte duhan shtrirë në krevat. U magjeps pas asaj xixe. Ndezjet e fikjet e saj i ngjanin një fari në një breg të largët.

Më në fund një ditë që s'kishte shkuar si të tjerat. Punonin në korpusin kryesor. Montonin. Sotiri po merrej me korrigjimin e një gabimi të djeshtëm. Kishte hipur mbi një maqinë të lartë dhe po zhvidhose blokun e transmisionit nga shtrati, se s'kishte vajtur mirë në vend. Të tjerët punonin larg. Kështu, të humbur në punë dëgjuan një thirrje:

— Shpejt!

U turrën të gjithë te Sotiri. Vërshimi i tyre e tërhoqi Lekon pas, si një bisht. Duke u munduar ta çonte në vend blokun e transmisionit, Sotirit i kishte dalë nga shtrati dhe i kishte rrëshqitur. Punë sekondash. Bloku po të binte në tokë jo vetëm që do të ishte dëmtuar keq po kushedi ç'do të kishte shkatërruar tjetër duke u përkjekur në të rënë. Sotiri provoi ta mbante peshën e rëndë me duar (dhe ka krahe jo dosido), por ajo e tërhoqi me vete. Punë sekondash. E lëshoi dhe i futi këmbën nga poshtë që të mos lëvizte. Blokut i pëlqeu pengesa prej mishi e zuri vend. Kështu e gjetën shokët. Hipën, e ngritën peshë gjumtyrën metalike të maqinës dhe e vendosën në vendin e vet. Sotiri zbriti bashkë me ta. Metali i rëndë i kishte zhvoshkur një copë lëkurë me gjithë çorape. Ja pllakosën me duhan dhe u nis për te këndi i ndihmës së shpejtë.

Kjo ngarje pra e kishte bërë për Lekon atë ditë krejt të ndryshme nga ditët e tjera. Tërë këtë skenë ai e kishte ndjekur nëpër një shastisje të pakuptueshme. Shikonte të tjerët. Vetëm ishte mpirë dhe s'kishte bërë asgjë. S'kishte thënë asnjë fjalë. Vetëm kur thanë që njëri duhej të shoqëronte Sotirin kishte bërë gjysmë hapi.

Montatorët kishin vazhduar punën. Pas pak që kthyer edhe Sotiri me këmbë të lidhur e që bashku-

ar me ta. Kishin këmbyer vetëm nja dy fjalë të rëndomta:

- Të dhemb?
- Pak.
- U vrave goxha!
- U vrava ca.

Pastaj punë, ndonjë shaka e dita prapë që kthyer në vazhden e të tjerave.

S'i flihej atë natë Lekos. Dhe në pagjumësinë e tij ndjente lëvrimin e një ndjenje të panjohur.

Kishte kaluar java e pestë.

Dy javë më vonë ndodhi diçka tjetër.

Ishte buzëmbremje dhe binte shi. Rrinin shtrirë apo ndenjor nëpër shtretër e më të rrallë hidhnin ndonjë fjalë të mërzitur. Prisinin Ndrekon. Kishte katër ditë që ishte larguar. U pat thënë shokëve se kishte të vjehrrën keq, s'dihej a e gjente me shpirt. Ata i qanë hallin e i dhanë lejë. Dhe iku. Tani po e prisnin. Kristos një shofer i kishte thënë se Ndrekuja që nisur pas tij. Por u tha dhe diçka tjetër që i vrau. Ndrekuja na kishte gënjyer. Neve na tha se do të shkonte t'i mbyllte sytë vjehrrës, kurse ai paska shkuar e ja paska shtruar në dasmë një javë të tërë. Kjo s'durohej. Mbyllur në fjetore jepnin e merrnin me vete. I këputën dhe ca të shara po xha Kamberi tha që ta dëgjonin një herë vetë nga goja e Ndrekos ç'kishte ngjarë pastaj me të parë e me të bërë. Po prisnin.

Dhe ai erdhi. Ishte lagur e përbaltur. I përshëndeti e u dha dorën të gjithëve. Ata e pritën ftohët e s'luajtën nga shtretërit.

— Ç'ka bërë vaki? — pyeti si i habitur po dukej që i dogji.

Ata s'para i kanë qejf llafet e shumta. Xha Kam-beri i ra drejt.

— Si e le vjehrrën?

— E grisi edhe këtë radhë!

U bë një copë heshtje për të përmbajtur nervat. Pastaj Kristua tha:

— Paske qenë burrë i zoti!

— S'ju marr vesh, ç'keni me mua?

— Si, ore, na gënjeve!? Alamet burra ne...

Kemi kaq vjet që punojmë tok e ti pa pikë turpi na gënjen. Kërkon lejë për të sëmurë e vete ja shtron me të pira një javë të tërë.

Ndrekua s'u ndie më. Gjithshka ishte e qartë. Shokët flisnin të gjithë, pa pritur radhë. Atij në fillim ju skuqën majat e veshëve pastaj të kuqtë e mbuloi të gjithin. Edhe Lekua filloi të ndjente të nxehtë. Montatorët flisnin ashpër e pa dorashka:

— Qenke tuaf, o t'u mbylltë! Neve po na bie bretku ta mbarojmë montimin e korpusit në fund të muajit, ti vete ja shtron dasmave!

— Qofsh ti që je, për nder! Si të bën goja të gënjesh, bre!? Pse, o, shoqëri i thonë kësaj tëndes!?

— Ç'djall të shtyu, o i uruar — tha xha Kam-beri...

Ndrekua pa e kuptuar as vetë ktheu kokën nga Alekua.

— Mirë thonë!

Vetëm kaq tha Lekua. Por peshën e vërtetë të atyre fjalëve e ndjeu Ndrekua.

— E djalloso — tha ai pa ngritur kokën.

Gjuha i qe trashur si e një të dehuri. Rrinte sa rrinte dhe fshinte djersët me cepin e xhupit të rëndë. Lekos prapë i shkrepri mendimi se ku i gjente njeriu tërë ato djersë.

Ky muhabet që dikush e quajti mbledhje të brigadës vazhdoi gjatë.

Më në fund Ndrekuua u ngrit e doli nëpër shi. Ata s'e pyetën ku po shkonte. E dinin. Pas gjysmë ore u kthye ashtu si doli, i zyrtë e i lodhur. Vari xhupin pas derës dhe u shtri mbi shtrat me sy në tavan. Të tjerët heshtnin. Ai tha:

— Te Nurja gjeta edhe sekretarin. Ua thashë të gjitha.

Prapë heshtje. Pastaj njëri nga punëtorët tha:

— Si thoni, shkojmë nga mensa?

— Unë them të shkojmë më parë nga klubi. Hedhim nga një gotë — tha Alekua dhe u habit me guximin e tij.

Të tjerët u panë sy në sy e buzëqeshën.

— Filloi të të vijë era, Leko... o! —tha xha Kamberi dhe ju kthye Ndrekos:

— Hajde, more, çohu ti!

— Ngrehu, Ndreko! — i tha edhe Kristua dhe i hodhi xhupin mbi krevat.

Ai u ngrit sikur të ishte dergjur një vit në shtrat dhe u nis pas shokëve. Alekua mbeti i fundit. I hodhi një sy fjetores cep më cep dhe u mbush me frymë për të ndjerë atë erën e çuditshme. Shokët e shikonin nga dritarja dhe qeshnin.

— Ç'ke, Leko? — e pyeti Kristua, që flinte poshtë.

— Vapë, — tha Lekua dhe shtyu batanijet në fund të këmbëve.

Ishte natë tetori. Në mal.

— Sikur s't'u fjetka sonte?

— Do ta ndezësh një herë, Kiço?

— Është vonë. Fli të çlodhesh. Natë!

E ndezi. Kishte qëndruar në breg dhe shikonte tërë atë rrugë që kishte lënë pas.

Kishin kaluar dy muaj.

Po çlodhej në pagjumësinë e kujtimeve.

XHIRIMI

— Keq! — tha i pakënaqur regjizori.

Operatori ndërpreu xhirimin. Aktorët mbetën në pozicionet e tyre.

— Keq! — thirri përsëri regjizori pa e fshehur dot nervozizmin. Dhe ju afrua aktoret:

— Je e ftohtë, Vera... Është takimi i fundit me «djalin»... Kupton? Nuk do ta shohësh më... Do të pushkatohet. Je nënë, Vera! Më shumë ndjenjë... Më e thellë, më e ngrohtë... Jo sentimentale, dreqi e mori... Je nënë e dhimbshme por edhe krenare, edhe burrëreshë... Më kupton?

Ishte e pesta herë që prapësohej xhirimi i skenës «nënë e bir».

Aktorja e dëgjonte regjizorin në heshtje dhe e kuptonte, por kur pa që po nxehej i tha:

— Nuk mundem!

— Mirë, mirë! Qetësohu! Përqëndrohu! Kape rolin!

— S'kam ç'bëj! Përpiqem po s'mundem! Ndoshta unë...

Atë çast nga turma e kureshtarëve, që kishin rrethuar vendin e xhirimit u shkëput një plakë rreth të shtatëdhjetave.

— Nënë! O nëne!.. Mos shko andej se është e ndaluar — i tha dikush por plaka s'e dëgjoi. Ajo

shpejtoi hapat dhe ju afrua portës me shufra hekuri, përtej së cilës qëndronte «djali».

Regjizori fare papritur thirri:

— Kamera! Gati kamera! — Dhe bashkë me aktoren u largua nga porta e hekurit.

— Ej, kamera... Shpejt, shpejt! — thirri ai përsëri kur pa se ajo s'po luante nga vendi. Vrapoi drejt saj, thirri disa herë në emër operatorin por ai s'ju përgjegj.

— Ptu! Po ku shkove, e marrtë dreqi... Ku je futur. ! — grindej me vete.

Plaka kishte futur duart midis shufrave të hekurta, kishte kapur djalin për faqesh dhe e puthte në ballë. Dhe thoshte me një zë çuditërisht të thellë:

— Bir i nënës!

Regjizori ishte gjithë nerva.

— Po ku shkove, more dreqi! Ku e gjete kohën! Ptu! — dhe vinte vërdallë duke thirrur operatorin.

Aktorja kishte ngrirë tek shikonte atë plakë shtatëpaktë dhe të kërrusur nga pesha e viteve që puthte papushim «djalin» e nuk çmallej dot.

Operatori më në fund dëgjoi që po e thërrisnin dhe erdhi me vrap.

— Ç'është?! — pyeti i habitur duke ju marrë fryma.

— Na iku nga duart, ja ç'është! Ku e gjete të shkretën! Ishte e mrekullueshme!

Ai s'kuptonte asgjë.

— E shkëlqyeshme ishte! E papërsëritshme...

Kryevepër ishte!

Operatori ngriti supet.

— Unë thashë se do të vonohej xhirimi dhe shkova të mirrja një paqetë.

— Humbëm alamet skene! — tha me dëshpërim

regjizori duke bërë me duar e me kokë nga plaka, e cila tani po shkonte drejt turmës. Kur pa ata që po grindeshin ajo u kthye dhe ju afrua.

— Ju prisha punë, bir — o, po më falni mua plakën se u turbullova e s'e mbajta dot veten. Edhe unë kam patur një djalë, njëzë të vetëm. . . Ja, kështu si atë aty e kam takuar për herë të fundit. Pastaj s'e pashë më. Ma vranë!. . . Dhe tani m'u duk sikur. . . — plaka u gëlltit. — M'u kujtua ajo ditë e s'u mbajta dot. Edhe ai shoku juaj aty pas porte sikur i ka këputur kokën tim biri, aq i ngjet!. . . Po djalin e kam patur trim, bir-o! Vërtet vdiq po gjermanëve s'u tregoi as kaq — ajo kaloi thoin e gishtit të madh mbi majën e gishtit tregues — Më falni, djem, se ju prisha punë, po është zemër e zhuritur nëne kjo e shkretë!

Nën dritat e prozhektorëve në faqet e saj shkëlqyen dy pika lot që lanë dy gjurmë mbi rrudhat valë-valë.

— Më falni, biro! — tha përsëri plaka dhe u largua.

Më në fund operatori kuptoi gjithshka.

— E martë dreqi edhe këtë të mallkuar — tha i revoltuar me vete dhe hodhi përtokë cigaren e porsandezur. — Njëqind herë kam vendosur të të lë e s'jam i zoti.

-- Do të kishte qenë diçka e rrallë, origjinale... Ptu! — Regjizori tani fliste me vete i dëshpëruar.

— Na shpëtoi! — tha me dëshpërimin e fajtorit operatori.

— Fillojmë. . . Gati! — thirri aktorja dhe shkoi te vendi prej nga do të nisej drejt «djalit».

Regjizori s'ja vuri veshin.

— Jam gati — tha përsëri ajo.

Ai ktheu kokën.

— Kjo do të jetë hera e fundit.

Regjizorit i bënë përshtypje fjalët e saj. Kurrë s'kishte qenë kaq e vendosur.

— Mirë pra, fillojmë... Gati kamera!

Dhe ju afrua aktoret:

— Mos harro ç'të thashë... Më e thellë, më shumë ndjenjë... Më kupton!? Takohesh për të fundit herë me «djalin»... Jo sentimentalizma, Vera... Dhimsuri, krenari... burrëri..!

— E njoha nënën, regjizor... — tha ajo me besim — Fillojmë!

Regjizori buzëqeshi. Në sytë e saj vezullonin ndjenja nëne.

RRUGËS, PËR TE KOMUNISTI....

Diçka i kërciti në gjoks dhe rreshti ju këput papritur. Pena ju ngatërrua keq nëpër një ndërthurje të çuditshme ndjenjash e mendimesh të shqetësuar. Koka ju rëndua, duart ju mpinë, ndërsa sytë i mbetën të ngulur si të pajetë aty në fund të faqes, ku qe këputur rreshti. Po shpështillte lëmshin e kujtimeve por ato i kalonin të turbullta si tablotë e një filmi që dridhen në ekran e të mjegullojnë shikimin.

E ngjeu edhe një herë penën por ajo shkroi vetëm një fjali dhe përsëri u ngatërrua nëpër atë rrjetë shqetësimesh të lodhshme.

«Po ç'dreq desha që hapa gojën e i premtova sekretarit!» — ju hakërrua vetes dhe u ngrit.

— Vaso!.. — Diç deshi t'i thoshte e motra, po ai sikur t'ja kishte fajin ajo ju zbraz:

— Lëmë rehat, për kokën tënde! Shko nga kuzhina! Ikë tani!

Ndonëse s'kuptoi asgjë ku i rrihte damari të vëllait, ajo doli. Mirë s'i erdhi që mori atë përgjigje, po edhe i vëllai ju dhims. Ç'e mundonte?! E ku s'i shkonte mendja motrës!

Vasua u shtri në divan dhe e ndezi një herë. Deshi të qetësohej, të shplekste atë gardh që i qe ngritur aty në fund të faqes e s'e linte të shkruante një

fjalë më tej, por ashtu shtrirë siç që i dilte përballë fytyra e sekretarit, ashtu e qeshur siç e pat lënë kur u ndanë në drekë. Puliti sytë dhe u kthye në krah por fytyra e tij i doli përsëri përpara. U ngrit ndenjor dhe mori kokën midis duarve. Dhe pas një çasti sikur ta kishte rrëmbyer një frymëzim i rrufeshëm zuri vend prapë në karrige dhe vazhdoi të shkruante. I mëshonte penës dhe hiqte cigaren parreshtur gjithë nerva.

«Hë!?» — pyeti veten duke lexuar rreshtat që kishte hedhur me një frymë në letër. Penën e shtrëngonte fort midis gishtave sikur kishte frikë mos i ngecte përsëri.

«Se mos kanë për ta marrë vesh! Ajo iku tani, mbaroi! S'ka për t'u kujtuar më kurrë.» — ju përgjegj vetes dhe vazhdoi të shkruante:

«...Gjithmonë jam përpjekur ta kryej detyrën time me ndërgjegje.»

«Me ndërgjegje!» — përsëriti me vete dhe u mpi përsëri.

Ah kjo ndërgjegja! Pikërisht te kjo fjalë i ngeci pena herën e parë. Dhe tani kur filloi përsëri të shkruante pa e kuptuar as vetë mundahej të mos e sillte ndërmend. Por erdhi një ditë kur ajo duhej thënë. Vasua ndjeu një djegësirë në gjoks, i kërcëlluan dhëmbët e flegat e hundës ju zgjeruan. Ndërsa shihte ato ç'kishte shkruar, gërmat ju zmadhuan e ju zmadhuan gjersa u shkrinë në një masë të zezë e të palexueshme.

— Ptu!

Përplasi penën mbi tryezë dhe mbështeti ballin mbi duart e mbledhura grusht.

Atë e mbanin si një nga punëtorët më të mirë të ndërmarrjes. Djalë i zoti, i palodhur, që e kishte mendjen femër e që e kishte për ç'ta doje. Ai u kishte fituar zemrën të tjerëve. Disa nga komunistët e re-partit shpesh i kishin hedhur fjalën për t'u futur në parti, por ai ishte ndrojtur megjithëse fjalët e tyre e ngrohnin. Kohët e fundit e kishte kuptuar edhe vetë se organizata e partisë po e mbante gjithmonë afër, e ngarkonin me punë të ndryshme, shpesh i kërkonin mendimin për problemet e ndërmarrjes dhe ai i përgjegjej kësaj konsiderate me punë. Sa vinte dhe bëhej më i gjallë e më aktiv. S'kishte mbledhje ku të mos diskutonte Vasua. Dhe jepte ca mendime të matura e të pjekura që zinin vend. Vetëm në një mbledhje, këtu e nja pesë muaj të shkuar ai s'kishte thënë gjysmë fjale. Dhe ajo kishte qenë mbledhja më e rëndë që mbante mend e që zor se do të përsëritej. Ishte torturuar Vasua në atë mbledhje. Kaq herë që bërë gati të ngrihej të thoshte dy fjalë, vetëm dy fjalë dhe mbledhja do të merrte fund, por ca duar të padukshme e mbërthenin pas karriges. Dhe duke bërë që të ngrihej nën këtë peshë të rëndë e kishin mbuluar djersët.

Atë që s'e tha dot në mbledhje i mbeti varur si një këmbanë e bronçët në zemër që hem i rëndonte hem i lëshonte kohë më kohë ca tinguj të mprehtë që i futeshin si gjilpëra nëpër gjak.

Por kaluan muaj e ai sikur u mësua me atë peshë e me ata tinguj dhe nisi të çelej. Prapë ishte nga diskutantët e parë të mbledhjeve. Këmbana e bronçët kujtohej rrallë e më rrallë dhe tingujt e saj sa vinin e bëheshin më të shurdhët.

Për të hyrë në parti një ditë ja hodhi fjalën edhe vetë sekretari.

— Të mendohem. — I kishte thënë Vasua dhe aty për aty qe skuqur duke menduar se ishte përgjegjur si një kalama i llastuar.

Shkuan javë e ai s'i dha përgjegje sekretarit. Se si i vinte, sikur druhej, sikur kishte turp nga mendimet e mira që kishin për të. Sa për të hyrë në parti i qante zemra. Dhe një ditë i shkoi sekretarit në atë kthinën prej kompensate në cep të repartit, që e thërrisnin «Zyra e mjeshtrit». Sekretari e priti me buzë në gaz:

— Hë, mo Vaso!

— Po ja, për atë që më the ti një ditë... — tha si me turp.

— Partisë i duhen njerëz si ti, gjak i ri, i pastër. Ti je punëtor i mirë, i klasës je...

— Ç'duhet të bëj unë?

— Do të bësh një lutje, një... — Dhe sekretari i shpjegoi me atë zërin e ngrohtë gjithë ç'duheshin. Pastaj i hodhi krahun supeve dhe dolën të dy.

Duke ecur nëpër repart sekretari i fliste Vasos për një pompë të re që kishte ndër mend të ndërtonte ndërsa ai ishte tulatur ndën një emocion të fortë dhe rrallë e tek hidhte ndonjë «po» sa për t'u ndodhur në muhabet. Dhe çuditej. Me sekretarin ishte sjellë gjithmonë si me një shok. Kishin qeshur, ishin grindur, kishin folur edhe mbarë e prapë kur kishte qenë rasti, ndërsa tani pesha e krahut të tij mbi supe i dukej e rëndë dhe sikur e ndrydhte. Ku kishte qenë tërë ky pushtet i tij që s'e kishte vënë re?

Kur dolën në krye të repartit sekretari i tha se do të shkonte nga axhusteria dhe pasi i shtrëngoi dorën u fut nëpër një korridor të ngushtë, ngarkuar

me standat e emulacionit. Vasua mbeti si i hutuar dhe vetëm kur sekretari po merrte në të majtë të korridorit i thirri:

— Sho... O Kristo!

Ai qëndroi.

— Si ta bëj atë lutjen?

— Si të duash.

— Po ç'të shkruaj? Ç'të them?

— Ç'të të thotë zemra. Thjesht fare.

Dhe u ndanë përsëri. Vasua përsëriti fjalët e tij: «Ç'të të thotë zemra.» Kur ndezi tornon emocionet sikur ju lehtësuan. Dikush lëshoi një zë që përtej:

— Pas punës një mbledhje e shkurtër e organizatës.

Vason e trazoi një ndjenjë që i ngjante ngazëllimit. Dhe duke punuar e mendonte veten në atë mbledhje, midis komunistëve. Ai shpesh e kishte përfytyruar veten në mbledhjet e tyre.

Kur doli nga puna i përlqeu të ecte vetëm. Nuk e priti as urbanin po ecte më këmbë, duke u çapitur mendueshëm. Dhe nëpër mendimet e tij tingëllonin si refren fjalët e sekretarit:

«Ç'të të thotë zemra!»

* * *

Mori nja katër-pesë lugë nga gjella e drekës që ja kishin lënë të ngrohtë mbi stufë dhe u mbyll në dhomë ku e motra që shtrirë e lexonte. E porositi që të mos i bënte fjalë dhe u ul pas tryezës. Nisi të shkruante:

«Jam bir i një familje punëtore. Babai ka qenë partizan i dyzet e treshit. Një xhaxha e kam dëshmor...»

Pastaj nisi të tregonte për veten. Ato që po shkruante i pëlqyen e ky gëzim sikur ja hapi më shumë zemrën. Fjalët po dilnin më të rrjedhshme, më të ngrohta. Dhe ashtu duke gërmuar për të gjetur të mirat e të ligat e vetes arriti gjer në çastin e asaj mbledhjes ku duart e padukshme e kishin mbërthyer pas karriges. Këmbana e bronçet papritur trokëlliti fort. Tingujt e saj i shkanë nëpër trup me dhembje dhe rrodhën në majën e penës duke e mbërthyer atë pas tryezës, aty ku qe këputur fjalja. U mundua ta kalonte këtë ngjarje të mundimshme dhe të shkruante për ndodhitë e mëpastajme por nuk mundej. Ju kujtua një libër që kishte lexuar vite më parë. Atij i kishte munguar një kapitull dhe ai pasi e kishte mbaruar së lexuari kishte kuptuar që s'kishte marrë vesh asgjë.

Kështu filloi ajo luftë nervash që e la mbërthyer pas tryezës kushedi se sa, me majën e penës ngulur pas një copë fjalie të këputur.

Pasi e kishte nxjerrë të motrën nga dhoma e si shkarraviti edhe disa rreshta ai humbi gjatë ashtu me ballin mbështetur mbi grushte. Kur ngriti kokën u ndje i dërmuar, i përgjumur. Kërkoj penën mbi tryezë dhe mezi u kujtua që e kishte hedhur. E mori dhe shoi rreshtat e fundit në fillim ngadalë e si me përtesë dhe pastaj duke tërhequr me zhurmë penën kryq e tërthor letrës. Papritur inati e rrëmbeu të gjithin. E grisi gjithshka pat shkruar, e shuku letrën dhe e flaku pa parë ku e hodhi. Rrëmbeu xhaketën dhe doli. Kishte filluar muzgu. Ndjeu të ftohët

dhe mbërtheu jakën e këmishës. Humbi midis turmës së shëtitorëve mbështjellë me amullinë e mendimeve. As vetë s'e dinte sa herë e bëri atë ecë e jakë bulevardit dhe as që vinte re se pas çdo xhiroje njerëzit rralloheshin. Kur u kthye në shtëpi nëna dhe motra kishin fjetur. Mori një letër tjetër dhe u ul përsëri pas tryezës. Dora s'ju pengua më.

Të nesërmen ja dha në dorë sekretarit zarfin e hapur ku kishte futur letrën. Ai i ra lehtë supeve, por Vasos ju duk sikur ju drodhën këmbët. Dhe doli kokëvarur nga zyra e tij. Kristos i dogji kjo dhe hapi zarfin. U zhgënjye që në rreshtin e parë:

«Unë nuk mund ta shkruaj dot lutjen.»

Tendosi shikimin sikur do ta përpinte këtë letër të çuditshme.

«Unë s'jam aq i mirë sa mendoni ju. Jam shpirtvogël dhe i lig. Masa që u mor për Tefikun më takon mua. Aksin e tornos e theva unë. Punoja pas turnit të dytë për një detal të motorit të ri që prodhuam. Aty m'u thye aksi dhe unë e ndërrova me atë të tornos së Tefikut. Flitej se do të më bënin brigadier. . .»

Kristua e lexoi disa herë këtë letër të papritur. Pastaj doli me një barrë mendime.

Vasua dëgjoi hapa që afroheshin.

Dhe ndjeu përsëri një dorë mbi shpatulla.

D A S M Ë!!!

Para katër-pesë ditësh kishte ardhur te ne një grup të rinjsh nga Vidhasi, për të marrë eksperiencë nga organizata jonë, e cila ndonjë muaj më parë edhe ishte dekoruar si e dalluar në luftën për të renë.

Miqtë pyesnin për çdo gjë e ne u tregonim se si punonim me njerëzit. Bëmë edhe një mbledhje të organizatës e ata mbetën shumë të kënaqur.

Të nesërmen ishte e shtunë. Miqtë kishin ndër mend të rrinin deri nga dreka e të niseshin për në fshatin e tyre. Por ne nuk i lamë. Miku është mik po në fund të fundit për ca gjëra vendos i zoti i shtëpisë. Sidomos ne fshatarët s'para të lëmë të ikësh kollaj.

Të nesërmen martohej Liraku, zëvendëssekretari i rinisë. Le që ai vetë ju lut njëqind herë miqve që të rrinin po edhe ne të tjerët ngulëm këmbë duke u thënë se fundja edhe kjo ishte eksperiencë, se edhe në dasmë do të dukej puna jonë.

— Do të rrimë, — tha Sania, sekretarja e rinisë së Vidhasit. Të tjerët s'e kundërshtuan. Ajo ju drejtua Lirakut:

— Do të vijmë po vetëm mos u mërzitni se do të fusim hundët një çikë si shumë. Eksperiencë, apo jo?

Ai qeshi përzemërsisht e pa e bërë të gjatë i hoqi udhës për nga shtëpia. Në mbrëmje shkua

edhe ne. S'vonoj shumë dhe ja mbërriti orkestra. Dhe gazi s'kishte të mbajtur. Veç një gjë stononte në atë mbrëmje gazmore. Mbi fytyrën e rreshkur të xha Ganos, babait të Lirakut, po thurej një perde ankthi e mërzie. Kurse sytë e nënë Zaros ishin të hutuar e të trembur. Ata diç i thoshin të birit me gjuhën enigmatike të heshtjes, por ai i rrëmbyer nga hareja e dasmës as që kuptonte gjë dhe qeshte pa të keq. Liraku kujdesej sidomos për miqtë e Vidhasit e veçanërisht për vajzat e grupit, Sanien e Zeskën. Si zot shtëpie dhe si i zoti i punës ai mundahej të mbante ndezur humorin.

Orkestra nisi një tango. Për të thyer akullin ai mori Sanien e filloi të kërcente megjithëse ja kishte frikën atij Kuqos, që i binte fisarmonikës. Ai e kishte zakon që kalonte menjëherë nga tangoja në vals ose nga vallja në foks e të hutonte fare.

Kërcenin dhe bisedonin. Ajo e pyeste për peshqeshet që i kishte pregatitur nuses.

Ganua me të shoqen ishin mbledhur kokë më kokë e seç pëshpërisnin. Të dy ishin prerë në fytyrë.

— Mos nuk është ajo, mor burrë? — pyeste Zarua.

— E po unë në ballë i kam de... Ajo e tërë është. Tri nishane, dy në faqe të majtë e një në hundë. Veç është trashur e sikur është zgjatur ca.

— Si 'ta ha mendja?

— Xheç ka për të pasur, po ecë e merre vesh në qofsh burrë!

— E...e! Si s'na u mbaruan një herë taksiratet!

— Dreqi e di se ç'mund të na bëjë djali! Kam frikë.

Bisedonin pikë e vrer me njëri-tjetrin dhe s'ki-

shin vënë re që i biri shihte i shqetësuar dhe s'kup-
tonte asgjë.

— Pleqtë s'qenkan në terezi — i tha Sanies —
Më duken shumë të mërzitur.

— Ndoshta e kanë menduar dasmën ndryshe!

— S'më duket... Ne bashkë i kemi vendosur
të gjitha.

— E po s'je vajzë e t'u vijë keq që do ikësh.

— Se si na shikonin qëparë...

— Ashtu të duket.

— Jo e kam me gjithë mend. Ata diçka kanë.

Kuqua si duket e pa që Liraku s'qe në terezi
dhe me të mbaruar pjesa që pat filluar s'e zgjati më
tej. Dhëndrri shkoi te i ati. Nga afër ai ju duk edhe
më i mërzitur. Kurse nëna si e shastisur. Shikimi i
saj ngulur në bebëzat e të birit lutej për diçka të
pakuptueshme. Ganos i kërcente herë njëra vetull e
herë tjetra. Në shteg të ballit i qenë formuar pesë
rrudha e ajo e mesit si zakonisht kur ishte në orë të
liga i qe skuqur tejmbanë. I biri një çast pyeti pa
fjalë duke parë sa njërin tjetrin, por ata s'ju për-
gjegjën. Këmbyen nga një shikim dhe ulën kokat e
rënda.

— Po ç'keni të shkretën?

— Vëri gishtin kokës — hungëroi mbytur Ga-
nua. — S'jam turpëruar kurrë unë... Deshe ta
prishç fejesën, ta prisha. Deshe të fejohehe me pël-
qimin tënd, u fejove. Tani...

Liraku u çorodit më keq. Kjo i erdhi si një go-
ditje fare e papritur që e trullosoi.

— Po e bëre atë, ta dish... — Në zërin e Ganos
ndjehej frika nga diçka e pasigurt. Megjithatë ai e
lëshoi fjalën gjer në fund:

— S'je më im bir.

Lirakut ju duk se sytë e nënës ishin mjegulluar.
Dhe pyeti nervoz:

— S'po ju marr vesh bre, ç'keni?

Ganos i kërcejnë vetullat në heshtje. Nëna ka ngulur sytë diku në korridor. Kthen edhe ai kokën. Shikon mysafirët, muzikantët... Ç'është kjo gjë e padukshme që ja ka mërzhitur pleqtë në një natë të tillë!? Ai nuk sheh asgjë. Ngre supet.

— S'ju marr vesh!

— Atë që të thashë! — zëri i të atit këtë herë ishte i shtruar, por megjithatë çuditërisht i ashpër.

— Po thuamani de, se më plasët! Për se e kenit fjalën?

— Për nusen, — tha e ëma me gjysmë zëri dhe pa të shoqin si fajtorë.

— Ajo është në shtëpi të vet — Dhe Liraku ngriti përsëri supet pa ditur të shpjegohej me vetëveten. Pastaj e thirrën se i kishin ardhur mësuesit e fshatit për urim. Ai doli në oborr po mendjen e kishte gjithë te prindërit...

«Ç'është kjo enigmë!?»

Ngjiti mysafirët në dhomë dhe shkoi prapë te i ati. Për habinë e tij ata ishin qetësuar. Ganua buzëqeshi dhe i tha të shkontë e t'u bënte muhabet të porsaardhurve. Nëna ishte ulur pas Sanies e seç e pyeste. I dukej e qetë e gazmore, por kur u afrua kuptoi se kjo ishte një bisedë hetuese.

Si këmbëu dy fjalë me mësuesit, Liraku e mori përsëri Saniën për të kërcyer.

— Ç'të thoshte nëna?

— Më pyeste e kujt jam, a jam fejuar? Ashtu si e kanë nënat! Po ti përse më pyet?

— Kot.

Çiftet ishin shtuar shumë. Dasma mori zjarr e

ai sikur po e harronte shqetësimin e prindërve. Sanien dhe shokët e saj i kishte rrëmbyer rrjedha e kësaj dasme që u dukej aq larg dasmave që ishin bërë gjer tani në fshatin e tyre. Të moshuarit ishin mbledhur në një dhomë dhe ja kishin krisur muhabetit. Nganjëherë ja thërrisnin këngës. Rinia kishte pështuar korridorin e gjerë ku gjëmonte orkestra. Buçisnin të qeshurat dhe kërcenin dhjetëra çifte.

— Do ta mbaj mend këtë dasmë, — i tha Sania Lirakut.

Ai uli kokën dhe qeshi. Njeriut se si i vjen kur i mburrin dasmën e tij.

— Te ne kjo po bëhet modë! Kemi patur edhe nja tri dasma të tjera. Në mos si kjo po... — hyri në bisedë Hajria, një kushërira e Lirakut.

— Edhe ne do t'i bëjmë modë, — tha Sania.

— Në dasmën e parë hoqëm keq. Sa nuk plasë sherri, — tha Liraku.

— Te ne do ta provoj unë e para. Martohem pas nja dy muajsh, — qeshi Sania.

— Hajde, flamurin! — e ngacmoi Hajria.

— Jo, moj, për flamur, po ka një vit e ca që s'ka patur dasmë në fshatin tonë.

Këngë, valle, të qeshura, biseda gazmore, kështu i gjeti dhe i la dasmorët mesnata.

Edhe e nesërmja filloi po me atë gaz.

Sanien e kishte rrëmbyer rregulli. Njerëzit vinin për vizitë, merrnin një karamele e një gotë rakë, uronin dhe dilnin. Dikush, që ishte më i gazit hynte ndonjëherë edhe në këngë e në valle. Po ajo nuk pa as shtro e ngrerë tryezat, as mbush e zbraz shishet e rakisë, as vërë e hiq pjatat e mezeve. Dhe pyeti:

— S'do shtroni fare?

— Do shtrojmë por në mbrëmje, si të vijë edhe

nusja. Në qytet kësaj i thonë bufe. Vetëm me të afërmit. Do të ftojme edhe disa nga krushqit.

Kur dasmorët po niseshin për të marrë nusen, Liraku i tha Sanies:

— Do të vish edhe ti.

— Jo, jo! Falemi nderit, po kjo nuk shkon.

— Po ti ç'ke, kur të them unë. Nuk do shkojnë vetëm burra. Do të vijë edhe ime motër, edhe tezja... Edhe unë do të shkoj. Ngrehu. — Dhe e kapi për krahu duke qeshur — Fundja ty të duhet edhe për eksperiencë... Si the ti, pas dy muajsh...

Ndërkaq krushqit ishin nisur dhe ata vrapuan t'i arrinin.

Ganos përsëri i kërcyen bishtat e vetullave dhe i rrahën mollëzat tek i pa të vraponin të dy.

— E ç'do na bëjë ndonjë të pabërë! Ç'na polli belaja!

— Rri rehat! Asgjë s'ka për t'u bërë. Unë ja bleva mendjen, — thoshte e sigurt e shoqja.

Ai ja priste:

— A t'u mbylltë edhe ty! Ata të japin ujë në bisht të lugës, ti seç thua. Krushku e njeh, moj, këtë çupën. Ka të hyrë e të dalë me të anë. Edhe historinë tonë domosdo që e ka marrë vesh... Kam frikë se do pëlçasë ndonjë sherr e hajde të dëgjosh botën. Fajin e ka ky toni. Ç'të duhet, o t'u mbylltë, që e merr me krushqit! Mirë në shtëpi e solle... po me krushqit!?

— Ku e di ai! Më mirë t'ja kishim thënë.

— Hajde, mendje, hajde. Që ta linte fare atë tjetrën.

Ishte në ethe xha Gana. Atyre që e uronin u përgjegjej ftohët, të tjerëve që i kërkonin ndonjë

këshillë, ndonjë mendim ua priste shkurt. Kurse së shoqes i shfryu:

— Lëmë rehat, për kokë tënde!

Mbante sytë nga qafa e Borrigës dhe priste krushqit.

— Ters u nis e ters do bitiset kjo punë. E mori dreqi! — përsëriste refrenin e tij dhe fërkonte ballin e rënduar.

Dhe ja krushqit dolën nga qafa. Kërkoj me sy nusen midis tyre. Por ishin larg e s'dalloheshin.

— Qenka, qenka! — tha pastaj me zë dhe nxori kutinë ta dridhte një herë. Edhe një merak tjetër që kishte i iku kur i pa krushqit të qeshur.

— S'qenkan turbulluar ujërat — qeshi i kënaqur dhe ju këthe së shoqes.

— Tundu, moj, se të erdhi nusja! Ç'më rri kështu si e shastisur?

Nusen e ngjitën lart. Në një krah e mbante Liraku e në tjetrin Sania.

Ganon prapë e përshkoi një drithërimë por s'e mbajti gjatë. E përqafoi nusen dhe e puthi në ballë.

Orkestra gjëmoi përsëri dhe sikur mblodhi në një shpërthim të madh gëzimin e të gjithëve.

Kur gjashtë lisat zunë të bënin hije për nga shtëpia, Sania dhe shokët e saj kërkuan leje të të zotët e shtëpisë për t'u larguar se, po të rrinin gjer të ngrysej, as në mes të natës s'e zinin dot Vidhasin. Patën punë, sidomos me Zaren që i shqiti duke i mbajtur për krahësh e me Lirakun që u lutej të rrinin e të niseshin të nesërmen me natë. Sania u përcuall me pleqtë e shtëpisë, me të rinjtë e fshatit pastaj i shtrëngoi dorën fort Lirakut:

— Të trashëgoheni! Dhe mos harroni se ju pre-

sim. Pas dy muajsh e kam unë këtë që pate ti. Të pres me gjithë nusen.

— Do të vijmë patjetër. Veç ti krushk s'ke si më dërgon, — e ngacmoi ai.

Sania u përqaftua dhe u puth me nusen e re si dy motra.

— Na falni, se s'qemë nisur për dasmë e siç e sheh... duarthatë.

Nusja e përqafoi përsëri:

— Mos e kishe thënë më mirë.

— Të trashëgoheni! — uruan në kor vidhasit dhe dolën. Liraku me disa të tjerë i përcollën deri tej.

— Ç'ishte kjo Sania?! Shpuzë! — i tha të atit kur u kthye.

— Prandaj kisha frikë mos na digjte.

Liraku nuk e kuptoi dhe ja nguli sytë të atit. Ai uli të tijtë.

— Domethënë mbrëmë...

Ganua ngriti sytë ngadalë, në peshën e një buzëqeshjeje të zbetë.

— E di kush ishte ajo, mor budalla?

— Sekretarja e... Baba!?

— Ç'sekretare mor... E fejuara jote e parë...

.....
— Si!?

Por Ganiu kishte ngjitur shkallët. Liraku kishte shtangur dhe po llapashitte nëpër kujtime.

Një vit e ca më parë, një mëngjez ai kishte lexuar një shkrim në «Zërin e rinisë». I shihte ende si të gjalla ato gërma të mëdha të titullit: «DO T'I GJEJMË VETË SHOKËT E JETËS». Dhe kishte lexuar fjalët e Sanies.

«Unë e quaj të prishur fejesën time. Na kanë

fejuar prindërit pa e parë as me sy njëri-tjetrin, le-
pastaj për të na pyetur. Unë atij i di vetëm emrin.
Edhe atë nuk kam të drejtë ta zë në gojë... Ne do
ta gjejmë vetë shokun e jetës...»

Kur i kishin treguar gazetën Ganos ishte tër-
buar.

— More edhe me flori ta veshin, unë atë s'e
fus në shtëpi — Kishte bërtitur.

Për herë të parë në ato vite fejesë Liraku provoï
një ndjenjë të ngrohtë për atë vajzë të panjohur.
Pastaj ajo ngjarje humbi në kujtesën e tij me gjithë
fejesën, që kishte qenë për atë gjithmonë e pakuptue-
shme dhe e pakapshme si një fjollë tymi. Me Shpre-
sën u njoh në një seminar rinie në qytet, ku qëndruan
një muaj. Ndejtën përsëri bashkë nja dhjetë ditë në
takimin e estradave të kooperativave... dhe...

Ajo po priste në mes të korridorit. Dikush ki-
shte porositur orkestrën për një kërcim të çiftit të
ri.

Ajo diç i pëshpëriti e lumtur.

Ai i tha:

— Nesër do të të tregoj një histori.

Orkestra luante vals. Ata luanin tango. Jo, ata
shkelnin në gjurmët e njëri-tjetrit. Dhe s'e dëgjonin
muzikën.

Njerëzit qeshnin. Ata heshtnin të lumtur.

TEZJA

Siç më tha plaka e siç më shkruante shpesh motra, teze Likua, tezja e fshatit, siç e thërresim ne, kishte bërë kiametin për mua e për time shoqe.

«I këtilli e i atilli! E kam rritur që pa dalë nga shqytkat e tani hodhi gurin prapa. E harroi tezen djali... Domosdo, na zuri punë asaj Tirane, na gjeti dhe nuse... Posi! Tezja i ka rrugët me baltë..!»

E ç'nuk kishte thënë tezja! Sidoqoftë ajo ka të drejtë. U bënë plot gjashtë vjet që s'kam shkëlur në shtëpi të saj. Kur mbarova studimet më thirri një natë për darkë po nuk i shkova, kur u martuam na pritri një javë të tërë po se si qëlloi e s'i vajtëm dot. Ai i shkreti pesëmbëdhjetëditëshi i lejës është i dhimsur e s'para të pëlqejnë gostirat... Iku dhe ai vit. Vitet e tjera më shumë e kemi kaluar lejën nëpër plazhe e kështu që tezes ja kemi njëqind herë borxh një të vajtur.

Sivjet i hoqëm vizë plazhit e vendosëm që lejën ta kalonim në vendim tim të lindjes se s'mbante më ujë pilafi. Të çmалleshim një herë me njerëzinë, të lanim borxhet e urimeve e të ngushëllimeve te motra që martoi kunatin, te goca e hallës që lindi binjakë, te daja që ju lirua djali nga ushtria, te një kushëriri i babait që i kishte vdekur i ati... E ku numroheshin! Natyrisht që kjo listë e pashkruar do

të seleksionohej po sido që të binte puna, e vendosëm që në Tiranë që te tezja do të vinim një natë, sikur kiameti të bëhej.

Dhe një ditë të lejës aty më të ngrysur i them gruas:

— O burra, t'i sulemi tezes!

Ç'është e vërteta, tezja gjithmonë më ka dashur shkuar djalit! Edhe unë, të themi atë që është, vërtet s'i kam shkuar po për të dashur... teze Likua e përgjërohem. Jo se e kam teze e ta mburr po është e mirë! Seriozisht që është e mirë! E dashur, e urtë, e pastër... e sidomos e pritur. S'besoj t'ja dalë grua. Fluturon, fluturon kur i shkon miku. Hyrë e dil, e folë e qesh. Apo s'e ka atë gojën sheqer! Nganjëherë mendoj se të gjitha tezet janë të tilla e më vjen keq që kanë tërë këta nipër shkrimtarë e s'u kanë bërë një roman. Apo s'e kam bujare tezen! S'i hyn në sy kamja e gjëja për mikun. Ja këput kokën pulës si duke qeshur... Le po sikur të bësh shaka e t'i thuash: «Mos u harxho, teze, hamë ç'të hamë!» Të zemërohet keq. E kam provuar vetë. Kur isha ende student kam qenë në këto anë në një ekspeditë leksikologjike me një shokun tim. Qëndruam një natë te tezja. Ju bë qejfi mal! Veç kur filloi të mbushte sobën me tenxhere dhe e shtrëngoi fort rripin e përparses pas mezit.

— Teze — i thashë — po sikur... .

Ajo ma preu fjalën e ma bëri me kokë të dilja pak jashtë. Aty m'u kthye e çfarë s'më tha.

Kështu tezja! Të lë pa mend po i shkove në shtëpi. E djeg, e përmbys fare. Fillojnë gjellët, shtro një e hiq një e me siguri të fundit s'i vjen radha ta provosh. Zakon i keq po ecë e mbushja mendjen teze Likos!

Thonë që edhe të shoqin kështu e ka patur, veç

ka qenë i këputur fukaraja. Pas lufte si të tjerët u bë me tokë e me katandë e sikur u zu ca. Po s'i gëzoi dot i ziu. U bënë njëzet vjet që ka vdekur. E la tezen me tre djem e një çupë. Copë u bë tezja e i rriti vetë, pa e shtrirë dorën gjëkund. E ju bënë djemtë diva, njëri sa për katër burra punon. Tani s'ka si tezja në fshat. Vajzën e ka nxjerrë. Edhe dy djemtë i ka martuar.

Bëj hesap atëherë që ishte hiq e mos këput dhe përmbyste dynjanë kur i shkonte miku... Kushedi tani!

Ja, këto i tregoja gruas rrugës për në fshat.

— Ta shohim edhe këtë tezen tënde se si shumë po na e mburr! — më thosh gruaja me shaka.

— Le të tjerat po ti je dhe nuse më të parë... Me petulla, me revani, me punë... Ç'ka për të vajtur!

Në fshat arritëm aty ndaj të errur. Arritëm po ecë e gjej shtëpinë e tezes se! Të mos them të tëra po tre çerekët e shtëpive ishin të reja. E shtëpi jo shaka! Të sistemuara, me ca modele të bukura... Vila fare! Kërkova me sy atë murregryerën e tezes po s'i dukej shënjë gjëkund.

— E paska bërë edhe tezja shtëpinë, — i thashë gruas.

Pyetëm një plak që kaloi aty e ai na tregoi një alamet pallati. Nuk e zmadhoj aspak, seriozisht. Ishte vërtet pallat, me tri hyrje për të tre djemtë.

Tezen nuk e gjetëm në shtëpi. U ulëm dhe e pritëm në oborr. Unë kujtova se do të kishte shkuar te ndonjë komshi, kur tezja na vjen nga fusha.

— Aha, të paska hyrë krimbi i parasë në pleqëri më duket! — e ngava unë. — Një tufë djem e nuse e ti prapë në punë?!

— Është fushatë, bir i tezes, kemi bereqetin fushës — tha ajo dhe na u hodh në qafë.

Ç't'ju them sa u gëzua! Kap mua e kap time shoqe, puth mua e puth atë. Dhe rrinte sa rrinte e thoshte me vete:

— Epo ç'ka ngordhur de..! Ç'të përmbys unë e shkreta!? Si e gjetët rrugën?!

Shkonte e vinte nëpër shtëpi pa ditur ç'të bënte. Herë sillte paqetën, herë tavllën, herë për të marrë një jastëk. . .

— E. . . e? — pyeta me sy gruan.

— Kishe të drejtë, — tha ajo me një të luajtur të kokës.

Kaluan ca minuta e tezza sikur u qetësua. Zuri vend atje midis nesh dhe filloi të pyeste me radhë për të gjithë, kokë më kokë: «Si e kam Zeqon? Po Syrjai si u bë me atë të flamosur stomak? Djali i Kikës kishte marrë nuse të mirë më thanë? Po Qamilja si e ka atë të voglën, se sikur i vinte si kërthinjë? Nuriun e shkretë e zu taksirati me atë të shkretë këmbë... S'ju bë ndonjë çikë më mirë e flamosura? Po ajo puna e çupës së Kasëmit si qe, mor bir? . .

Dhe pyetjet e tezes s'kishin fund. Teze Likua kishte mbetur po ajo e dashur dhe e dhimsur sa s'tregohet. Por unë prapë habitesha! Kishte rënë nata e ajo ishte shtruar në muhabet për shtatë palë qejfe. Rrinte sa rrinte e thoshte:

— U ç'më çlodhët, mor të uruar. — Dhe she-shohej mbi minder.

Ku më parë, sa përshëndoshej pesë minuta e fluturonte nga kuzhina... veç dëgjoje klithmat e pulës kur i këpuste kokën ose zërin e saj që urdhëronte të vegjëlit për të shkuar në dyqan ose te komshitë.

«A...a! Po tani ka nusët te zja!» — kujtova se i rashë më të dhe nisa ta ngacmoja:

— Paske mësuar të rrihsh ndenjor, teze!

— Epo pleqëri, mor bir! Pastaj edhe lodhemi.

Ajo s'e kuptoi ku më rrihte mua dhe qeshi pa kuptim.

Qetësi! Asnjë lëvizje nëpër oborr! Asnjë shënjë shqetësimi. Pulat flenë të qeta në qymezin modern të shtëpisë së re. Pa të kuptuar qesh dhe ngre supet.

— Ç'ke? — thotë te zja.

— Ndryshime, teze, ndryshime... Ku shtëpia e vjetër me këtë farë pallati! Le po paske vënë edhe plaçkë!

— E kemi patur mendjen prapa, bir i tezes, s'ja dinim jetës!

U kthyen nga puna edhe djemtë e tezes me gjithë nusët. Edhe me ata u gëzuan e u çmallëm një copë herë të mirë. Nusët u ulën aty pas nesh pa e çarë kokën për telashet e kuzhinës. Si kishte kaluar ora nga teta, Beqiri, djali i madh na tha:

— Si thoni, ngrihemi e dalim një herë?

Ç'të thoshim ne mysafirët! U ngritëm. Kur shoh që tok me ne erdhën të gjithë, që nga te zja e gjer te mbeska më e vogël. S'po merrja vesh gjë. Po Beqiri s'më la të mendohesha gjatë, ktheu rrugën e na futi në një sallë të madhe gjithë dritë, mbushur me tryeza të shtruara, shumica e të cilave ishin të zëna. Djemtë e tezes bashkuan dy tryeza dhe zëmë vend të gjithë.

Kamarieri erdhi në çast.

— Ç'do merrni? — na pyeti Beqiri.

Unë kujtova se kishim ardhur për të pirë ndonjë gotë e desha të porositja një teke nëntëmbëdhjetëshe, kur kamarieri na lexoi një menu të gjatë.

— Mish pule bëji këtij nipit, se e ha shumë —
tha tezja. — Edhe nuses.

U porositën për të gjithë, të para e të dyta.

— Na sill më parë ndonjë gjë për të pirë — tha
djali i dytë i tezes — Raki për burrat e birrë për
gratë.

— Në fund edhe nga një revani — tha tezja. —
Po dopio ama, se e kemi nuse më të parë këtë
çupën.

Ime shoqe më pa në sy e qeshi me zë sa tër-
hoqi vëmendjen e të tjerëve. Ja kriza edhe unë. Edhe
të tjerët qeshën. Por kur gazi zu të platitej të gjithë
po më shikonin mua. Desha s'desha u shpjegova:

— Të shita ndryshe te ime shoqe, teze... Të
dija atë të parën...

— Ka ecur përpara tezja — qeshi një nga nuset.
Beqiri tha me seriozitet:

— Këtë muaj jemi të mbytur në punë... Bereqeti
është i mbarë shumë e ka ardhur për drapër pothuaj
njëheresh i tëri... Prandaj jemi sulur lërë me fëmijë
e me pleq... Të vish ditën në fshat këmbë njeriu
s'gjen... Me natë ikim e natën kthehem... Po kemi
bereqet jo llafe.

— Lodheni shumë — thashë unë.

— Domosdo... Dhe me tërë atë lodhje ecë e futi
gratë të gatujnë pastaj... Kemi gjetur rehat me të
ngrënë këtu... Drekën na e bien në fushë. Gjellë të
mira, jo shaka... Edhe lirë është se të gjitha i pro-
dhojmë vetë... Kur të vini një herë tjetër që të mos
jemi në fushatë si tani tezja do t'jua shtrojë në shtë-
pi.

Tezja seç po matej të thoshte me të mbaruar i
biri po erdhi kamerieri dhe mbushi tryezën.

— Mos harrosh revanitë, Selo... Dopio, xhan
— e kujtoi tezja.

Filloi teatri në mikrofon. Dikush ngriti volumin e radios.

— Sh...t! — tha tezja. — Ta dëgjojmë. Javën e parë kishte një me mblesërira. Ishin ngatërruar për një çupë e qe bërë lëmsh dynjaja... Po ajo çupa ishte trime... S'e mori që s'e mori atë që deshën t'i jepnin... Ikën ato kohëra... Kush të jep dot sot burrë me zor!.. Pa të dëgjojmë ç'do ketë sonte!

Hanim gostinë e tezes dhe dëgjonim «Një ngjarje në fabrikë».

SHPËRTHIM NGA THELLËSITË

Me të arritur kërkova të takohesha me sekretarin e partisë. Kisha shpresuar se do të isha në fshat pa u fshehur dielli pas tri majave, por rruga është rrugë e ka të vetat. Kështu që fshatin e zura kur ishin ndezur dritat. I hoqa vizë punës për atë ditë. Gjëja më e mirë që mund të bëja ishte të gjeja sekretarin e partisë, të sqaroja me të ç'kisha për të sqaruar, të nesërmen t'ja filloja punës mbarë që në mëngjes e aty nga dreka të merrja prapë rrugën. Nga zyrat e kryesisë së kooperativës sekretarin s'e gjeta. As kryetari s'ishte aty.

— Në paç këmbë të lehtë, mos përto e hidhu gjer te shtëpia e kulturës... Atje e ke sekretarin — më tha një plak e bëri me dorë nga një kodrinë ku nëpër errësirë ndriçonin katër katrorë të mëdhenj e nëpër ta lëviznin silueta njerëzish.

Pyeta vendasin se nga i bihej për të arritur atje dhe u nisa. Në vende ku shkel për herë të parë, përcaktimi i largësive me sy është i vështirë. Le pastaj natën! Kështu e pësova dhe unë. Kur u nisa nga zyrat e kooperativës, shtëpia e kulturës m'u duk afër, po për të arritur aty m'u deshën njëzet minuta të mira. Në udhë nuk isha i vetëm. Nga drejtime të ndryshme, rruga që të çonte në kodrinën

ku ndriçonin katrorët e mëdhenj mblidhte grupe fshatarësh e fshatarkash nga rrugicat e ngushta.

Kur hyra brenda, salla pothuaj sa ishte mbushur... Shumica kishin zënë vend nëpër stola, kurse disa silleshin poshtë e lart. Ishte e vështirë të përcaktoje përse ishin mbledhur gjithë ata njerëz. Para perdes së kuqe të skenës ishte vendosur një tryezë e vogël, edhe ajo mbuluar me copë të kuqe. Mbledhje?! Mbase! Por në vesh më vinte një përzierje tingujsh çiftelish që akordoheshin... Dikush kruante zërin pas perdes. Oratori i mbledhjes?! Apo ndonjë këngëtar?! Mbase dhe ndonjë recitues.

E solla disa herë shikimin nëpër sallë. Në sytë dhe fytyrat e të ardhurve spikatte ndjenja e pritjes, e një pritjeje të gëzueshme. Këtë ndjenjë e sillnin me vete dhe ata që vazhdonin të vinin, të cilët hapnin derën me ngut, hetonin një çast të shkurtër, mbusheshin thellë me frymë, shpejtonin të zinin vend dhe mbërthenin sytë nga skena. Por dikush rrinte dhe i ngrysur si një copë muzg dimri. Ç'do të kishte? Diçka të rëndësishme. Vetëm këtë munda të përcaktoja hëpërhë... Diçka të rëndësishme dhe të gëzueshme. I lashë arësyetimet e mia. Duhej të kaloja sekretarin e partisë. Për mua kjo ishte kryesorja. Por ndërkohë s'më shpëtoi edhe diçka tjetër. Në sallë kishte shumë gra e vajza, të ndrojtura e të çelura, me shami e pa shami në kokë. Kishte shumë. Një në dorë për shkrimin tim... (se për gratë e këtij fshati kisha shkuar të shkruaja). Me sa psikologjisa aty për aty, do të kisha ç'të thosha...

Pyeta për sekretarin e partisë dhe më thanë se ishte në skenë, pas perdes. Ndejta një çast në mëdyshe, ta shqetësoja apo jo, por më në fund vendosa

e shkova. Me të kaluar perden, hamendjet e mia u zgjidhën menjëherë. Diletantët përgatiteshin për të dalë para spektatorëve. Aty për aty s'dita ku të drejtohesha. Një vajzë e re, së cilës një shoqe po i bënte një makiazh të lehtë, kafshoi buzën e poshtme, uli sytë e m'u duk sikur u skuq. Me sa duket, u tregova i pasjellshëm që hyra në prapaskenë si në shtëpinë time.

— Mirë mbrëma! — përshëndeta pa ju drejtuar askujt dhe ju afrova një burri fytyrimtë që s'besoj t'i kishte kaluar të tridhjetë e pesat. Ai seç po u thoshte katër vajzave të reja që akordonin çiftelitë.

— Jam gazetar — i thashë. Ai buzëqeshi dhe më shtriu dorën.

— Keni ardhur si me porosi... Qenkeni me fat... Do të gjeni material të mirë për një shkrim interesant.

— Ju jeni sekretari i partisë — thashë me bindje unë.

— Jo, unë jam mësues këtu... — buzëqeshi ai. Përsëri u ndjeva ngushtë. Po pse m'u mbush mendja që ishte ai sekretari? Apo sepse nëpër shkri-me i kam nxjerrë sekretarët vetëm që këshillojnë?!

— Po mua, më thanë që...

— Këtu është shoku Dalip — s'më la të mbaroja mësuesi dhe i thirri në emër.

Nga një e ndarë aty pranë, dera e së cilës ishte e hapur doli një burrë i shkurtër veshur me një palë rrobe të trasha shajaku, me një bastun gjithë gdhënj në dorë e me një barrë mustaqe. Në kokë mbante një qeleshe të pastër dhe mbi veshë kishte lidhur një shami të kuqe me pika të bardha. Kur e pashë nga larg në atë kënd gjysmë të errët, m'u duk nja

gjashtëdhjetë vjeç, por kur u afrua më shtrëngoi dorën fort e më foli buzëgaz. S'i dhashë më shumë se dyzet e katër — dyzet e pesë vjet. S'do mend që e kuptova se atë e kishte plakur rekuizita dhe makia-
zhi. Edhe ai më tha se kisha shkuar si me porosi.

— Sonte inaugurojmë skenën, shoku gazetar — filloi të më shpjegonte — Kena hjekë bela të madhe me ngritë këtë grup artistik që po shef këtu... Si-domos për vajzat e kena pas keq fort... Me luf-të... Një s'e linte baba, një tjetër s'e linte burri... E ç'kena hjekë... E ende lufta s'ka mbarue... Po gja që s'bahet s'ka pra...

Atë kohë, nga kthina prej nga doli sekretari u afrua një vajzë e re dhe më përshëndeti. Kishte veshur petkun e rëndë e tradicional të krahinës. Gjoksin e kishte mbushur me turli paresh të vjetra, teneqesh, rruazash e ç't'ju them... Një pavion i tërë muzeu arkeologjik.

— Është vajza e shokut sekretar — tha më-suesi:

— Ashtu?

— Po — qeshi sekretari, — jena at e bijë, po këtu në skenë jena burrë e grua... Dikush kafshoi përsëri buzën.

— M'u desh me u ba artist në pleqni! — qeshi përsëri sekretari. — Po duhej dhanë shembulli, s'ke ç'i ban... Le që mësuesi thotë se paskam edhe talent!

Qeshëm të gjithë një çast dhe përsëri e mori fjalën sekretari, por me seriozitet:

— Nejse, po e patëm keq boll... Gjuhët e liga s'pushojshin. Me disa familje ku vajzat pranuen të hynin në grup, na plasën grindje... Lene ç'kena hjekë... Po grupin e ngritëm... Sonte kena shfaqjen

e parë... Për tri javë jena përgatitë... Kena punue mos e pyet hallin... Po lehtë s'e kena prapë... S'jena mësue me skenën, vajzave s'u ka dalë turpi mirë. Pastaj, shiko, ti, vëlla... Disa vetë në sallë kanë ardhë për t'u tallë me ne... Prandaj ne po mundohemi të dalim me faqe të bardhë...

Kam qenë në sa e sa inaugurime, në fabrika, në kombinatë, në vepra nga më të ndryshmet... Dhe inaugurimet gjithmonë kanë emocione, sidomos për krijuesit e veprave. Por ky ishte një inaugurim krejt i ndryshëm. Të inaugurosh një koncept të ri (po të na lejohet të themi kështu) është e vështirë. Për të hyrë në të nuk duhet prerë një shirit i kuq, por zinxhirë të trashë le të padukshëm prangash të zakonave të vjetra... Ndaj emocionet pas perdes janë aq të mëdha. Por te sekretari në vend të gërshërëve të inaugurimit ndrit shikimi i tij plot besim, buzëqeshja e tij që ngroh e që e shpon perden e kuqe tejpertej.

— Hajde, gati... sonte duhet me e tregue veten... Të fortë si në luftë... — mobilizon diletantët mësuesi që drejton grupin.

— E në u talltë dikush a në hedhtë ndonjë thumb Musa Sula, Zela e ndonjë llafazan tjetër mos e bani veten... Ata me llafe ne me kangë. Kush do të fitojë?

* * *

Dola nga skena. Si mysafir që isha, më bënë nder e më liruan një vend në radhën e parë. Shfaqja duhej të fillonte nga çasti në çast. Tani salla

ishte mbushur plot. Sekretari kishte patur të drejtë. Diletantët ishin para një prove të vështirë... Shumë prindër e burra kishin pranuar t'i çonin vajzat e nusët në grupin artistik, sepse ashtu kishte thënë partia. Por në zemër diç i mundonte. I mundonin dhe thashethemet e llafazanëve e prapanikëve. Dhe në ato pak çaste, duke pritur që të hapej perdja, i dëgjova me veshët e mi disa nga ata. Sallën e kishin mbushur debatet, thumbat, romuzet. Ishin krijuar disa vatra të tilla me grupe burrash nëpër sallë. Kurse rinia dhe gratë e vajzat i kishin ngulur sytë skenës dhe prisnin.

Mësuesi hapi me duar të dyja fletët e perdes dhe doli në paraskenë. Salla gumëzhiti. Dikush lëshoi një të qeshur të çjerrë, një tjetër u koll thumbeshëm. Por u dëgjua një zë i fortë nga fundi:

— Prani, bre! .

Pastaj një: «Shëëët...» e gjatë që erdhi si një dallgë e fortë nga fundi dhe fshiu zhurmat.

Mësuesi e mori fjalën i qetë:

— Unë do të them vetëm dy fjalë. Sonte po japim shfaqjen e parë të grupit artistik. Grupi është i ri, ne s'kemi patur kohë të punonim sa duhet. Por aq sa t'u mbushnim mendjen disave se edhe ne dimë të japim shfaqje, ma ha mendja se e kemi bërë.

Përmes asaj qetësie pritjeje në ankth u hap dera. Mësuesi e preu fjalën. Në sallë hyri një plakë e kërrusur mbi një shkop thane. E mbante për krahu një djalë i ri, shtathedhur... .

— Meqë erdhi dhe Lokja, të siguroj unë se s'ka mbetë rob i gjallë në fshat pa ardhë — më tha ai që kisha në krah.

— Lokja një herë në vjet del nga shtëpia — u hodh një tjetër.

— Këtu s'ka shkelë kurrë — pasoi i pari.

— Pse s'e keni futë dhe Loken në estradë, bre? — shpotiti me zë të lartë mësuesin dikush.

Ardhja e saj shkaktoi një vorbull zhurme që u shfaq aty nga mesi e përfshiu gjithë sallën. Dikush u ngrit dhe i liroi vend Lokes aty pranë meje. Mbi ato shpatulla të gërmuqura duhej të kishte nja tetëdhjetë të shëndosha.

— U ba me qit pushkë — foli dikush pas shpinës sonë. . .

Plaka as që ua vuri veshin këtyre fjalëve. . .

— Më tha çuni se do të knojnë edhe çikat? — tha me një zë të mekur Lokja pasi ishte qetësuar nga lodhja e rrugës.

— Do të knojnë, Loke, do të knojnë. . . Hana e Shabës, Bardha e Nures, Zoga e Dautit. . . — gje-gji dikush në krah.

— Bash për njato kam ardhë. . . S'e pyta të liktë e pleqninë e u ngrita. E m'ua lumsha! — fjalët e fundit plaka i mbështolli me një psherëtimë që s'ja kapa dot ngjyrën.

Vorbullën e zhurmës e mbuloi përsëri një «shëëët» e gjatë që shkoi e u shua te mësuesi, të cilit i kishte mbetur fjala përgjysmë. Tek e shikoja, mendova se do të fliste gjatë, por si duket ai e kup-toi se s'ishte koha për leksione dhe i ra shkurt.

— Fillojmë.

Në sallë mbinë pëshpëritjet, kërcitën stolat, u ndezën shikimet sikur në atë skenë të thjeshtë do të shfaqej diçka e pabesueshme, e habitshme. Fletët e perdes filluan të rrudheshin, dhe lumi i shikimeve

vërshoi në skenë... Nuk jam në gjendje të them në se do ta kishin patur të lehtë të frenonin emocionet edhe artistët që e njohin skenën më mirë se shtëpinë e tyre, nën një vërshim të tillë ku përzihej habia, kureshtja, krenaria dhe nënqeshja ironike.

* * *

Sillja ndër mend kaq e kaq premiera, ku artistët e skenës hetojnë orë e çast sallën, reagimet e spektatorëve dhe presin me ankth fundin e shfaqjes për të marrë çmimin, për të matur pulsën e duartrokitjeve. Por asnjë prej atyre premierave s'më ngjan me këtë të këtushmen. Këtu nuk luftohet për duartrokitje. Ata që janë në skenë e dinë se duart e rinisë do të lëshojnë shkëndija nga të përpjekurit. Këtu nuk shikohet në rrudhin buzët apo në luajnë kokën me kënaqësi kritikët që mbajnë shënime nëpër bloqe. Këtu sytë mbërthehen te mustaqet e xha sulove, xha hysave, xha shabave. A do të dridhen idhtas mustaqet e tyre, apo do të ndëren nga një shtrirje e lehtë e buzëve. Do të ngrysen vetullat e do të plugohen ballët e tyre, apo do të formohen tufa të imta rrudhash në bishtat e syve. Do të bjerë mjegull, apo do të shkrepë një rreze dielli në sytë e tyre... Nga goja e tyre do të dalin kërcëllitje dhëmbësh, apo do të dëgjohet një «s'qenka keq!» Vetëm një «s'qenka keq» duhet sonte, fundja dhe një heshtje e butë. Sytë këtu mbërthehen nga dera. A do ta nërplasë njeri me forcë duke dalë pa mbaruar shfaqja!

Mungesa e një personaliteti në një premierë

ndoshta s'ka asnjë rëndësi, por mungesa e Metit në këtë sallë me stola ka rëndësi të madhe.

Perdja u hap, por skena mbeti një çast e zbrazët. Në sallë mbinë përsëri pëshpëritje, kërcitje stolash. Diçka kishte në këtë mes. Këtë e mora vesh pas shfaqjes. Në prapaskenë emocionet i kishin mbërthyer keq vajzat... Disa i kishte mbuluar djersa, një djersë e ftohtë ethesh, ndonjë kafshonte buzën dhe ndjente t'i digjnin faqet. Kthetrat e padukshme të emocioneve kishin mbërthyer sidomos Lulen e Bardhën, të cilat duhej të çelnin programin me një duet. Ca si gishtërinj të fuqishëm u shtrydhnin zemrat e ato ndjenin ca drithërima ngjethëse e u dukej se s'ngopeshin me frymë.

— Hajde, vajza, shkunduni, shkunduni — desh t'i qetësonte mësuesi, por ato s'nxorën zë e s'luajtën vendit.

Sekretari u mundua t'ua frenonte emocionet duke i prekur në sedër.

— Bukur fort... Posi... Pse s'thoni të dal unë e t'i them Shabës... Ke hak, bre burrë, s'bahet stan me lepuj... Pse s'thoni ta mbyllim perden!?

Ato u panë sy ndër sy, por shikimet e tyre të dridhura nuk komunikuan dot...

Në sallë po dukej një vorbull e re nga padurimi. Disa pleqve filloi t'u tendosej mustaqja.

Pra fillimi nuk qe i mbarë. Por sekretari nuk lejoi që grupi të topitej, të plogështohej, të çorientohej nga ato dridhma emocionesh.

— A keni mend me fillue, apo të ikim. — shkoi në prapaskenë duke u dridhur nëpër ato dallgë zhurme.

— Mehmet, duhet me ndërrue programin...

S'kemi ç'ka me ba, s'ka kohë me prit. . . Po dal unë i pari. . .

— Po ne. . .

S'kishte kohë për diskutime. Konferencierja çeli programin dhe në skenë doli Dalipi. . . Çapitej rëndë-rëndë mbi shkop me mustaqe të ngrehura e me vetulla varur mbi sy. Ai u suall nëpër skenë, hungëroi nja dy herë, seç tha ca fjalë pa kuptim që s'u morën vesh në ishin sharje apo mallëkim dhe thirri:

— Oj ti. . . ?

S'vonoi dhe në skenë hyri Hana me atë koleksion monedhash e teneqesh që i mbushnin gjoksin. Në duart që i dridheshin mbante një tabaka. Sytë e trembur ja kishte ngulur filxhanit të kafes ndërsa këmbët i hidhte sikur të shkelte mbi vezë. . .

— Ku je, moj ti? — sokëlliu përsëri plaku.

«Nusja» dridhet e trembur. Kafeja i derdhet mbi tabaka.

Ajo ngriu.

— T'u derdhtë gjaku, e humun e botës — tundi bastunin plaku. — Të kam ble një qese pare, moj ti. . . As kafën s'di me ma dhanë. . . Pse veç për dyshëk të mora unë a?.. Y... y, thyj qafën e më piq kafe tjetër, se ta theva kresë — e i tregoi përsëri bastunin. Ajo doli si një statujë duke luajtur si dy mekanizma këmbët vetëm që në gju e poshtë.

Unë vura re se, ndërsa mbushte llullën me duhan nga një qese me një pash uskur, Dalipi nën vetullat e trasha maste pulsin e sallës. Te shumica shikimet ishin të çelura, por disa diç pëshpërisnin vesh më vesh. Dikush ckërmete me veten. Në skenë u duk përsëri Hana.

Skeçi ishte i shkurtër, i shkruar nga një dorë e

pastërvitur, ndoshta nga mësuesi, por ishte diçka e singertë, që të emociononte. Dhe të dy aktorët, at e bijë, interpretuan bukur. Kur ata dolën nga skena, salla gjëmoi nga duartrokitjet. Në fytyrat e të gjithë diletantëve u end një buzëqeshje e lehtë. Këmbyen shikime midis tyre. Hapi i parë ishte hedhur mbi taban të shëndoshë. Sekretari kishte hapur paksa cepin e perdes dhe shihte sallën. Për atë s'mjaftonin duartrokitjet. Në sallë frynin erëra të ndryshme. Dalipi s'kapte dot fjalët, por diçka kuptonte edhe me sy. Ishin ndezur diskutime vende-vende. Disa flisnin me zjarr, ca të tjerë ua kthenin me romuze, një palë frynin e shfrynin mushkëritë pa nxjerrë zë, një palë tjetër bëhej spec nga ky «turp» që i kishin parë sytë.

Programi vazhdoi me duetin e Lulës e Bardhës. Ndonëse shembulli i sekretarit u kishte dhënë zemër e i shpengoi, ato kur dolën në skenë ngulën sytë në dysheme, ndërsa prapa shpine i shtrëngonin fort, fort dorën njëra-tjetrës sikur do të mbaheshin për të mos u rrëzuar. Kurse shoqëruesi i tyre, Hasani, dukej i qetë. Ai filloi t'i binte çiftelisë. Pas pak, tingujt e saj u bënë më të lehtë. Vajzat këmbyen nga një shikim vjedhuraz, u mbushën me frymë, hapën paksa buzët e pjekura si nga ethet, por nuk filluan. Hasani buzëqeshi me vete dhe e filloi përsëri motivin nga e para e, siç që në krah të këngëtarëve, ashtu duke i rënë çiftelisë, doli pak përpara tyre dhe u buzëqeshi. Ato sikur u ngrohën. Kur filluan të dobësoheshin tingujt e çiftelisë, ai ngriti kokën lart dhe u dha shënjë. Ato filluan të këndonin, por fjalët e para s'i mora vesh as unë, që isha aq afër.

— Ngrejani kokën, mos na koritni! — dëgjova zërin e sekretarit pas skenës.

Shikimi i tyre filloi të ngrihej me vështirësi.

Dhe zëri i tyre filloi të bëhej më i plotë, më i qartë. Sytë e Lulës ndeshën mbi një shkëmb të akullt në cep të sallës dhe e hodhën shikimin në tavan prej nga s'u ulën më gjersa mbaroi kënga.

Përsëri duartrokitje e përsëri sekretari vëzhgon-te sallën pas perdes. Biseda, diskutime, romuze, shikime të çiltëra e të vrejtura. Babain e Lulës, që i qe ckërmitur së bijës kur kishte ndeshur në sytë e saj, duartrokitjet sikur e shkundën. Një çast ai mbeti si i hutuar, pastaj mblodhi buzët, luajti pak kokën e sikur ju çel fytyra. Kurse i shoqi i Bardhës kishte zënë veshët me pëllëmbë për të mos i dëgjuar duartrokitjet.

— Ky është i ri, s'e kena aq keq me këtë — kishte thënë me vete sekretari.

Plaka që kisha në krah humbi e tëra pas këngës që kënduan vajzat. Ju çel fytyra, i shkëlqyën sytë dhe, kur qëllonte që vajzave u plakej zëri, u thoshte me sa i jepnin mushkëritë:

— Ngrijeni, moj, zanin!.. Jepini... jepini!..

Dhe këto fjalë kishin një ngjyrë të habitshme gëzimi e mallëngjimi përzier.

Pas duetit, në skenë doli një rapsod, pastaj i erdhi radha një skeçi tjetër. Bënte fjalë për dy të rinj që kishin qenë në aksion, ku mbi shoqërinë e tyre të shëndoshë kishte lindur dashuria. Në këtë skeç gjatë gjithë kohës pati gumëzhitje në sallë, por qetësia u trazua keq kur Zana i tha hapur Malit se e dashuronte. Ai s'e përmbajti më veten dhe e përqafoi.

— E ta lumsha, or Mal! — i foli dikush me zë të lartë.

Tani skeçi kishte mbaruar, por këto fjalë u

bënë shkak për ta ndërprerë disa minuta shfaqjen.

— Mbaje gojën, or ti, Tefik! — ja pat me të ashpër një zë i dytë të parit.

— Unë fola për tem bir, or Shabë.

— Unë ja lashë në besë cucën shokut sekretar e s'e kam lanë me u hargalisë bota. . .

— Se mos vërtet ta mori im bir cucën... Kjo asht estradë, bre...

Shabanit i mori krahun një tjetër...

— Ka hak Shaba, ç'janë këto tunpe... Unë dhetë çika me pasë, kurrë s'e çoj njanën me ba atë punë që bani çika e Shabës.

Pasuan zëra të tjerë. Por Shabës i kishte hyrë inati në gjak.

— Thueji çunit të mbledhë mendjen, Tefik... Në mos po do kena punë bashkë. . .

— S'ka mbetë im bir për cucën tande, or ti. Me mue s'ke punë ti. . . me çikën tate po. . .

Sekretari, kur e pa që po ndizej sherri, doli nga skena. . .

— Çka jeni tue folë, or burra?

Shaba turfulloi më keq dhe kërceu në këmbë.

— Më ke pre në besë, shoku sekretar. . .

— Kadalë, kadalë. . . Ti je në besë të partisë. . .

— Ma nxirr çikën prej atyne kthinave. . .

— Zana do dalë kur të mbarojë shfaqja. . .

— Epo mbani ate, se po iki unë. . . — dhe ai u nis midis stolave. . .

— Mbahu, bre burrë, mos baj marrina!

Por Shaba s'ktheu fjalë. . . Kur arriti te dera ndeshi në një grup të rinjsh që s'i lironin rrugë.

— Ç'është kështu, gjyq apo shfaqje! — ulëriu.

— S'po ban mirë, mor burrë. Prit një herë të merremi vesh.

— Shoku sekretar...

— Prit një herë, prit! — sekretari i futi krahun dhe e tërhoqi në një stol. Shaba u ul mbi të i ngrysur e i vrenjtur, me dhëmbë të shtrënguar e buzë të mbyllura, ndërsa Dalipi seç i shpjegonte. Kur ky pa se e pengonin mustaqet, i hoqi dhe i futi në xhep.

Bisedat nisën të zbuteshin e zhurma u platit pas pak. Në paraskenë doli konferencierja. Fjalët u prenë. Vetëm sekretari vazhdonte t'i fliste Shabës, gojëkyçur. Dikush lëshoi një «shëëët» dhe sekretari uli zërin. Shaba rrinte nursëz dhe godiste me çibuk kupën e gjurit.

— E, bre... — ofshante nga thellësia e kraharorit dhe shfrynte me hundë duke tundur kokën.

Në skenë kishte dalë Mexhidi... Pa hapur gojë ende, në sallë zunë të zjenin të qeshurat nga ajo lëvizje e vetullës së djathtë dhe e buzës së poshtme që i njihnin të gjithë. Ai gjithmonë ishte mbajtur si hokatari më i madh i fshatit, por atë mbrëmje njerëzit prisnin të dëgjonin hoka të reja nga ajo gjuhë brisk. Fjalët e tij të para shpërthyen si një bombë gazhedhëse. Qeshën të gjithë. Qeshi dhe sekretari që i kishte dëgjuar dhjetë herë në natë gjatë provave.

— Po aty në skenë seç ka një lezet tjetër fjala — mendoj një çast sekretari.

Vetëm Shaba s'desh t'ja dinte... Atij i dukej sikur njerëzit qeshnin ende me të bijën. Vazhdonte t'i binte gjurit me çibuk e veshët i gjëmonin nga një buçimë shurdhuese sikur ta kishte patur këmbanë atë të shkretë gju.

Dikush nga fundi u ankua se s'dëgjohej mirë Mexhidi, ndaj të qeshurat u shtruan.

Hokatari buzëqeshi, i lëshoi një thumb të kri-pur xha Hysës që s'e kishte lënë të bijën të shkonte në grupin artistik.

«Ti s'je dhi që të t'çoj me të vu kumonë atje.

— Po, jam mushkë e ti don me më vu fre...»

Kësaj here të qeshurat ishin aq të forta sa nuk dalloje më zëra, por një oshëtimë dallgë-dallgë.

Dhe nëpër këto dallgë përpëlitej klithma e Hysës.

— Nigjo, ti, çun i Xhemalit... Kafsho gjuhën se të vuna të zezën.

Fjalët humbisnin nëpër dallgët dhjetë ballëshe të të qeshurave, fundoseshin e ngriheshin, por s'arri-nin dot në breg.

Askush s'ja vinte veshin Hysës. Ai ktheu kokën nga Shaba. Atij ju venit ajo shkëndijë buzëqeshjeje instiktive që i patën ndezur ato dallgë.

Romuze të reja, dallgë të reja të qeshuri e përsëri ndonjë klithmë ankese që përpëlitej nëpër to.

Si doli nga skena Mexhidi, konferencieres ju desh të priste gjatë gjer të pushonin të qeshurat e duartrokkitjet. Ndërkohë sekretari kishte vënë re një siluetë që dukej e zhdukej pas xhameve të dritareve. E la Shabën dhe doli. Me të dëgjuar kërcitjen e derës, njeriu i fshehur në errësirë, që kishte zgjatur kokën te dritarja, u tërhoq i trembur. Dali-pi s'e njohu aty për aty, por me t'u afruar disa hapa dalloj xha Metin. Duke ju afruar sekretari qeshi me vete. I dha vaktin e i shtrëngoi dorën.

— Pse s'hyn, o xha Met?

Si një fëmijë e zënë në faj befasisht, plaku te-tëdhjetë e kusur bukësh s'diti ç'të thoshte. Edhe

Dalipi një çast sikur s'e zgjidhi dot gjuhën.

— S'e kam ndie vedin ma keq se sot, or çun... Isha i lanun krejt... — plaku pasoi fjalët me një psherëtimë të thellë të përzier me një si rënkim dhembjeje. Pastaj vazhdoi:

— Robtë e shtëpisë, po siç e di ma mirë se unë, ikën e më lanë... Ndejta vetëm, po u mërzita... U nisa e shkova te Shaba, dera mbyllë... Shkova te Zeia, dera mbyllë... Te Zydiu, dera mbyllë... Au! Bana me vete... Si, or Met, të paska lanë hijen katuni...

— Veç ti kishe mbetë pa ardhë — tha Dalipi.

— Sa jam ba kaq, kurrë s'e kam gjetë derën mbyllë te kojshiu e te miku...

— Kojshitë e miqtë i ke këtu të gjithë, e derën çelë e ke. Ne mezi po të pritnim... Hajde!

Plaku s'gjegji aty për aty. Hoqi thellë çibukun.

— Shiko këtu, or çun i Dashit... Unë s'kam ardhë as prej friket, as prej turpit — u bë burrëror zëri i plakut. — Veç më erdhi ligsht kur e pashë vedin të lanun, e të harruemun krejt... se do burra që ke mbrenda të kanë ardhë prej friket mos u vejnë ato letrat e rrufesë, or ti...

Dalipi, duke i futur krahun, i tha buzëgaz.

— Eja të shkojmë mbrenda, xha Met dhe ke me na dhanë të drejtë...

— Po ajo a ka krye punë thue? — foli vrazhdë duke hequr fjalën zvarrë plaku.

— Kush?

— Bardha eme, që i pafsha të vezën!

— S'i ka ardhë radha.

— E si me hy unë, or çun?... A me pa turpena?... Ku duroj unë të qeshet fshati me mue... Apo të baj namin tash që po më sosen bukët?..

— Ecë, bre burrë, s'ka me të nga kush...

— Thue ti...

— Kurrkush...

— Më ke në besë?

— Në besë të partisë e të fshatit...

Dhe hynë të dy në sallë... Plaku dukej se hynte si për të la gabimin që e kapën në befasi... Një vajzë po recitonte.

— A kështu do thërrasë dhe ajo emja... e preftë ujku?..

— Jo, do këndojë.

— Au...

Dalipi e solli xha Metin në krye të sallës. Diskush u ngrit dhe i liroi një vend.

— A të ranë mendtë a? — i tha qortueshëm plaka që kishte në krah.

— Praj, oj ti!.. — ja ktheu plaku.

— I kemi pleqtë ma të moçëm të fshatit — më shpjegoi sekretari dhe shkoi në skenë.

Plakut s'i erdhi mirë që ai iku dhe e la vetëm, si ta kishte lënë lakuriq në mes të shiut. Kështu ju duk vetja kur ktheu një herë kokën prapa e kapi gjithë ato shikime që i qenë mbërthyer pas zverkut. Vjersha që e gjatë dhe ai pati kohë ta mblidhte pak veten. Kur mbaroi recitimi, të gjithë duartrokiten. Metit sikur i shpuan veshët përplasjet e shuplakave. Plaka i bëri me kokë që të duartrokiste edhe ai, por Meti ja pat:

— Pse, oj ti, konferencë asht, a?

Konferencierja doli përsëri.

— Po kjo? — deshi të pyeste plaku. Vajza ja nguli sytë atij, i buzëqeshi dhe... lëshoi furtunën nga goja.

Plakut sikur ju zu fryma e sikur ju prenë damarët.

Në skenë doli Bardha. Edhe ajo (të cilën sekretari e kishte vënë në dijeni) ja nguli sytë të gjyshit dhe i buzëqeshi.

— Ty të pafsha të zezën — shfryu plaku nëpër dhëmbët e rrallë.

— Mbylle atë gojë të keqe, or plak! — fshikulloi plaka.

— Kam me ta thye kresë atë çifteli që më ke marrë — vazhdonte Meti t'i hakërrohej së mbesës... por ajo, ndonëse u skuq, dukej e qetë. Fiksoi çiftelinë në krahun e majtë dhe filloi t'i binte. Si kërpudha pas shiut, nëpër sallë mbinë zhurma që përziheshin me tingujt, me ata tinguj të ndrojtur e të thjeshtë që nxirrte ajo dorë e pastërvitur mbi ata dy tela të lashtë. Kurse zëri i Bardhës ishte më i vendosur, më i sigurtë. Te pleqtë — ngërdheshje, kërcitje dhëmbësh, dridhje mustaqesh, thirrje proteste. Te xha Meti, tërmet. Ju duk se u shembën malet midis të cilave kishte kaluar jetën dhe e mbuluan të gjallë. Dhe s'kishte burrëri që t'ja mbante djersët e ftohta, ngjethjet dhe atë dhembje therëse që i plugonte zemrën.

Mbesa e tji të thvente zakonin e mave! Të merrte çiftelinë që gjer atë ditë s'kishte dalë dorë gruaje ta prekte! Dikur, për një punë të tillë... ai...

Me t'ju zgjuar kujtimet, atë e drodhën ethet. Humbi çdo durim e kontroll dhe, siç e kishte shkopinë në dorë, ja flaku së mbesës. Në sallë shpërtheu një potere që ju duk sikur do ta fluturonte çatinë.

— Ty të vraftë zoti, Met Sala — mallëkoi plaka me gjithë shpirt.

Bardha, të cilën shkopi e kishte fshikulluar

këmbëve, por jo me forcë, e mblodhi shpejt veten dhe e kapi këngën aty ku ja këputi gjyshi... Salla u bë lëmsh. Sekretari nga cepi i perdes hetonte dhe u prish në fytyrë kur shikonte se si ngriheshin disa, i hidhnin dru zjarrit e s'e linin të fikej... Shabën e kishin zënë përsëri ethet, Hysa ishte bërë spec e seç thoshte me duar e me kokë. Meti ishte këputur fare, qe zbehur në fytyrë e fshinte djersët me qeleshe. Zemërimi tek ai plak i lodhur nga vitet kishte shpërthyer aq njëherësh dhe kishte vërshuar aq vrullshëm, sa i dukej tani vetja si diçka krejt e zbrazur, sikur i kishin rrjedhur tërë forcat, tërë gjaku, tërë burrëria. Majat e veshëve i ngrinë, duart ju prenë, kapakët e syve ju rënduan. Ç'ishte kjo thyerje që s'e kishte provuar kurrë në jetë? Ndoshta nga që e mbesa s'kishte pyetur për shkopin e tij? Nga ato gozhdë që i vinin me fishkëllimë si shigjetë nga prapa dhe i nguleshin në kokë? Nga...

Ai s'ishte në gjendje të ndante dy mendime. Ato caste unë pashë diçka të rrallë... Pashë një mrekulli, një shpërthim ndjenjash që kanë vuar të pashuara gjysmë shekulli në një zemër të ngrohtë... ndjenja që të ngjethnin, të drithëronin e që të përshkonin tej-përtej si jehonë e një klithme të largët.

Plakës ju mjegulluan ata sy të vegjël të fshehur në honet e thella të zgavrave. Në fillim ju drodh pak nofulla e poshtme e pastaj drithërima e përfshiu të gjithën, e elektrizoi... Vajza, që i kishte rënë çiftelisë, kishte dalë nga skena, por plaku vazhdonte ta kishte aty parasysh. Përmes shtëllungash të mjegullta të shikimit të saj buzëqeshja e vajzës i hidhte një zjarr në zemër që e ngrohte fort e fort e ja rriste kraharorin me hope.

— Ty të priftë e zeza, shtrigë! — belbëzoi Meti

me ato dy pare fuqi që i kishin mbetur nga ai stërmundim i vetvetes...

— E zeza të raftë kresë, bre, t'u shoftë emni!
— shfryu plaka dhe ja nguli sytë prej nga rridh-
nin jo shikime, por dy turjela të zjarrta.

— Praj, oj e marrë! — Hungëroi Meti dhe
fryu kanalet e hundës.

Por plaka që ndezur e tëra e nga ata sy të
vegjël të picëruar tani zgjatej një thikë e hollë
urrejtjeje që e cante tejpertej Metin.

Ai seç bluajti nëpër gojë për një çast të gjatë
e ja plasi plakës:

— Ngordh, ej morte, se po baj namin pasha
zotin!..

Plaka s'nxori zë, por nga sytë, nga rrudhat, nga
buzët e rreshkura që përpëliteshin rridhte një si
shafran që s'kishte të sosur...

Në sallë vazhdonin të fluturonin thumba mbi
kryet e Metit, por atij i digjte sidomos ai shikimi i
vrerët i plakës.

U ngrit duke rënduar mbi shkop. U dëgjua një
kërr-kërr... i gjatë që s'u muar vesh në e lëshoi
karrigja apo kockat e tij. Kurse plakut ju duk sikur
kërcitën tëmthat dhe i shtrëngoi me dorë... E ndjeu
veten të prerë, gjunjët ju drodhën, shkopi i rëndonte
sikur ta kishte të mbërthyer mbi dysHEME, kurse
koka ju duk si një thes me gurë. Me shumë vështirësi
e ktheu pak majtas e këputja e përpiu të tërin kur
ndeshi në atë lumë vështrimesh të sallës. Ju duk
si një tufan i befasishëm, ndaj ngriti dorën të
mbante qelshen mos ja rrëzonte. Bëri të dilte, por
u ndje i pafuqishëm për të çarë atë digë shikimesh.
U ul përsëri në karrige... Përsëri një kërr-kërr...
e përsëri ai shtrëngoi tëmthat... Pastaj nxori një

shami të madhe me pika jeshile nga xhepi dhe fshiu fytyrën.

Plakën një hop të madh e kishin mbërthyer drithërimat, pastaj ajo u dha nja dy lëvizje të shpejta kapakëve të syve dhe hoqi frymë thellë. Sikur u përmend. Meti ngriti sytë, ia hodhi plakës, por s'mundi ta mbante gjatë shikimin mbi të... Atij i thoshte mendja se ajo ishte çmendur...

Kur mbaroi së recituari mësuesi, plaka u ngrit, sekretari, me ta parë, erdhi aty:

— Ç'ke, nanë Mine! Mos je sëmure gja?

— Kurr-gja, bir, kurr-gja... Do shkoj deri te shtëpia e po vij prapë... Veç një gja të lutet nana, bir. Po qe se mbaroni, më prisni se kam do fjalë me i thanë sonde, do fjalë që ma kanë randue zemrën e që s'mund t'i mbaj...

— E mjera ti! — belbëzoi Meti.

— Ta po më shef ti — ja ktheu plaka... Ai sikur s'ua vuri veshin fjalëve të saj, por me t'u larguar, nisi t'i shfaqej një si frikë... Ai frikë nga një grua!? U mundua të buzëqeshte me vete, por buzët i ishin trëshur e s'mund t'i hapte...

Programi vazhdonte. Thumbat dukeshin e zhdukeshin mbi valëzat e dallgët e shushurimave të sallës ashtu si duken peshqit pranverës mbi valët e detit. Meti vuri duart mbi shkop e mbështeti mbi to kokën e tij të rëndë. Në bisht të syrit të majtë i qe formuar një tufë rrudhash në formën e freskores dhe bishti i mustaqeve i dridhej parreshtur. Shaba andej nga fundi sikur ishte lehtësuar. Kishte ngritur kokën dhe hera-herës qeshte tok me të tjerët. Veç kur i kujtohej e bija, përsëri llulla e drunjte niste të sillej nëpër duar me nervozizëm. Kurse Hysa s'guxonte të shihte majtas e djathtas. Nëpër

gjak sikur i lëvrinin urithet e atëhere u hidhte vjedhuraz nga një sy Shabës e Demit e sikur mbësh-tetej për të mos u rrëzuar.

Kur u kthye Minja, programi ishte në të mba-ruar. Shumëkush u habit kur e pa, ndonjë nga të moshuarit u vrenjt. Meti e mallëkoi, kurse Dalipi gjatë gjithë kësaj kohe s'kishte mundur që s'kishte mundur të merrte dot me mend se ç'mund të thoshte Minja, s'e kishte kuptuar dot atë zë të panjohur të saj, atë shikim të panjohur mbi sytë e saj.

Djali që e shoqëronte e solli deri aty në rresht të parë dhe ajo u ul aty ku pat qenë. Në duar mbante diçka të gjatë të mbështjellë me një rrobe të hirtë lidhur me gjalmë leshi. Kërcinjtë e thatë të gishtërinjve e mbanin atë gjë të shtrenjtë me një solemnitet të çuditshëm. Ajo e mbështeti me kujdes sendin e mbështjellë mbi prehër e priste në ankth të mbaronte shfaqja. Salla e harroi fare Minen. Por Meti jo. Ai s'ja ndante sytë.

Salla buçiti nga duartrokitjet... E nëpër to për-sëri ngrinin krye thumbat e romuzet... Në skenë doli sekretari. Kureshtja e platiti zhurmën.

— Ne kaq e kishim në program... Po ky është i pari dhe i përgatitur shpejt e shpejt.

— Ju lumtë... S'ka ku shkon ma mirë — thirri dikush. Pasuan duartrokitje aprovuese...

Sekretari ngriti dorën për të treguar se do të vazhdonte fjalën... Por ju desh një çast i gjatë që të getësohej disi salla.

— Me këtë program ne deshëm me ju tregue se mund ta bajmë një grup artistik e s'asht turp me dalë këtu me këndue e me luejtë edhe çikat... Ju e patë vetë... Çfarë turpi ka këtu? Unë i pari nxora çikën time...

— Çdo berr varet për kambë të veta — ja preu dikush.

— Unë s'e lej ma teme bijë me shkelë këtu — pasoi një tjetër.

— Ku asht pa, bre, me i bra çika çiftelisë! — u zbraz Meti.

— Ngadalë, ngadalë — thoshte sekretari. Por tashmë salla ishte ndezur keq. U krijuan disa vatra vorbullash. Sekretari me zor mendohej t'i qetsonte. Tani valonte keq kazani atje poshtë. Dikush ngrihej e protestonte, bërtiste... Një tjetër hidhej kundër tij, dhjetë të tjerë i mbanin krahun...

Kaluan çaste gjersa erërat në sallë kishin nisur të dalloheshin mirë. Ata që ishin bërë epiqendër e vorbullave të zhurmës e diskutimeve s'po u bënë dot ballë grupeve që i kishin rrethuar... Sekretarit ju çel fytyra. Ai ktheu kokën pas dhe buzëqeshja e tij çeli fytyrat e gjithë diletantëve.

— S'i ka ra kurrë grueja çiftelisë te na, ç'janë këto marrina! — tundi shkopin Meti dhe sytë ju ndezën. Fjalët e tij i ngjanin rrebeshit të fundit të shiut para se të largohet shtërngata. Në sallë sikur u platitën zërat.

— S'e kanë lanë, se, besa, ma mirë se burrat i ka ra — zbrazi gjithë zërin Minja.

-- Shuej zanin, drej i mallëkuem, se... Ty të ka lanë mendja në pleqni, ej mos të zantë dita!

— Kadalë, xha Met! — ndërhyri sekretari.

— Pse s'thue me u dhanë edhe pantallonat grave e mos me i thanë ma vedit burra, or ti! — shfryu Meti.

Shkrimet rrodhën në krye të sallës. Minja u drithërua një herë fort, pastaj u ngriç e, duke shtrënguar fort pas gjoksit atë send të shtrenjtë mbështje-

llë me copën e leshtë, u ngjit ngadalë drejt skenës. . . Sekretari ju afrua dhe e ndihmoi të ngjite shkallët. Salla ra në heshtje. Të gjithë zunë përsëri vend nëpër stola. . . duke kryqëzuar shikimet e duke ngritur supet prej habitë.

Nënë Emineja mbeti një hop ashtu e hutuar, jo nga që s'dinte ç'të bënte, por nga që tërë ato zjarre që i digjeshin përbrenda e kishte vështirë t'i mbante pleqëria e saj. Sendin e mbështjellë me rrobe leshi e shtrëngonte pas gjirit si një foshnjë që e ruante mos ja rrëmbenin. Salla s'pipëtinte. Parandjenin diçka ndërsa shihnin plakën si s'e kishin parë kurrë.

— Çka don me ba, oj u bafsh lugat i vedit
— plasi si një minë zëri i Metit.

— Boll e zgjate, xha Met, tani. . . mjaft — gjegji një zë i trashë qortues.

Plaka u shkund nga topitja. Në sytë e saj ndriste vetëm një dëshirë: ta flakte tej pleqërinë një çast; vetëm një çast sa ta nxirrte e ta hidhte në sallë gjithë atë zjarr që i përvëlonte gjoksën, që e kishte ndezur të gjithën gjer te thonjtë e këmbëve. Pastaj. . .

Ajo psherëtiu duke ju përpëlitur me drithërima ato dhëmbë të rrallë, dhe bëri me dorë nga prapaska.

— Hajde, burrneshë!

Bardha me çifteli në dorë, e hutuar, u çapit e ndrojtur drejt saj.

Plaka u zgjat duke drejtuar shtatin e kërrusur dhe e puthi në ballë:

— Ty të falsha ditët që më kanë mbetë!

Meti diç hungëroi me vete. Nëpër sallë zgjateshin

ca «shëëët...» si fshikuj që godisnin pëshpëritjet
sapo nxirrnin krye.

Plaka nisi të zgjidhte gjalmin e leshtë me kërcinjtë e thatë që i dridheshin... Sekretari e diletantët mbajtën frymën, salla priste të shikonte çudinë e mbuluar nën atë rrobe të vjetër... Bardhës ju bë sikur në vend të zemrës kishte një grusht që i rrihte gjoksin.

Filloi të shpështillej rroba e leshtë... Kuresh-tja u ndez edhe më. Rroba u lëshua në dysheme, pas saj edhe një tjetër, edhe një tjetër dhe në duart e plakës doli një... një çifteli. Një çifteli si gjithë çiftelitë, veç ishte e punuar me merak të madh, ishte e vjetër dhe kishte një ngjyrë si përzjerje e së murmes me kafe të errët.

Në sallë u ngritën ca shtëllunga habie. Minja e puthi çiftelinë përmallshëm, siç mund të puthësh një fëmijë që të ka djegur zemrën dhe i rrodhën dy çurka lotësh që i buruan nga guvat e syve, kuptuan atë rrudhën harkore mbi mollëza dhe pastaj u zhdukën pa ju dukur gjurma nëpër ato faqe të pluguara kryq e tërthor prej pleqërisë.

— Merre! — i tha Bardhës mes ngashërimesh — Kam gjysmë jete që po ta ruaj. Merre! — dhe i zgjati çiftelinë. Meti u drodh, Bardha u shushat fare e s'dinte ç'të bënte.

— Merre, bijë!.. Është jotja... Dhe bjeri një herë ta ndiejnë të gjithë si knon kjo çifteli... Bjeri!..

Sekretari zgjati dorën dhe i mori Bardhës çiftelinë me të cilën kishte ekzekutuar. Sytë e zëri i Mines e çarmatosën fare Bardhën. Mori çiftelinë dhe nisi t'i binte shumë e emocionuar, ndërsa plakën ata tinguj e rrëmbyen, ja drejtuan shpinën dhe ja

kthjelluan ballin... Nga emocioni Bardha u ngatërrua dhe e pati të vështirë të luante më tej.

— S'ka gja, bijë. Mëso t'i biesh ma mirë... Dhe eja ta mësoj unë një kangë që s'e din kush veç meje e që e ka ndigjue një herë veç yt gjysh.

— Shueje zanin, o t'u shoftë jeta! — klithi Meti.

Por Minja as që u vuni vesh fjalëve të tij.

-- Ma jep mue! — i tha Bardhës dhe mori çiftelinë. Por ndjeu një turbullirë, një marrje mendësh dhe kërkoi një karrige.

Askush s'e kuptoi se ishte pesha e viteve apo e kujtimeve që e rëndonin aq shumë. Si u ul e si u çlodh një çast ajo vuri çiftelinë mbi gjoks dhe... Atëhere habia s'u përmbajt më. Ajo filloi t'i binte çiftelisë duke ua dhënë të gjitha forcat e qenjes së saj atyre gishtërinjve të hollë që luanin mbi tela.

Dhe unë tash kaq kohë, kur dëgjoj të thuhet «qetësi absolute» për një sallë mbushur plot e përplot me njerëz sjell ndër mend atë çast... Dhe ai ishte vetëm çast, sepse pas pak Minja zu t'i shoqëronte telat me këngë, me një këngë që s'e kishte dëgjuar askush. Fjalët e saj i ranë Metit si një shkëmb mbi kokë. Ai u përkul e s'u ndie më.

*Ej, kanun, ti qofsh mallkue,
Që ja nxive jetën grues,
Ma mirë mushk' se me qenë grue,
Zemra lidhun me tërkuz.*

.....

Më tej s'u muar vesh asnjë fjalë, sepse zëri i Mines sikur humbi. E mbështolli ngashërimi e dhem-

bja, apo shterën forcat? Edhe kjo s'u muar vesh. Edhe ata që ishin nga fundi zunë të dyndeshin me majat e këmbëve në radhët e para. Tek dëgjonte hapat, Metit i dukej se po i hipnin të gjithë në kurriz.

Por Minja s'mundi ta çonte këngën deri në fund.

— Kam 4-5 vjet që s'i kam ra ma, po thashë se sonte do i gjejsha do forca për me i ra. Po pleqni e ma s'më ban as dora e as goja... — Ajo ngriti kokën dhe vetëm atëhere vura re se faqet e saj të lëruara ishin vaditur.

Ajo psherëtiu disa herë sikur të çlodhej kështu, pastaj tha:

— Desha me ju thanë ju gjithë sa jeni këtu, se grueja din me i ra çiftelisë njilloj si burri: Dyzet vjet mbaj mend unë... dyzet vjet i kam ra unë ja, kësaj çiftelie që shifni këtu... Dhe dyzet vjet kam këndue kangën e kanunit që ma nxiu të rit tem...

Ajo heshti përsëri e u mbush mirë me frymë.

— Gruen s'e kanë lanë, gruen e vritshin me i ra çiftelisë...

Metin e zuri ngërçi dhe e mbuluan djersët... desh me folë po ju duk sikur i kishte ikur zëri.

— I vritshin posi... Si e ka vra ky Met Ceni gruen e vet...

Të rinjtë çakarritën sytë e u zgjatën të shikonin Metin, sikur s'e kishin parë kurrë. Bardhën e kapi një si rrëqethje.

— Pse i binte çiftelisë, pse shante kanunin... — vazhdoi Minja.

Meti duke rënduar fort mbi shkop e duke drejtuar sa mundi me dhembje trupin, u ngrit e mori më të majtë.

— Xha Met... po dale ti... — foli sekretari.

— Ku shkon, baba? — i foli dhe i biri, një burrë i shëndoshë rreth të dyzetave. I folën dhe të tjerë, por ai as foli e as kokën s'e ktheu, po ashtu i hutuar çau nëpër atë shteg të ngushtë që ju hap midis njerëzve me shikime të rrepta dhe doli.

Shaba, Hysa dhe një tjetër s'e kishin ndjekur turmën që u dynd në radhët e para, por tani që ndeshën në shikimet e të gjithëve që përcollën plakun deri te dera, e ndjenë veten ngushtë e zunë të çapiteshin si me përtesë drejt të tjerëve.

Si në një kotje të rëndë, gjatë kësaj kohe, Minja humbi mes kujtimesh të largëta që i jepnin ca si afshe të vala nëpër krahëror. Pastaj nisi tregimin.

Ajo fliste ngadalë, por me një zë të thellë, të mbushur me ca dridhje valzake. Në fillim fjalët i dilnin copa-copa e si të përdredhura, si ashkla që dalin pas faqeve të tyrjelës. Dhe tyrjela ishte ai mallëngjim i madh që zhbironte trupin tejpertej

— Kanë shkue tridhjetë e kusur vjet nga ajo ditë e zezë në mos janë ba dyzet... Ja, bani hesap vetë... Kur ndodhi gjama, i biri sa kishte mbushë motin.

Njerëzit vazhdonin të aviteshin pranë skenës duke u munduar të mos bënin zhurmë e të mos u shpëtonte gjë pa dëgjuar.

Mines ja përshkoi disa herë fytyrën një ngërç i fortë që i shkaktonte dhembje.

— Ne ishim prej një fshati, ishim rritë bashkë si motra me Nushen. Dhe fati prapë na pru pranë... Fati i keq a i mirë s'di me thanë... Ajo u martue për Metin e unë për Hasanin. E këta sikur t'qenkeshin

vëllazën për nga zakonet. Zi unë e ma zi Nushja. Unë s'pata fat me pas një gocë e me ja kallëzue ato të zeza... Asgja s'mun bajshim me mendje tonë veç ç'ka dojshin burrat, ç'ka thojshin burrat... S'ka ma zi për gruen...

Spektatorët, sidomos gratë dhe vajzat prisnin me ankth se ku donte të dilte kjo plakë që s'ja kishin dëgjuar kurrë zërin midis kuvendit. Mbi të ishin mbërthyer qindra sy e ajo vazhdonte të fliste me atë zë si të përdredhur, të ngjirur, të valëzuar.

— Nushja i binte çiftelisë... I binte vjedhuraz. I kishte ra që në shtëpi të vet, ku ja kishte mësue e ama e i binte edhe këtu.

Spektatorët vazhdonin të ngjiteshin në radhët e para e çdo kërcitje, çdo zhurmë goditej me një «shët...» të menjëhershme e shuhej në çast si t'ishte goditur nga një kamzhik dërmues.

— Askush s'e dinte këtë gja, veç meje... Bile çiftelinë prej shtëpisë së vet unë ja pruna këtu, se vetë s'pati se si... Kishte sajue një brimë në koshar të gjasë e aty e mshifte... Kur burrat ikshin shtëpiet me punë kund a viheshin për udhë, Nushja e merrte çiftelinë e futej te lisat e Ujabardhit ku s'e shihte kush e s'i shkonte kujt ndër mend me e kërkue. Unë shkojsha me e ndëgjue... Po çfarë me ju thanë bre?! Çfarë me ju thanë?! Se u bana kaq, s'kam pa e s'kam ndie tjetër kend me i ra ma bukur çiftelisë, me i ra me ta dridhë zemrën. Edhe unë mësova prej saj me i ra po ku...! Ajo kishte le për çifteli e për kangë... e për plumb... I pata thanë kushedi sa herë me e lanë atë çifteli, se kish me i hangër kryet, po s'qe e mujtun... Ajo çdo gja mund ta linte, veç çiftelinë jo... Ja donte zemra... Ajo ja jpte gazin e ja merrte helmin.

Minja u prish keq në fytyrë sikur të kishte nxjerrë dhe ajo helm prej goje. Fjala e saj tani i kishte rrëmbyer aqë shumë të pranishmit saqë pothua se po harrohej që pak më parë aty u dha shfaqje. Plaka i ngjante një burimi të thellë e njerëzit, të etur, prisnin ç'do të dilte nga ajo thellësi. Ata që ishin ulur në radhën e parë tani e kishin lënë stolin dhe ishin përkulur duke u mbështetur me bërryla mbi paraskenë, të tjerët qenë përkulur mbi ta, kurse ata të fundit kishin hipur mbi stola që të shikonin më mirë. Madje fjalët e plakës kishin një forcë aq të madhe magjepse, saqë edhe diletantët i harruan ato emocione të forta të disa çastevet të mëparshme dhe ashtu si pa u ndjerë, si pa e kuptuar as vetë, e kishin lënë prapaskenën dhe kishin rrethuar Minen.

— S'kish perëndi t'ja mbushte mendjen që të hiqte dorë nga çiftelia, gjersa e gjet rreziku.

Sallën e përshkoi një shushurimë e përzier, shikimet u tendosën, njerëzit lëvizën, zgjatën kokën sikur do shfaqej diçka e magjishme para tyre. Plaka shkarkoi me dhembje mushkëritë, luajti pak kokën, u shkoi një të fshirë syve me shpinën e dorës.

— E vranë... E vrau i shoqi... Meti...

Sekretari e përpiu një herë kënd më kënd sallën me shikimin e tij të ndezur.

— Te lisat e Ujabardhit... Meti ishte nisë me shkue për miqësi në Gropë. Si kreu punët e drekës Nushja erdhi e më bani za. E shkuem te lisat... Nushja kish frikë me i ra në shtëpi se mos shkonte kush... Shkuem te lisat pra e ajo nisi me i ra asaj kange që nisa dhe unë një këtu. Ajo i binte e këndonim të dyja, Nushja me za e unë pa zë. E, Nushja e shkretë! Unë e nji fsha si shof vedin, por kur e

shifsha tue i ra çiftelisë më dukej si një tjetër. Balli i bahej rrudha-rrudha, sytë i mbyllte përgjysmë e shikonte larg, andej nga Gryka e Ukut... Damarët e duarve i fryheshin si damarë burrash e thue se po i pëlcisnin. E unë e dijsha, i ndizej gjaku Nushes... Unë s'di me tregue sa bukur i bihte çiftelisë e ku e gjente gjithë atë za që të dridhte mishtë... Si këndonte e këndonte sa ngopej ato kangë që i nxirrte vetë, niste e ma mësonte mue çiftelinë. Po atë ditë s'mujti me ma dhanë... E ajo ditë e zezë që i preu jetën...

Në grumbullin e spektatorëve dikush lëvizi, pastaj filloi të çelej një shteg i ngushtë e nëpër të kaloi djali i Metit me të shoqen e me të birin. Atyre u liruan vende në radhën e parë. Edhe Bardha, si pa u ndjerë, u çapit e ju afrua Mines më shumë se të tjerët.

Minja u ngashërye një copë herë, u mbush me frymë e ja qepi sytë djalit të Metit...

— Kështu, çun-o, nanës tande i mbeti kanga në mes e sytë i mbetën te Gryka e Ukut... Krisi pushka e ajo mbeti me çifteli në dorë... Plumbi e mori brinjë më brinjë... Unë s'mujta me marrë veshi asgja... Prita radhën dhe unë, por pushka s'u ndie ma... U nguta me i shikue plagët Nushes, por ajo më mbeti ndër duer... Sytë ju zbehën, kapakët ju randuen, duart ju këputën fare, por çiftelinë s'e lëshonte që s'e lëshonte... Unë e dijsha se kishte nxjerrë shpirt e u habita kur ato buzë të djeguna u hapën paksa e midis tyne doli një za... za po e them unë, se nuk ishte za, por... Nuk di si me e thanë si ishte, veç mue sikur ma veshi në flakë trupin krejt... Ajo deshi me e vazhdue kangën aty ku ja këputën, por s'mundi me thanë veç katër-pesë fjalë me atë za që unë s'di si me e thanë.

Minja heshti përsëri për të kapërcyer me zor të madh ato ngërçe të gurta që i çanin fytin. Rizai, djali i Metit kishte shtrënguar nofullat e nën mollëza i kërcenin muskujt si dy uritha, flegrat e hundëve i ishin zmadhuar e tendosur, veshët i qenë skuqur, gjoksi i gjerë i ulej e i ngrihej parreshtur. Kurse Bardha ja kishte ngulur sytë të atit. U drithërua kur pa atë, që s'e kishte parë kurrë, një lot në syrin e majtë të të atit, kurse i djathti, si dukej, po mundohej ta fshihte pikën tjetër... Lulja u ngjeth gjër në gjak e ndjeu dhembje në rrënjët e flokëve. Salla heshtte me një heshtje që mbulonte dridhje zemrash, tendosje nervash, shtrëngim dhëmbësh e rrëqethje.

Sekretari ngriti kokën dhe kërkoi me sy Sulën e Hysën, që duhet të ishin andej nga fundi. Edhe ata, si duket, e prisnin prej kohësh shikimin e tij. Sula e përballoi vetëm një moment atë shikim të ndezur ashtu siç durojmë një dritë shumë të fortë që na shfaqet parasysh papritur. Pastaj mbylli sytë dhe uli kokën. Kurse të Hysa ai shikim gjeti trajtën e një force manjetike që s'pyeti fare për vullnetin e tij, por e bëri të hidhte edhe ato dy-tre hapa që i kishin mbetur e të futej në grumbullin e njerëzve që ishin dyndur te skëna.

Rizait, megjithëse mundohej të mos luante qerpikët, loti i syrit të djathtë i çau më në fund një shteg midis qerpikëve të dendur dhe u rrokullis mbi faqen e tij si një kokër lajthie. Ai u kapërdi zhurmshëm e ndjeu dhembje në tëmtha. Kurse Minen loti i tij sikur e shkundi e ja përzua heshtjen.

— Ti e ke ditë se ke pas nanë të mallëkueme. Bardhës ju drodhën duart e me gishtat preku telat e çiftelisë. Ajo u tremb, kurse i ati, që mun-

dohej t'u bënte ballë ndjenjave, u ngërdhesh dhe mbylli sytë që i digjnin.

— Si provoi me vazhdue kangën e s'mujti, Nushja më tha:

— Të ma kesh amanet çiftelinë... E, në baftë im bir ndoj çikë, jepja dhe mësoja kangën teme. — Mandej ma s'u ndie. Unë s'dijsha çka me ba... Ndejta pak... Mandej njeva zana e humba nëpër lisa...

Ditën tjetër mora vesh se atë e kishte vra Meti... Mue, si duket, s'më kish pa aty ndër kacuba... E kishte mallëkue të shoqen e e kish varrosë me të vëllain aty ku e vrau, pa pranue as me e futë në vorreza të fshatit. E qysh atëherë kjo çifteli që solla sonde këtu ka ndejtë mshefë në shtëpi teme. E kam ruejtë siç mund t'i ruejsh për amanet motrës gjanë ma të shtrenjtë të zemrës... E ruejsha që një ditë t'ja jepsha Bardhës e t'i mësojsha atë kangë që knonte gjyshja.

Bardhës sikur ju muarën mendtë, sytë ju mjegulluan, këmbët sikur ju drodhën e në gjoks ndjeu një lukth që i trokiste si një vare.

— Kush ka gojë me thanë se grueja s'ka ditë me knue e me i ra çiftelisë?

Për habinë e sallës ajo e ngriti zërin si asnjëherë gjatë bisedës. Fjalët e saj u ngritën lart si diçka e zjarrtë që shpërtheu në dhjetëra copa e që ranë nëpër sallë e ndezën dhjetëra vatra bisedash.

Minja diç u mat të thoshte po me atë vrull, por nuk foli. Salla e vërejti dhe shoi bisedat, atëherë Minja u çua e iju drejtua Bardhës.

— Atë kangë unë e kam mbajtë 40 vjet këtu në shpirt që të mos humbë, e ti këndoje tani, që ta marrin vesh të gjithë se gruen kanuni e ka lidhë,

por s'e ka mbytë kurrë... Eja atje ke unë të ta mësoj, se unë s'vij dot këtu çdo ditë, s'më bajnë kambët... Sot më solli zemra... Dhe këtë çifteli që të dhashë ta mbash me nder, si burrneshë. — Fjalët e saj ishin si një shpërthim nga thellësitë.

Më tej nuk foli. Ja nguli sytë Bardhës. Ja nga ata sy, që më parë dukeshin si thëngjij në të shuar në ato dy zgavra të errëta, tani dilte një flakë zhbiruese. Bardha më s'u përmbajt e ju hodh në qafë...

Salla gjëmoi nga duartrokitjet. Me t'u ndarë me Bardhën, Minja u ndodh në krahët e sekretarit të partisë. Ai ndjente gjoksin e saj që ulej e ngrihej parreshtur, ndjeu mbi faqe lotët e saj. Ndjeu zërin e saj te veshi.

— Sot kam lehtë dyti... E kam pa vedin njeri... o çun-o...

Midis radhëve të stolave rridhte një vërshim i pashkëputur ndjenjash të reja. Në krye printe Minja. E mbante në njërin krah sekretari i partisë e në tjetrin Bardha, e cila në krahun e lirë shtrëngonte fort pas trupit çiftelinë...

Nga mesi i rreshtit ecte Sula përkrah së bijës. Ajo ngriti kokën si vjedhuraz e pa të atin. Atij ju ndër pak buza e poshtme dhe i gurgulloi një mërmëritje, por u përmbajt... Ngriti me përtesë dorën dhe e vuri mbi qeleshe për të mbështetur shqetësimin e tij... E bija buzëqeshi. Salla mbante nën sqetull djepin që e bija e kishte sjellë nga shtëpia për nevojat e skenës. Kurse Tefiku, në të ecur e sipër, si drodhi cigare për vete, i zgjati kutinë Shabës dhe ai s'ngurroi ta merrte, ndonëse para një ore i kishin mbrehur keq fjalët kur fëmijët e tyre luajtën në skenë «të dashuruarit në aksion».

Edhe kur dolën në rrugë, turma e spektatorëve

dhe e diletantëve e ruajti trajtën. Dhe pas një çasti, si u mësuan sytë në errësirë, më të poshtë, ndo njëqind metra më larg, dalluan një njollë të vogël të bardhë që lëkundej majtas, djathtas.

Meti ishte gjendur jashtë i gozhduar aty pas dritares. Dhe ja tek po çapitej tani para fshatit, që i dukej se e ndiqte i udhëhequr nga ajo... Minja.

S'i kishte qëlluar kurrë në jetë ta ndjente veten aq të dobët, aq të pafuqishëm. Prapa, zërat e largët të atyre që zbrisnin nga vatra e kulturës i dukeshin si erëra që e shtynin përpara, po ku t'i gjente forcat që të çante! Përpara i gjëmonin si një tramundanë tingujt e çiftelisë e ai zë i largët, që ishte rizgjuar dhe i vinte andej nga lisat e Ujabardhit i çante gjoksin mes për mes si një heshtë.

Dhe s'ka dhembje më të madhe se sa kur plaga shfaqet 40 vjet pas goditjes.

* * *

Më qëlloi të shkoja përsëri në këtë fshat të largët pas katër vjetve. Gjëja e parë që bëra, pyeta për të mësuar se si kishte vajtur puna me grupin artistik, ç'bëhej Minja, Meti e Bardha? Ç'bëhej çiftelia e lashtë?

Grupi kishte fituar çmimin e parë në festivalin folkloristik të rrethit. Numri i diletantëve ishte shtuar. Çiftelia mbështillej në kujdesin e një thesari të paçmuar. Meti ishte plakur edhe më e ishte bërë më i heshtur. Këngën e Nushes, që i kishte djegur zemrën, tani e kishte mësuar gjithë fshati. Gjithashtu në fshat kishte lindur një këngë e re kushtuar Nushes dhe Mines, e cila e gërryente Metin siç gërryen tyrjela një gdhë të fortë. Në fillim ai s'kishte mundur

ta mbante atë dhimbje therëse, por tani kishte filluar ta gëlltiste. Minja kishte vdekur në verën e kaluar. Eshtrat e Nushes i kishin hequr nga lisat e Ujabardhit dhe i kishin varrosur me respekt në varrezat e fshatit. Minen e kishin varrosur përbri saj. Ato jetonin të pandara si dy motra edhe në këngën që u kishte kushtuar një rapsod i fshatit. Në krye të varrit të Nushes ishte vendosur një copë trung pishe mbi të cilin ishte gdhendur një çifteli që, midis gurëve dhe kryqeve të vjetra të vorrezave, i ngjante një lapidari të madhërishëm!

L È N D A

Faqe

Një vajzë në vagonin tonë	3
Kolegët	14
Zenepja e bukur	21
Për trenin dhe për grurin	28
Shërbimi i parë	36
Pas provimit të fundit	49
Sazexhinjtë	50
Shpirt bujku	68
Akti i fundit i dramës	73
Përtëritje	84
Bregu	92
Xhirimi	104
Rrugës për te komunisti	108
Dasmë!!!	115
Tezja	124
Shpërthim nga thellësitë	131